

TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT

MANUAL PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE

Botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Prezenca në Shqipëri

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Qershor 2016

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Materiali që përmban ky publikim mund të citohet ose rishtypet me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e publikimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet OSBE-së. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por që nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky publikim, kërkon lejen me shkrim të OSBE-së.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe as të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta.

Autorët: Kathleen Imholz dhe Elsa Toska (Dobjani)

Design: Kilica Studio

ISBN: ISBN 978-9235-272-1

Hartimi i këtij manuali është pjesë e projektit
Edukim vazhdues dhe i qëndrueshëm për nëpunësit e administratës publike të
Shqipërisë
i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta dhe zbatuar
nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Autorët

Kathleen Imholz dhe Elsa Toska (Dobjani)

Fjala Hyrëse

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut është një prej vlerave më thelbësore të OSBE-së. Shtetet Pjesëmarrëse të OSBE-së e vlerësojnë respektin e thellë për të drejtat e njeriut si pjesë të rëndësishme të identitetit të përbashkët; elementin përkufizues të dallimit midis diktaturës dhe demokracisë.

Në gjykim praktik, ndërtimi i kulturës së respektit për të drejtat e njeriut në qeverisje përmirëson dhënien e shërbimeve, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e jetës së qytetarëve, si edhe në rritjen e besimit të publikut tek institucionet.

Qëllimi i këtij manuali është të përkthejë disa prej koncepteve abstrakte të të drejtave të njeriut në detyrime të qarta për punonjësit e administratës publike, për të mundësuar të kuptuarit dhe të zbatuarit e këtyre koncepteve në punën e përditshme. Duke synuar përforcimin e respektit për të drejtat e njeriut, manuali do të jetë thelbi i një programi trajnimi për nëpunësit publik që do të zhvillohet nga Shkolla e Administratës Publike.

Ky manual u hartua si pjesë e projektit të krijimit të një programi të qëndrueshëm trajnimi në Shkollën e Administratës Publike, të financuar nga qeveria e Holandës e te zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, me mbështetjen e Ministrit të Inovacionit dhe Zyrës së Kryeministrit.

Dua të falënderoj Mbretërinë e Holandës dhe të gjithë ata që e realizuan këtë projekt, veçanërisht drejtorin e Shkollës së Administratës Publike, Fatmir Demnerin, menaxheren e trajnimeve, Arlinda Hotin, si edhe autoret Kathleen Imholz dhe Elsa Toska.

Përkushtimi juaj në edukimin vazhdues të punonjësve të administratës publike do ta kthejë respektin e të drejtave të njeriut në një realitet të jetueshëm për qytetarët.

Florian Raunig

Ambasador

Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

PËRMBAJTJA

I. PREZANTIMI I MANUALIT	11
II. ÇFARË JANË TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT?	17
2.1. Disa konsiderata të përgjithshme	17
2.2 Kategorizimi i të drejtave të njeriut	18
2.3. Të drejtat e njeriut dhe dinjiteti njerëzor	22
2.4 Çdo të thotë dhunim i të drejtave të njeriut?	22
2.5 Formësimi i kulturës të të drejtave të njeriut	23
III. TË DREJTAT E NJERIUT NË AKTE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE	27
3.1 Kushtetuta	27
3.1.1. Disa konsiderata të përgjithshme	27
3.1.2 Çfarë të drejtash parashikon Kushtetuta?	28
3.1.3. Kriteret kushtetuese të kufizimit të të drejtave	29
3.1.4 Cili është organi që bën interpretim përfundimtar të Kushtetutës	32
3.1.5 Si ndikon kontrolli kushtetues në veprimtarinë e përditshme administrative?	34
3.2 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950)	35
3.2.1 Të përgjithshme	35
3.2.2 Cilat të drejta sanksionon KEDNJ?	35
3.2.3 Cili është organi mbikqyrës për KEDNJ?	37
3.3 Instrumentet të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut	38
3.3.1 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948)	38
3.3.2 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966)	39
3.3.3 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966)	39
3.3.4 Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (1965)	40
3.3.5 Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979)	40
3.3.6 Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (1989)	41
3.3.7 Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (2006)	41
3.3.8 Karta Themelore e të Drejtave të Bashkimit Evropian (2000)	42

IV. KONTEKSTI SHQIPTAR MBI KULTUREN E TË DREJTAVE TË NJERIUT; ROLI I ETIKËS	47
V. DREJTA PËR MOSDISKRIMINIM, BARAZIA PËRPARA LIGJIT	53
VI. E DREJTA PËR INFORMIM	63
VII. E DREJTA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE	72
VIII. TË DREJTA “NË VEPRIM” TË LIDHURA ME VEPRIMTARINË E ADMINISTRATËS PUBLIKE	81
8.1 Të drejta të karakterit procedural në këndvështrim të procesit administrativ	81
<i>8.1.1 E drejta për akses (aktiv dhe pasiv)</i>	<i>82</i>
<i>8.1.2 E drejta për përfaqësues</i>	<i>83</i>
<i>8.1.3 E drejta për t’u informuar/njoftuar</i>	<i>83</i>
<i>8.1.4 E drejta për t’u dëgjuar</i>	<i>83</i>
<i>8.1.5 E drejta për t’u mbrojtur efektivisht</i>	<i>84</i>
<i>8.1.6 Arsyetimi i vendimeve</i>	<i>85</i>
<i>8.1.7 E drejta për ankim</i>	<i>86</i>
<i>8.1.8 E drejta për kohëzgjatje të arsyeshme të procesit</i>	<i>86</i>
8.2. Disa të drejta të përzgjedhura të karakterit substancial	90
<i>8.2.1. E drejta e pronës</i>	<i>90</i>
<i>8.2.2 E drejta për arsim</i>	<i>94</i>
<i>8.2.3 E drejta për kujdes shëndetësor</i>	<i>97</i>
IX. EDHE JU NËPUNËSIT KENI TË DREJTA!	102
9.1 Konsiderata të përgjithshme	102
9.2 Të drejtat e nëpunësve civilë	108
9.3 Nëpunësit civil dhe urdhrat e paligjshëm	113
9.4 Përgjegjësitë e nëpunësit publik për mosrespektimi e detyrimeve ligjore dhe kushtetuese	114
X. PËRFUNDIME, PËRMBLEDHJE DHE 10 KËSHILLA PRAKTIKE PËR NËPUNËSIT PUBLIKË	116

Lista e shkurtimeve

OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Civile dhe Politike
KNEFDR	Konventa Ndërkombëtare e Eliminimit të të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial
KNESK	Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
CEDAW	Konventa kundër të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave ¹
KPAK	Konventa e Personave me Aftësi të Kufizuar
KDF	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
KiE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese
ASPА	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ²
KDIMDP	Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
BE	Bashkimi Evropian

1 Eshtë përdorur shkurtimi i termave në anglisht për këtë Konventë për shkak të ndërkombëtarizmit që ka përdorimi i saj në anglisht "Convention on the Elimination of all Forms of Discrimination Against Women", i shkurtuar.

2 Eshtë përdorur shkurtimi ligjor ASPA, i parashikuar nga Ligji për Nëpunësin Publik, në nenin 8 për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. Kjo buron nga emërtimi në anglisht ("Albanian School for the Public Administration").

Shkurtime e ligjeve

1. Ligji nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”- **Ligji për Etikën**
2. Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me ligjin nr.178/2014 - **Ligji për Nëpunësin Civil**
3. Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” - **Ligji për të Drejtën e Informimit**
4. Ligji nr.9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 si dhe me ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” - **Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**
5. Ligji nr.10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” – **Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi**
6. Ligji nr.8510, datë 15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, ndryshuar me Ligjin nr.10005, datë 23.10.2008 – **Ligji për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore**
7. Ligj nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” – **KPA³**
8. Ligji nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” - **Ligji për Administratën Shtetërore**

3 Në këtë Manual, i referohemi KPA së re, që hyn në fuqi 1 vit pas botimit në Fletore Zyrtare. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr.87/2015, me datë 28 maj 2015, dhe për rrjedhojë, hyn në fuqi me 28 maj 2016. Kodi i vjetër i Procedurave Administrative, e cila hyri në fuqi në vitin 1999, është e zbatueshëm deri në atë datë.



I. Prezantimi i manualit

Administrata publike shqiptare, si çdo institucion tjetër në Shqipëri, po ndryshon në mënyrë rrënjësore gjatë zhvillimeve demokratike të dekadave të fundit. Në veçanti, me miratimin e Ligjit për Nëpunësin Civil synohet krijimi i “një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike” (neni 1/1).

Në nenin 8 të tij, Ligji për Nëpunësin Civil krijon Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, një institucion publik qendror, i cili *“ka për qëllim formimin profesional të nëpunësve civil, si dhe çdo individ tjetër, vendas ose të huaj, që nuk është pjesë e shërbimit civil”,* por që *“plotëson kriteret e kërkuara”* (neni 8/2).

Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, jo vetëm që është një nga shtyllat e shoqërisë demokratike dhe moderne, por përbën element të rëndësishëm të profesionalizmit të administratës publike. Për këto arsye, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) ka përgatitur dhe u ofron nëpunësve të të gjithë niveleve këtë Manual Shpjegues për Administratën Publike (Manuali), i cili trajton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe përmban shembuj praktikë dhe raste për ilustrim dhe diskutim, duke u përqendruar tek disa të drejta dhe sit-

uata që prekin më shumë administratën publike në veprimtarinë e përditshme të saj.

Manuali mund të ndahet sipas kapitujve në një kurs trajnimi për nëpunësit civilë por edhe mund të lexohet dhe të konsultohet lirisht, si një “Vademecum” me informacion për të drejtat themelore të njeriut duke ofruar këshilla praktike për situata të ndryshme eventuale.

Gjithashtu, edhe pse u drejtohet nëpunësve të administratës publike, Manuali mund të jetë i vlefshëm për cilindo, pasi përmban këshilla që mund të jenë orientuese dhe të vlefshme për zbatim, në marrëdhëniet me administratën publike. Dhe sigurisht, nuk ka shtetas, i cili në një moment të caktuar nuk do të përballlet me administratën publike për përfitimin e shërbimeve të ndryshme.

Manuali ka për qëllim plotësimin e një nevojë edukative të administratës publike për të drejtat e njeriut. Pavarësisht nga lloji i sistemit të aplikuar nga vendi përkatës, ligjshmëria e veprimeve administrative lidhet me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Është e rëndësishme që nëpunësi i administratës publike të njoh paketën e këtyre të drejtave dhe lirive, me qëllimin për të realizuar gëzimin efektiv të tyre nga qytetarët dhe pse jo, edhe nga nëpunësit vetë.

Konkretisht, Manuali ka disa qëllime të ndërlidhura edukative. Nëpërmjet tij, synohet që:

- » Nëpunësit civilë (dhe çdo lexues) të marrin njohuritë bazë për kuptimin dhe rëndësinë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- » Nëpunësit civilë të marrin njohuri të thelluara për disa të drejta, të cilat prekin më shumë veprimtarinë e përditshme të administratës publike, siç janë p.sh. barazia përpara ligjit (mos diskriminimi), e drejta për informim dhe e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale;
- » Nëpunësit civilë të mësojnë se si mund të shmangin shkeljet e të drejtave të individëve, të cilat mund të çojnë në ankime kundër tyre ose edhe në padi në gjykatë;
- » Nëpunësit civilë të mësojnë strategji të ndryshme për trajtimin e situatave delikate të lidhura me komunikimin si, fyerjet, grindjet ose dhe më keq, me qëllim që të mos përshkallëzohen në shkelje të të drejtave të njeriut;
- » Nëpunësit civilë do të ftohen të reflektojnë përmes çështjeve të ndërvarura, të sjelljes korrekte dhe të etikës, si dhe të të drejtave të njeriut;
- » Nëpunësit civilë të kuptojnë se, edhe pse me disa kufizime që burojnë nga funksioni i tyre publik, edhe ata duhet të gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore si çdo individ tjetër.

Manuali është i ndërtuar në 10 kapituj. Pas kësaj parathënieje, është prezantuar një hyrje njohëse me të drejtat e njeriut, kategorizimin e tyre, si dhe zhvillimin e konceptit në kohën tonë (*Kap. II*).

Vazhdohet me përshkrimin e akteve kryesore, të cilat janë të detyrueshme për çdo individ, d.m.th., Kushtetuta e vitit 1998 si dhe

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, me qëllim informativ, përmenden shkurtimisht dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare në këtë fushë, kryesisht instrumente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (*Kap.III*).

Në kapitullin e katërt, rëndësi e veçantë i kushtohet kontekstit shqiptar në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Këto të drejta dhe liri janë universale, por nuk mund të zbatohen në mënyrë identike në shoqëritë me kultura dhe tradita të ndryshme. Nuk mjafton që të radhiten dispozitat e dokumenteve të sipërmendura, pa ia përshtatur ato terrenit praktik në fjalë.

Sigurisht, asnjëherë nuk mund të justifikohen shkelje të dukshme siç janë, p.sh., tortura, dhuna, mohimi i të drejtave të një grupi të caktuar, etj. Synimi ynë gjithmonë duhet të jetë në drejtim të krijimit të “kulturës së të drejtave të njeriut”, dhe kjo nënkupton etikën, respektimin e dinjitetit të çdo individi, si dhe një tërësi elementesh të lidhura me to.

Kapitujt vijues përqendrohen tek të drejtat e prekura dhe situatat e hasura më shpesh në kontaktet e publikut me nëpunësit e administratës publike. E para është e drejta e mos diskriminimit, për të cilën është miratuar një ligj i posaçëm (2010), i cili krijoi institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me kompetenca të gjera në këtë fushë. Më pas vjen e drejta e informimit, e parashikuar me ligj që nga viti 1999, por tani me një ligj tjetër më të ri (2014) dhe me mbrojtjen e kësaj të drejte nga Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Siç shihet nga emërtimi, kjo zyrë merret edhe me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të jetës private, (*Kap.V- VII*).

Në Manual janë përfshirë të drejta të natyrës procedurale dhe substanciale, duke pasur në vëmendje dy aspekte: procedimin administrativ si proces, si dhe fushën konkrete problematike, ku qytetarët janë të prekur më shumë, si prona, arsimit dhe shëndeti. Qëllimi është ndërgjegjësimi për respektimin dhe bërjen efektive të këtyre të drejtave.

Kështu, në kapitullin e tetë shtjellohen disa të drejta procedurale të individëve, në kontekstin e procedurës administrative: si p.sh. e drejta e aksesit, e drejta për t'u dëgjuar, e drejta për kohëzgjatje të arsyeshme të procedurave, si dhe aspekte të tjera të lidhura me veprimtarinë administrative.

Kodi i ri (2015) i Procedurave Administrative do të jetë pjesë e analizës për raportet që ka me të drejtat themelore të njeriut. Po në këtë kapitull vëmendje e posaçme do t'u kushtohet edhe të drejtave substanciale, si e drejta e pronës, e drejta për arsimim dhe e drejta për kujdes shëndetësor (*Kap. VIII*).

Manuali përmban edhe një kapitull, i cili thekson faktin që edhe nëpunësit civilë të administratës publike i gëzojnë të drejtat e liritë themelore, edhe pse me disa kufizime, të cilët burojnë nga natyra e marrëdhënies së tyre të punësimit me shtetin. (*Kap. IX*).

Në përfundim, Manuali përmbillet me disa konkluzione dhe 10 këshilla praktike për nëpunësit civilë të administratës publike.

Ndërkohë duam të theksojmë, se qëllimi i Manualit është të jetë i kuptueshëm dhe i aksesueshëm për të gjithë nëpunësit e administratës publike. Nga shembujt e dhënë për ilustrim janë hequr elementë teknikë dhe juridikë, pikërisht për t'i bërë të kuptueshëm dhe të aplikueshëm për diskutim praktik.

Nga ana tjetër, duhet mbajtur në konsideratë që një tërësi shkeljesh administrative nga ana e nëpunësve publikë mund të përbëjnë dhe vepër penale, (p.sh. ngacmimi seksual, abuzimi me pushtetin, dhuratat në kushtet e palejuara të ligjit), por trajtimi me qasje penale është përjashtuar nga ky Manual, duke i dhënë konsiderata të rëndësishme trajtimit nga pikëpamja e disiplinës së të drejtës administrative.

Në fushën e të drejtave dhe liritë të njeriut, si dhe në shumë fusha të tjera të së drejtës, "përgjigjet" ose "zgjidhjet" nuk janë të prera. Siç do të lexoni në Manual, edhe pse parimet bazë të të drejtave dhe liritë themelore janë të qarta, situata konkrete, në shumicën e rasteve, mund të trajtohen në mënyra të ndryshme.

Shpresojmë se Manuali jo vetëm do t'ju informojë për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, por së pari, do t'ju nxis të mendoni thellë për kulturën shqiptare të të drejtave të njeriut dhe se si mund të trajtohen sa më mirë, ndërmjet disa alternativave, situatat që lindin në veprimtarinë e përditshme të administratës publike.

*Ju urojmë lexim të mbarë dhe
diskutim të frytshëm!*

Kathleen Imholz dhe Elsa Toska

Metodologjia

Manuali siguron informacion rreth legjislacionit kombëtar dhe instrumenteve ndërkombëtare, si dhe në një formë të përmbledhur jurisprudencën e gjykatave për standardet e të drejtave të njeriut dhe respektimin e tyre nga administrata publike gjatë veprimtarisë së saj. Ai përmban këshilla praktike, tema për diskutim, çështje studimore si dhe shënime për t'u pasur në konsideratë nga nëpunësit civilë gjatë përbushjes së funksioneve të tyre.

Manuali përmban referenca dhe bibliografi të pasur, e cila mund të konsultohet, nëse përdoruesit do të jenë të interesuar për t'u thelluar më shumë në nen çështje specifike.

Për të konceptuar këtë Manual dhe për të përcaktuar strukturën, përfshirjen e problematikave, çështjet kryesore mbi të drejtat e njeriut, si dhe përgatitjen finale, u përdorën disa metoda, të përmbledhura shkurtimisht si vijon.

U diskutua problematika në takime dhe konsultime të shumta, brenda dhe jashtë administratës publike, u identifikuan dhe u grumbulluan shembuj nga situata aktuale që janë hasur ose që mund të lindin, me qëllim që Manuali të jetë sa më praktik dhe jo teorik.

Është rishikuar legjislacioni në fuqi për sa i përket veprimtarisë së nëpunësve civilë të administratës publike si dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese shqiptare dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe të detyrimeve për respektimin e tyre nga administrata publike.

Në fund, janë përzgjedhur burimet e bollshme nga literatura vendase dhe ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, me qëllim, që përdoruesit, të cilët duan të hyjnë më thellë në tematikën e Manualit të kenë këtë mundësi lehtësisht të gjindshme.

Si mund të përdoret ky Manual?

- » Si një tekst mësimor për nëpunësit civilë, të cilët marrin pjesë në trajnimin e Shkollës Shqiptare për Administratën Publike (ASPÀ);
- » Si një guidë mësimore për trajnerët e nëpunësve civilë, të cilët do të drejtojnë kurset e ASPÀ-së;
- » Si një mjet reference për nëpunësit civilë, që tashmë kanë ndjekur kursin e trajnimit për të drejtat e njeriut pranë ASPÀ-së;
- » Si një referencë e përgjithshme për çdo njeri, që ka nevojë për informacion dhe këshilla praktike mbi të drejtat themelore në situata të ndryshme eventuale.

Tre objektiva bazë formojnë themelin e programeve për të drejtat e njeriut, për sa vijon:

- » **Përfitimi i informacioneve për** standardet e të drejtave të njeriut dhe si mund të zbatohen ato në praktikë në veprimtarinë e përditshme të nëpunësit civil;
- » **Përfitimi dhe forcimi i njohurive dhe aftësive të kërkuara**, me qëllim që detyrat dhe funksionet e nëpunësit civil të mund të realizohen

me efektivitet duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut;

- » **Ndërgjegjësimi** në lidhje me qëndrimet dhe sjelljen negative ose përforcimin e qëndrimeve dhe sjelljes pozitive.

Thjesht njohuritë nuk mjaftojnë për t'u mundësuar të trajnuarve t'i kthejnë rregullat në sjellje të duhura profesionale duke shmanjur çdo problem me qytetarët që u shërbejnë. Përfitimi i njohurive duhet parë si proces; prandaj dhe njohuritë duhet të konsolidohen përmes reflektimit, praktikës dhe zbatimit.

Pas identifikimit të fushave specifike, ku nëpunësit ushtrojnë veprimtarinë e tyre, mund të jetë e nevojshme që procesi të vazhdohet duke përgatitur trajnime të veçanta.

Më poshtë, sugjerojmë disa hapa për zhvillimin e trajnimeve duke përdorur Manualin.

- » **Prezantim i standardeve** – Jepet një prezantim i shkurtër për të drejtat e njeriut, të domosdoshme për t'u njohur në një fushë të caktuar, ku nëpunësit civilë veprojnë, dhe si mund të zbatohen me efektivitet prej atyre. Prezantimi duhet përshtatur, sipas fushave ku punojnë nëpunësit e administratës publike (tatimet, gjendja civile, ndihma ekonomike, etj).
- » **Fokus dhe fleksibilitet** – Pjesëmarrësve u mundësohet të përqendrohen në çështje reale dhe aktuale sipas rastit dhe fushës së veprimtarisë. Trajnerët duhet të përshtatin nevojat e të trajnuarve me vazhdimin e mëtejshëm të programit të trajnimit.
- » **Zgjidhje të problemeve nëpërmjet diskutimeve** – Kjo metodë, mund të realizohet si një ushtrim intensiv, për të kërkuar zgjidhje të mundshme për aspektet teorike dhe praktike. Të trajnuarve u jepet një problem ose situatë për ta analizuar dhe për të dhënë zgjidhje të ndryshme. Kjo është një metodë për të nxitur pjesëmarrjen aktive. Të gjitha idetë e shfaqura për zgjidhje mund të mbahen shënim në një tabelë ose *flip chart*. Nuk ka nevojë të jepen gjykime ose të bëhen ndërhyrje.

Trajneri/drejtuesi më pas mund të kategorizojë dhe analizojë përgjigjet, të cilët mund të diskutohen, të kombinohen dhe të përshtaten. Në përfundim, grupi i të trajnuarve mund të bëjë vërejtje dhe të vendosë zgjidhjen më të mirë, sipas atyre.

- » **Punë në grup** - Kjo metodë zbatohet duke i ndarë pjesëmarrësit në grupe të vogla nëpunësish civilë, maksimumi 5 ose 6 veta. Çdo grupi i jepet një temë për diskutim, një problem për zgjidhje ose diçka konkrete për të krijuar, brenda një kohe të caktuar, (gjysmë ore ose pak më shumë). Trajneri/drejtuesi shkon herë pas here pranë çdo grupi për t'i stimuluar ose për t'i orientuar ata. Më pas, grupet mblidhen sërish dhe rezultatet e çdo grupi prezantohen nga një përfaqësues i zgjedhur. Pjesëmarrësit mund të diskutojnë të gjithë bashkë për temën apo punën e kryer nga grupet e vogla.
- » **Simulime (role-playing)**- Në këtë metodë, pjesëmarrësit luajnë role në një situatë të përshkruar nga trajneri/drejtuesi. Ata duhet të interpretojnë sjelljen siç mund të veprohet në realitet. Qëllimi është që nëpunësit të provojnë situatat e zakonshme ose të mundshme të hasur në punën e përditshme. Nëpunësit e tjerë në kurs vëzhgojnë dhe komentojnë.
- » **Raste studimore (kazuse)** - Kjo metodë përdor raste imagjinare por të besueshme dhe realiste, të cilat përqendrohen në dy ose tre çështje kryesore. Nëpërmjet tyre, u kërkohet nëpunësve civilë të ushtrojnë aftësitë profesionale, duke iu përgjigjur pyetjeve të shtruara në kazuse, në lidhje me të drejtat themelore të njeriut dhe standardet që duhen zbatuar në rastin konkret.⁴

⁴ Kjo listë është bazuar tek sugjerimet e publikimit të OKB-së, "Human Rights Training, "A Manual on Human Rights Training Methodology", Professionals Training Series no.6, United Nations" [Manual mbi metodologjinë e trajnimeve të të drejtave të njeriut, Seritë e Trajnimit Profesional nr.6], ISBN 1020-16888, 2000, fq. 3-5, e disponueshme online:<http://www.ohchr.org/Documents/Publications/training6en.pdf>. vizituar me datë 15.11.2015

II. Çfarë janë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut?

Këto metoda mund të kombinohen ose të përdoren veçmas, sipas rastit, për t'i bërë kurset sa më interesante dhe sa më të vlefshme për pjesëmarrësit.

2.1. Disa konsiderata të përgjithshme

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të drejta, të cilat i përkasin çdo njeriu që nga lindja. Ato nuk 'fitohen' dhe nuk varen nga statusi i individit në fjalë. Ato janë universale, të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme, d.m.th.:

Universale – Të drejtat dhe liritë themelore u përkasin të gjitha qenieve njerëzore, në mënyrë të barabartë dhe pa u diskriminuar për asnjë shkak apo arsye. Ky parim është parashikuar në nenin 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilit: *“Të gjithë njerëzit janë të lindur të lirë, me dinjitet dhe të drejta të barabarta”*. Universaliteti i të drejtave nuk prek diversitetin e individëve ose të kulturave të ndryshme. Universaliteti nuk do të thotë uniformitet.

Të pandashme dhe të ndërvarura – I referohet faktit se të gjitha të drejtat kanë rëndësi; ato duhet të konsiderohen kolektivisht, dhe nuk duhet të ndahen. Parimi i ndërvarësisë, nënvizon sidomos faktin se të drejtat janë të ndërlidhura me njëra - tjetrën dhe mosrealizimi i një të drejte mund të sjellë mohimin

ose mosrealizimin e një të drejte tjetër.

Të patjetërsueshme dhe të padhunueshme – I referohet faktit që të drejtat e njeriut nuk mund t'i hiqen apo t'i mohohen askujt, qoftë edhe me pëlqimin dhe miratimin e tij, dhe asnjëri nuk mund të heqë dorë nga këto të drejta⁵.

Duhet theksuar se koncepti “Të drejtat e njeriut” nuk është parim thjesht deklarativ. Të drejtat janë të detyrueshme për realizim në natyrën e tyre, dhe duhen gëzuar nga të gjithë individët.

Në këndvështrimin e mësipërm, nënvizojmë fjalët e Deklaratës së Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut dhe Planin e Veprimit të Vjenës (1993), ku afirmohet në paragrafin e pestë se: *“Të gjitha të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, të ndërvarura dhe ndërlidhura. Komuniteti ndërkombëtar duhet t'i trajtojë ato në të gjithë botën në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë, me të njëjtën rëndësi dhe më të njëjtën peshë”*.

2.2 Kategorizimi i të drejtave të njeriut

Të drejtat e njeriut, edhe pse janë të pandashme siç u theksua më lart, mund të kat-

⁵ Nga Manuali “Human rights for Social Workers in Theory and Practise”, [Manual trajnimi “Të Drejtat e Njeriut në Teori dhe Praktikë” për Punonjësit Socialë, Bosnjë- Hercegovinë], Misioni i OSBE në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2010, Kapitulli – Hyrje në të drejtat e njeriut, nënçështja 1.1.1 - Karakteristikat e përgjithshme të të drejtave të njeriut, fq.12, i disponueshëm online: <http://www.osce.org/bih/110217?download=true>, vizituar me datë 12.10.2015.

egorizohen në tre ‘gjenerata’ ose lloje të të drejtave: *së pari*, të drejtat civile dhe politike, ndryshe të njohura si të drejta tradicionale; *së dyti* të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, dhe *së treti*, të drejtat e solidaritetit/ të drejtat e popujve, të cilat nuk mund të gëzohen individualisht, por në grup dhe duhet bashkëpunim dhe koordinim ndërkombëtar midis vendeve.

Manuali përqendrohet në *dy kategoritë e para*, dhe siç do të shohim më poshtë, edhe Kushtetuta shqiptare bën një diferencim të tillë.

Kategoria e dytë, të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore kanë natyrë ‘progresive’, pasi për realizimin e tyre kërkohen burime dhe infrastrukturë financiare, karakteristika të cilat ndryshojnë nga shteti në shtet. Pra, për to nuk mund të kërkohet realizim i menjëhershëm, si me të drejtat civile dhe politike. Gjithsesi, edhe pse zbatimi i plotë ka natyrë progresive, kjo nuk ndryshon detyrimin e shtetit për t’i realizuar ato.

Një ndarje tjetër për të drejtat është se ato mund të konsiderohen *pozitive* dhe *negative*. Në të parat, shteti duhet të ndërhyjë që individi t’i gëzojë ato, p.sh. e drejta për informim, e drejta për ambient të shëndetshëm, ndërsa në të dytat mjafton që të mos ndërhyjë shteti që individi t’i gëzojë i qetë, p.sh. e drejta e besimit fetar, liria e shprehjes.

Disa të drejta mund të jenë *negative* dhe *pozitive* njëkohësisht, p.sh. e drejta për punë është pozitive, pasi shteti duhet të ndërmarrë veprime për punësimin e njerëzve dhe mbrojtjen e tyre në punë, por është dhe negative se individi duhet të jetë i lirë të zgjedhë punën që dëshiron të bëjë. Po kështu dhe e drejta për arsimim është pozitive, pasi shteti ndërhyr tek arsimi fillor si arsim i detyrueshëm, por është negative se individi mund të zgjedhë të arsimohet, si dhe ku të dëshirojë, pa

asnjë lloj ndërhyrjeje nga shteti.

Gjithashtu, të drejtat mund të ndahen në *individuale* dhe *kolektive*. Në të parat përfshihen të gjitha të drejtat që lidhen me sferën e integritetit fizik e personal të njeriut si qenie njerëzore, dhe që ushtrohen individualisht, si e drejta e jetës, fshehtësia e korrespondencës dhe shumë të tjera. Në të dytat, përfshihen ato të drejta dhe liri që ushtrohen në grup, pavarësisht se lidhen drejtpërdrejt me personin, si liria e tubimit, liria e organizimit, e drejta e grevës, etj. Ka liri dhe të drejta që mund të jenë personale dhe kolektive, si p.sh. liria e besimit fetar me dy aspektet e saj; liria për të besuar dhe liria për ta ushtruar besimin me të tjerët.

Nga ana tjetër, duhet mbajtur parasysh se të drejtat mund të konkurrojnë me njëra-tjetrën. Ka “*konflikt të të drejtave*” p.sh. kur e njëjta e drejtë duhet t’i njihet dy personave të ndryshëm. Për shembull, një pacient ka nevojë për një transplant zemre ashtu si dhe një tjetër, por në dispozicion është vetëm një zemër. Në këtë rast, e drejta për jetën e një personi konkurren me të njëjtën të drejtë të një personi tjetër.

Një hipotezë tjetër, është kur për një person konkurrojnë dy të drejta të ndryshme, si p.sh. në rastin e eutanazisë, kur e drejta për të jetuar konkurren me të drejtën për të zgjedhur “të vdesë” ose për të mos u trajtuar në mënyrë degraduese⁶.

Një hipotezë e tretë, e cila haset shpesh në praktikë, do të ishte kur të drejta të ndryshme konkurrojnë për njerëz apo kategori të ndryshme njerëzish. Për shembull, e drejta

6 *Shih çështjet Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuara*, aplikimi nr. 2346/02, vendim i GJEDNJ i datës 29 prill 2002; *Alda Gross kundër Zvicrës*, aplikimi nr. 67810/10, vendim i GJEDNJ i datës 14 maj 2013.

për t'u shprehur dhe liria e shtypit për gazetarët, konkurrenca me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale të individëve të caktuar, subjekt të lajmit konkret; ose kur e drejta e dikujt për të shprehur idetë e tij për besimet fetare në publik, konkurrenca me të drejtën e personave të tjerë, që të respektohen dhe të mos cenohen në të drejtën e besimit⁷.

Megjithatë, theksojmë se të gjitha të drejtat themelore të njeriut janë të rëndësishme. Nuk ka të drejta “më pak” të rëndësishme dhe “më shumë” të rëndësishme.

Më poshtë do të prezantojmë një grafik të përmbledhur të të drejtave të njeriut, sipas një manuali të Këshillit të Evropës⁸. Skema ofrohet për të rritur njohuritë për konceptin e të drejtave dhe çështjeve të lidhura me to, disa prej të cilave mund të mos jenë të menduara më parë si tematika të lidhura me të drejtat e njeriut. Njëkohësisht, skema ofrohet për të rritur ndërgjegjësimin për tërësinë e fushës së të drejtave të njeriut dhe qasjen globale që mund të mbahet ndaj tyre.

USHTRIMI NR. 1

Nëpunësit civilë që ndjekin kursin ndahen në grupe të vogla prej 5-6 vetash, dhe u kërkohet të zgjedhin dy temat më të njohura dhe dy temat më pak të njohura për ta, referuar skemës së mëposhtme, duke iu lenë kohën përkatëse për të diskutuar mbi to dhe për të shprehur pikëpamjet e tyre personale mbi problematikat e të drejtave të njeriut sipas tematikës.

Më pas, ata ftohen të prezantojnë shkurtimisht njohuritë për dy temat e zgjedhura më të njohura. Në lidhje me dy temat më pak të njohura që kanë zgjedhur, trajnuesi/drejtuesi ofron ndihmën e vet, duke iu drejtuar pyetje apo duke i orientuar drejt temës përkatëse. P.sh. n.q.s. globalizimi zgjidhet si më pak i njohur, trajneri mund të pyesë për lidhjen që ka me drejtat e njeriut, a ndikon pozitivisht ose negativisht tek të drejtat e njeriut, p.sh. shkëmbimet tregtare si ndikojnë tek të drejtat ekonomike, tek e drejta për punë, etj.

7 Shih, p.sh. çështjen Aydın Tatlav kundër Turqisë, aplikimi 50692/99, prg. 26, vendim i GJEDNJ, i datës 2 maj 2006. Në vitin 1992, Aydın Tatlav, një gazetar në Stamboll, publikoi një libër për fenë islame dhe u dënua për fyerje ndaj një sektit islam. Ai u ankua pranë GJEDNJ për dhunim të lirisë së shprehjes. Kjo gjykatë vlerësoi nëse ndërhyrja ndaj së drejtës së aplikuesit ishte e “nevojshme në një shoqëri demokratike”. GJEDNJ vendosi se disa pasazhe të librit përmbanin kritika të forta ndaj fesë në një kontekst socio-politik, por ato nuk kishin tone ofenduese si dhe nuk përmbanin sulme abuzive ndaj muslimanëve apo ndaj simboleve të fesë së tyre. Për rrjedhojë, e drejta e tij për lirinë e shtypit prevaloi.

8 Nga Compass, “Manual for human rights education with young people” [Manual për edukimin e të rinjve mbi të drejtat e njeriut], Këshilli i Europës, publikim i rishikuar dhe përditësuar, tetor 2012, i disponueshëm online: http://www.coe.int/t/dg4/eycb/Source/Compass_2012_FINAL.pdf, vizituar me datë 10.10.2015

Nëpunësit civilë në kurs, zgjedhin një grup prej tyre të aktrojnë në një situatë, ku drejtuesi i një gazete dhe stafi i tij takohen me disa anëtarë të pakicave kombëtare, të cilët ankohen për mbulimin e pakët që media i bën aktiviteteve të komunitetit të tyre. Ata pretendojnë midis të tjerave se gazetarët i kanë dhunuar të drejtën për privatësi, duke përhapur informacion rreth rriteve të tyre fetare, përfshirë dhe akuza se ata përdorin lëndë narkotike gjatë ritualeve

Gjithashtu, ata pretendojnë se gazetarët i kanë bërë subjekt talljeje nga publiku dhe kanë nxitur urrejtje me gjuhën helmuese, që kanë përdorur në njoftimet dhe pasqyrimet në shtyp. Gazetarët mbrohen duke thënë se “publiku ka të drejtë të dijë”, dhe se gjithçka që ata kanë raportuar është e vërtetë dhe jo e ekzagjeruar.

Pjesëmarrësit janë të lirë të ngrenë argumente dhe kundër argumente nga të dyja anët e situatës, qoftë duke përkrahur të drejtën e pakicave, qoftë duke përkrahur lirinë e shtypit. Trajneri mund të shpjegojë se edhe pse në këtë rast nuk është e përfshirë administrata publike, ky është një shembull se si të drejtat konfliktohen me njëra-tjetrën dhe se nuk ka vetëm një “përgjigje të saktë”. Gjithashtu, të gjithë pjesëmarrësit ftohen të japin komentet e tyre për situatën.

Trajneri/drejtuesi i vë në dispozicion grupit nenin 59 të Kushtetutës, (Objektivat Sociale), duke i shpjeguar se ato janë disa nga të drejtat e “gjeneratës së dytë”, të sqaruara në Manual. Kjo dispozitë lexohet me zë të lartë, dhe secilit pjesëmarrës të grupit, i jepet detyra të diskutojë shkurtimisht për “objektivat socialë”, nisur nga eksperiencia personale, sa i njeh, si ka punuar në fushën përkatëse, cilat janë problemet me këto të drejta dhe si trajtohen nga legjislacioni shqiptar. Për shembull, “përkujdesi dhe ndihma për të moshuarit sipas nenit 59/e”, mund të diskutohet për azilet, pensionet e ulëta dhe mungesën e kujdesit shëndetësor të mjaftueshëm.

Trajneri duhet të theksojë se qëllimi i këtij ushtrimi nuk është “të zgjidhim” problemet ekzistuese, ose t’i lidhim “objektivat socialë” me veprimtarinë e administratës publike, por për t’i ndihmuar nëpunësit të kuptojnë se edhe pse jo të gjitha të drejtat mund të zbatohen plotësisht, për shkak të kufizimeve buxhetore, gjithsesi ato janë të drejta dhe shteti shqiptar ka marrë përsipër t’i përmbushë ato.



Të drejtat e njeriut sipas 20 tematikave botërore*:

* Nga *Compass*, "Manual for human rights education with young people" [Compass, Manual për edukimin e të rinjve mbi të drejtat e njeriut] Këshilli i Evropës, botim i rishikuar dhe përditësuar, tetor 2012, Kapitulli I - Edukimi me të drejtat e njeriut dhe Compass- Hyrje; nen çështja- Të drejtat e njeriut sipas tematikave, fq.46.

2.3. Të drejtat e njeriut dhe dinjiteti njerëzor

Aspirata për të mbrojtur dinjitetin e të gjitha qenieve njerëzore, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo aspiratë është e bazuar në sistemin e përbashkët universal të vlerave dhe ofron një kornizë për ndërtimin e sistemit të të drejtave të njeriut, të mbrojtur nga normat dhe standardet e pranuar ndërkombëtare. Ky parim ka rëndësi të veçante në marrëdhëniet e administratës publike me qytetarët.

Dy vlerat kryesore, në qendër të idesë së të drejtave të njeriut, janë **dinjiteti njerëzor** dhe **barazia**. Respektimi i këtyre të drejtave pashall në mënyrë të pashmangshme respektimin për të drejtat e tjera.

Më poshtë, radhiten disa vlera të tjera që rrjedhin nga dy vlerat kryesore. Ato mund të na orientojnë se si në praktikë njerëzit dhe shoqëritë mund të bashkëjetojnë.

Liria: sepse vullneti është pjesë e rëndësishme e dinjitetit njerëzor. Nëse individi do të detyrohej të vepronte kundra vullnetit do të ishte dhunim i dinjitetit të tij njerëzor.

Respekti për të tjerët: sepse mungesa e respektit për tjetrin është dështim për të vlerësuar dinjitetin dhe individualitetin.

Mos-diskriminimi: sepse barazia në dinjitetin njerëzor do të thotë që të mos dallohen njerëzit në të drejta dhe mundësi, bazuar tek karakteristikat e tyre.

Toleranca: sepse toleranca tregon respekt për dallimet midis njerëzve; duke marrë parasysh në çdo rast se barazi nuk do të thotë uniformitet.

Drejtësia: sepse duke qenë të barabartë, të

gjithë njerëzit meritojnë trajtim të drejtë.

Përgjegjshmëria: sepse respektimi i të drejtave të të tjerëve kërkon përgjegjshmëri të veprimeve dhe përpjekje për realizim si të një personi të vetëm ashtu dhe të të gjithëve⁹.

Për të gjitha këto arsye, nëpunësit e administratës publike duhet të kenë në qendër të veprimeve të tyre mbrojtjen e dinjitetit të çdo njeriu.

2.4 Çdo të thotë dhunim i të drejtave të njeriut?

Koncepti “dhunim i të drejtave të njeriut”, përfshin veprimet dhe mosveprimet agresive të shtetit dhe individëve ndaj të drejtave të garantuara nga Kushtetuta, aktet kombëtare të tjera dhe aktet ndërkombëtare. Kemi dhunimin e një të drejte kur një ligj, politikë apo praktikë, qëllimisht ose jo vepron kundër detyrimeve ose injoron detyrimet e marra nga shteti, si dhe kur shteti nuk arrin standardin e kërkuar në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, shkeljet shfaqen kur shteti shmang nga sistemi i brendshëm mjetet apo mekanizmat mbrojtës kundër shkeljeve.

Për sa u përket të gjithave të drejtave të njeriut, si ato civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale, shteti ka tre lloje detyrimesh:

(i) detyrimin për t'i respektuar të drejtat, që do të thotë shteti nuk duhet të ndërhyjë dhe të dhunojë ato;

(ii) detyrimin për t'i mbrojtur të drejtat, që do

9 Shih Compass, “Manual for human rights education with young people” [Manual për edukimin e të rinjve për të drejtat e njeriut], botim i rishikuar dhe përditësuar, Këshilli i Europës, tetor, 2012. Kapitulli IV- Kuptimi i të drejtave të njeriut, nënçështja “Vlerat kryesore”, fq.383, vizituar me datë 10.10.2015.

të thotë që shteti duhet të parandalojë aktorët jo-shtetërorë nga ndërhyrjet që pengojnë gëzimin e tyre;

(iii) detyrimin për t'i mundësuar realizimin e të drejtave, që do të thotë se shteti duhet të veprojë në mënyrë aktive që të drejtat të plotësohen dhe të gëzohen nga individët¹⁰.

Nëse shteti nuk plotëson këto detyrime atëherë jemi para shkeljes së të drejtave të njeriut.

2.5 Formësimi i kulturës së të drejtave të njeriut

Përveç sanksionimit të të drejtave në aktet ligjore, është thelbësore për shoqërinë shqiptare të zhvillohet një kulturë e të drejtave të njeriut.

Në nenin 26/2 të DUDNJ-së¹¹, theksohet se: *“Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”*.

Me fjalë të tjera, edukimi për të drejtat e njeriut duhet të konsiderohet si një e drejtë më vete. Vetëm me një edukim të tillë mund të krijohet kultura e përshtatshme, ku të drejtat themelore të njeriut jo vetëm të parashikohen në tekstet ligjore, por të mishërohen dhe jetohen.

Në Rezolutën 66/137, Deklaratë e Kombeve të Bashkuara për edukimin dhe trajnimin e të drejtave të njeriut, e 19 dhjetorit 2011, përkufizohet: *“Edukimi për të drejtat e njeriut”* si:

10 Manual on Monitoring Human Rights, Professional Training Series [Manual mbi Monitorimin e të Drejtave të Njeriut], Seritë profesionale të trajnimit nr.7, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, OKB, 2001, Kapitulli I - Hyrja, nënçështja “Përkufizimi i termave kryesorë”, fq.10, i disponueshëm on-line: <http://www.ohchr.org/Documents/Publications/training7Introen.pdf>, vizituar me datë 30.09.2015.

11 Shkurtime që janë përdorur në Manual, janë shpjeguar në fund të tij në pjesën “Përkufizime, fjalorth, sqarime”, por gjithashtu edhe në brendësi të tekstit. “DUDNJ” është Deklarata Universale e së Drejtave të Njeriut, një nga instrumentet bazë në këtë fushë

“Trajnim, shpërndarje dhe përpjekje për informim, përmes transmetimit të diturisë dhe aftësive, me qëllim të ndërtimit të kulturës universale për të drejtat e njeriut, si dhe krijimit të sjelljeve në drejtim të forcimit të respektimit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe zhvillimit të plotë të personalitetit të njeriut dhe kuptimit të dinjitetit të tij”¹².

Karta Evropiane për Edukimin me Qytetarinë Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, miratuar nëpërmjet Rezolutës CM Rec (2010) 7 të Komitetit të Ministrave të KiE¹³, jep një tjetër përkufizim si:

“Edukim për të drejtat e njeriut do të thotë edukim, trajnim, ndërgjegjësim, forcim, informacion, praktika dhe aktivitete, të cilat kanë për synim që të aftësojnë individët me njohuri, aftësi, dhe të kuptuarit si dhe të zhvillojnë qëndrimet dhe sjellje që forcojnë individët me dëshirën për të kontribuar në ndërtimin, mbrojtjen dhe promovimin e një kulture të të drejtave të njeriut në shoqëri.”

Edukimi për të drejtat e njeriut duhet të përfshijë më tepër se vetëm pjesën informative,

12 Resolution 66/137 United Nations Declaration on Human Rights Education and Training [Rezoluta 66/137, “Edukimi me të drejtat e njeriut e Kombeve të Bashkuara”], miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, datë 19 dhjetor 2011. World Programme for Human Rights Education, second phase 2010-2014. [Plani Veprues i Kombeve të Bashkuara për Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut] faza e dytë, (2010-2014), të disponueshme on-line: <http://www.hurights.or.jp/archives/asia-pacific/section1/pdf/11%20-%20UN%20Declaration%20on%20Human%20Rights%20Education%20and%20Training.pdf> / http://www.ohchr.org/Documents/Publications/WPHRE_Phase_2_en.pdf, vizituar me datë 14.11.2015

13 Charter on Education for Democratic Citizenship and Human Rights Education, Council of Europe, 2010, e disponueshme on-line: <http://www.coe.int/en/web/edc/charter-on-education-for-democratic-citizenship-and-human-rights-education>, vizituar me datë 25.11.2015.

dhe duhet të jetë proces i përhershëm dhe gjithëpërfshirës, në të cilin njerëzit e të gjitha niveleve të zhvillimit dhe shtresave të shoqërisë duhet të mësojnë respektin për dinjitetit e të tjerëve, si dhe mjetet dhe metodat e sigurimit të atij respekti në të gjitha shoqëritë.

Kështu formësohet shoqëria si e tërë, me kulturën e të drejtave të njeriut. Kultura e të drejtave të njeriut merr vlerë kur kuptohet dhe zbatohet nga të gjithë. Edhe pse, sigurisht, përgjegjësia për mbrojtjen e të drejtave të njeriut bie mbi shtetin është e pamundur që çdo rast i mosrespektimit të tyre të vihet re dhe të korrigohet nga autoritetet. Ato që u japin të drejtave të njeriut qëndrueshmërinë të vazhdueshme janë, të kuptuarit dhe respektimi i tyre nga çdo person.

Vlerat kulturore janë të rrënjosura thellë në psikikën e njerëzve dhe të komuniteteve, ku ata jetojnë. Edhe nëse ligjet ndryshojnë, jo domosdoshmërisht, do të ndryshojnë dhe sjelljet e njerëzve dhe qëndrimet e tyre. E kemi parë këtë dukuri shpesh gjatë tranzicionit shqiptar. Duke marrë në konsideratë mungesën e lidhjes mes sjelljes së përditshme të njerëzve dhe teksteve të kushtetutës apo ligjeve, duhet të konsiderohet pyetja se si mund të ndryshohet dhe të ndikohet jeta e përditshme e qytetarëve, për sa u përket vlerave dhe kulturës për të drejtat e njeriut. Kështu, p.sh. si mund të luftohet “abuzimi me pushtetin” rrënjosur thellë në normat e kulturës dhe traditat e një vendi, ose “kultura e korrupsionit”, që shpesh vihet në shënjestër si problem tek shoqëritë në zhvillim, si kjo e Shqipërisë.

USHTRIMI NR. 4	Nëpunësi Y është inspektor mjedisi në Ministrinë X dhe një ditë gjatë kontrollit për respektimin e rregullave mjedisore, shoqëria e inspektuar që po ndërtonte i ofroi një shishe verë të lirë. Ai e pranoi dhuratën. Gjatë një kontrolli të dytë, po nga kjo firmë, iu ofrua përsëri si dhuratë një zarf me 5000 lekë të reja. Ai e pranoi dhuratën.
PYETJE	Si duhet të sillet nëpunësi Y? A duhet refuzuar dhuratata, edhe pse mund të jetë simbolike? Si veprimi ai në lidhje me dhuratën e parë, shishen e verës? Po në lidhje me dhuratën e dytë? Si mund të ndikojë tek imazhi i tij si nëpunës civil përfitimi i dhuratave sa herë që është në kryerje të detyrës në kontakt me publikun? A janë këto praktika normale që vijnë nga një kulturë e konsoliduar shqiptare mbi konceptin “dhuratë”? Po nga pikëpamja ligjore si duhet trajtuar çështja?
OBJEKTIVI	Të diskutohen dhe të kuptohen qasjet e nëpunësve civilë ndaj dhuratave. Ata duhet të ndërgjegjësohen në lidhje me sjelljen ndaj ofrimit të një dhurate, pavarësisht se çfarë vlere ka, si dhe të kuptojnë se secili luan rolin e tij në zbehjen e korrupsionit në administratë publike, pavarësisht pozicionit që mban ¹⁴ .

14 Sipas Vendimit të KM nr.714, datë 22.10.2004 “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”, është përcaktuar një procedurë dhe rregulla sjelljeje ndaj pranimit ose refuzimit të dhuratave si dhe është përcaktuar vlera e dhuratave që mund të pranohen. Nëpunësi i administratës publike nuk duhet të kërkojë ose të pranojë, dhuratata, favore ose çfarëdo përfitim tjetër, ose shmangie të humbjeve të mundshme, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat ka marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare. (Pjesa II- Ofrimi i dhuratave dhe i favoreve, pika 8). Nëpunësi mund të mbajë dhuratata të lejueshme, pa qenë i detyruar t’i deklarojë ato, nëse nuk e kalojnë vlerën prej 10 000 lekësh për dhuratë, ndërsa në rast se dhuratat janë më të kushtueshme, ai duhet t’i deklarojë ato, brenda 30 ditëve, eprorit direkt dhe t’i dorëzojë në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit (pika 14).

Qasja më efektive në drejtim të respektimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut do të ishte ndërmarrja e nismave afatgjata, të cilat përfshijnë dhe edukimin publik – pranë institucioneve siç është ASPA, sigurisht, por edhe më gjerë.

Le të saktësojmë çfarë do të thotë “kultura e të drejtave të njeriut”. Kjo nuk është thjesht një kulturë, ku çdo njeri i di të drejtat e veta, pasi njohuria nuk do të thotë detyrimisht vënia në jetë ose respektimi i tyre. Sigurisht, njohuria është hapi i parë, por pa respekt gjithmonë do të ketë shkelje të të drejtave.

Kultura e të drejtave të njeriut ekziston aty ku njerëzit:

- » kanë njohuri të të drejtave dhe lirive themelore;
- » respektojnë këto të drejta dhe liri;
- » kanë respekt për vete dhe respekt për të tjerët, duke vlerësuar dinjitetin njerëzor të çdo individi;
- » shfaqin qëndrime dhe sjellje, me anë të të cilave tregojnë se kanë respekt për të drejtat e të tjerëve;
- » praktikojnë barazinë gjinore në të gjitha sferat;
- » tregojnë respekt për diversitetin kulturor dhe e vlerësojnë, sidomos atë mbi baza të kombësive të ndryshme, të etnive, feve, gjuhës dhe minoriteteve të tjera;
- » veprojnë si qytetarë në mënyrë aktive;
- » promovojnë demokracinë dhe drejtësinë sociale¹⁵.

Ka qëndrime të ndryshme se cila mund të

jetë mënyra e duhur për të krijuar një kulturë të të drejtave të njeriut. Kuptohet që shoqëritë kanë fillësa të ndryshme, faza të ndryshme zhvillimore, dhe të gjitha këto dallime duhen marrë parasysh.

Gjithsesi, pavarësisht dallimeve nga ku mund të nis procesi i edukimit me të drejtat e njeriut dhe krijimi i kulturës së duhur, ka një dakordësi se duhet të përfshihen tre dimensione:

- » mësimi mbi të drejtat e njeriut: çfarë janë dhe si mbrohen ato;
- » mësimi nëpërmjet të drejtave të njeriut: njohja e historikut dhe mënyra se si të drejtat e njeriut janë strukturuar; si dhe
- » mësimi për të drejtat e njeriut në thellësi, duke zhvilluar aftësi, qëndrime, vlera në mënyrë që njerëzit të mësojnë t'i zbatojnë ato në jetën e përditshme, dhe të ndërmarrin veprime vetëm ose së bashku me të tjerë, me qëllim promovimin dhe mbrojtjen e të këtyre të drejtave¹⁶.

Si të gjithë të tjerët, edhe nëpunësit publikë kanë nevojë për këtë edukim. Në Kartën Evropiane për Edukimin me Qytetarinë dhe të Drejtat e Njeriut, është parashikuar se: “...*të mësuarit për të drejtat e njeriut është një proces afatgjatë jetësor. Të mësuarit efektivisht në këtë fushë përfshin një rreze të gjerë aktorësh: politikë bërësit, mësuesit profesionistë, (...) institucionet e arsimit, nëpunësit publikë...*”¹⁷.

Sigurisht, nëpunësit publikë nuk janë të gjithë juristë. Megjithatë administrata publike duhet të edukohet me standardet e kërkuara kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me

15 Frymëzuar dhe përshtatur nga Compass, “Manual for human rights education with young people” [Manuali për edukimin e të rinjve mbi të drejtat e njeriut] botim i rishikuar dhe përditësuar, Këshilli i Europës, tetor, 2012, Kapitulli I, Pjesa 1- Hyrje në edukimin me të drejtat e njeriut, nen çështja: “Drejt një kulture të të drejtave të njeriut”], fq.27.

16 Po aty, fq.19.

17 Pika 5, shkronja “b” e Kartës Evropiane mbi Edukimin me Qytetarinë dhe të Drejtat e Njeriut. E disponueshme on-line: <http://www.coe.int/en/web/edc/charter-on-education-for-democratic-citizenship-and-human-rights-education>, vizituar me datë 20.10.2015.

njohjen dhe respek-
timin e të drejtave të
njeriut, të cilat duhet

t'i ketë në konsideratë
gjatë veprimtarisë së
saj administrative. Ky

edukim është një hap thelbësor në krijimin e
një administrate publike kompetente dhe pro-
fesioniste.



Në përmbledhje, mund të themi se administrata publike duhet të ketë një familjarizim të gjerë me vlerat dhe parimet, mbi të cilat, janë ngritur standardet e të drejtave themelore të njeriut, duke mundësuar krijimin e kulturës së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri.

III. Të drejtat e njeriut në akte kombëtare dhe ndërkombëtare

3.1 KUSHTETUTA

3.1.1. Disa konsiderata të përgjithshme

Kushtetuta jonë, padyshim promovon vlera demokratike të gjithë pranuar nga vendet evropiane perëndimore dhe demokracitë përparimtare. Në të janë sanksionuar parimet e demokracisë kushtetuese si: shteti i së drejtës, demokracia, pluralizmi, ndarja e pushteteve, të drejtat e njeriut, dinjiteti njerëzor, etj. Duke nisur prej Preambulës identifikohet fryma dhe shpirti që kjo Kushtetutë përçon:

“Ne, populli i Shqipërisë,.... me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik dhe social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut...”....vendosim këtë Kushtetutë”.

Siç thuhet shprehimisht në nenin 15/2 të Kushtetutës, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Të drejtat e njeriut nuk qëndrojnë në vakum; ka mekanizma për mbrojtjen e tyre në qofte se organet e administratës publike i dhunojnë ato gjatë veprimtarisë administrative ose ekzekutive.

Organet e pushtetit publik, gjithashtu duhet të respektojnë parimet dhe vlerat kushtetuese në të gjithë veprimtarinë e tyre drejt ndërtimit dhe respektimit të shtetit të së drejtës. Pa dyshim, administrata publike duhet që të përmbushë objektivat e saj të gjera sipas Kushtetutës. Ajo (edhe pse jo vetëm ajo) duhet:

“...të ndërtojë një shtet të së drejtës, demokratik, social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut...”¹⁸

Administrata publike, si edhe nëpunësit publikë që e përbëjnë atë, nuk i shpëtojnë përgjegjësisë vetjake (kur janë në keqbesim¹⁹), në rast dëmtimi të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve. Kushtetuta përcakton se, kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore²⁰.

Qëllimi i këtij rregullimi në nivel kushtetues është i rëndësishëm, pasi nëpërmjet tij sigurohet përgjegjësia e çdo organi shtetëror, nëse gjykohet se ka shkelur të drejtat e individëve.

3.1.2 Çfarë të drejtash parashikon Kushtetuta?

Kushtetuta në kreun e dytë ka sanksionuar

18 Preambula e Kushtetutës.

19 Shih Ligjin për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore, i cili përfshihet në Shtojcat.

20 Neni 44 i Kushtetutës.

liritë dhe të drejtat vetjake, si: e drejta për jetën, liria e shprehjes, e drejta e informimit, liria e ndërgjegjes dhe e fesë, mostrajtimi në mënyrë çnjerëzore dhe degraduese, moskryerja me detyrim e një pune, përveç rasteve që parashikohen me ligj, mos-heqja e lirisë në kundërshtim me ligjin, mos akuzimi pa të drejtë, mos dënimi fajtor për një vepër penale, e cila nuk ishte e tillë në kohën e kryerjes, mbrojtja e të dhënave personale, fshehtësia e korrespondencës, paprekshmëria e banesës, e drejta e lëvizjes lirisht, e drejta e pronës, e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta e ankimit, e drejta e rehabilitimit në rast të dëmtimit nga veprimet e paligjshme të organeve shtetërore, etj.

Kushtetua vazhdon në kreun e tretë, me parashikimin e **lirive dhe të drejtave politike**, si: e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, e drejta për t'u organizuar kolektivisht, e drejta e anëtarësimit në shoqata, e drejta e tubimeve paqësore, e drejta e kërkesave, ankesave ose vërejtjeve ndaj organeve publike, etj.

Në kreun e katërt, Kushtetuta ka parashikuar të drejtat **ekonomike, sociale dhe kulturore**, si: e drejta për punë, e drejta për anëtarësim në sindikata, e drejta për grevë, që ka lidhje me marrëdhëniet e punës, e drejta për mbrojtje shoqërore të punës, e drejta për jetë familjare, e drejta për mbrojtje të veçantë të fëmijëve, grave shtatzëna dhe nënave të reja, e drejta për kujdes shëndetësor, e drejta për mjedis të shëndetshëm, e drejta për arsimim dhe e drejta për krijim artistik dhe kërkim shkencor.

Kushtetutbërësi shqiptar është treguar i kujdesshëm, kur ka përcaktuar ndarjen në të drejtat sociale dhe objektivat socialë, përderisa përcaktimi kushtetues i këtyre të drejtave varet dhe nga gjendja ekonomike dhe zhvillimi social dhe kulturor i vendit përkatës.

Konkretisht, është rezervuar një dispozitë më vete në lidhje me te ashtuquajturit, "**objektivat socialë**"²¹. Këto janë shprehje e synimit të shtetit në favor të përfitimeve, siç janë: punësimi i të gjithë personave të aftë për punë, plotësimi i nevojave të shtetasve për strehim dhe të standardeve më të larta shëndetësore, fizike e mendore të mundshme, arsimimi dhe kualifikimi i personave të pazënë me punë, një mjedis i shëndetshëm dhe i përshtatshëm, përkujdesja dhe ndihma shoqërore për të moshuarit, jetimët, personat me aftësi të kufizuara, etj.

Realizimi i këtyre është ngushtësisht i lidhur me kushtet, mjetet dhe mundësitë e disponueshme buxhetore të shtetit. Përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërsëdrejti në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën, në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave.

21 Neni 59 i Kushtetutës.

USHTRIMI NR. 5	Me ligjin “ <i>Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik</i> ”, Kuvendi u ka njohur personave me aftësi të kufizuar, përfitimin e një tërësie të drejtash për shkak të pamundësisë shëndetësore. Këshilli i Ministrave, në zbatim të ligjit për statusin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ka miratuar vendimin që parashikonte, midis të tjerash, se këtyre personave u njihej e drejta për të paguar vetëm 20% të konsumit mujor të energjisë elektrike. Më pas, Këshilli i Ministrave ka shfuqizuar këtë vendim dhe me një vendim tjetër ka përcaktuar masën fikse të kompensimit për energjinë elektrike në shumën 2.000 lekë në muaj. ²²
PYETJE	Si duhet të trajtohet kjo çështje nga pikëpamja e të drejtave themelore të njeriut? Për çfarë të drejtash kushtetuese bëhet fjalë? A mund të ngrenë pretendime personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë? Në çfarë konteksti dhe me çfarë argumentesh?
OBJEKTIVI	Njohja me të drejtat e natyrës ekonomike dhe sociale dhe ndërgjegjësimi për dallimin midis të drejtave dhe objektivave social të shtetit. Të kuptohet se detyrimi i shtetit për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar buron nga Kushtetuta, por rregullat e detajuara të sistemit të ndihmës shoqërore nuk përcaktohen nga vetë Kushtetuta. Prandaj në këtë drejtim ligjvënësi gëzon diskrecion në përcaktimin e këtyre rregullave, megjithatë duhet të ketë kritere ligjore, të qarta e të qëndrueshme në përcaktimin e tyre.

3.1.3. Kriteret kushtetuese të kufizimit të të drejtave

Të drejtat e njeriut nuk janë absolute në shumë raste dhe mund të kufizohen deri në njëfarë mase. Kushtetuta ka parashikuar në nenin 17 të saj dhe kriteret në lidhje me kufizime të tilla. Ato janë parakushte që kufizimi të jetë i justifikuar nga pikëpamja kushtetuese. Mund të renditen për sa vijon:

- » **Vetëm me ligj.** Kjo do të thotë se kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore nuk mund të bëhen me instrumente dytësore, akte nënligjore si , vendim i Këshillit të Ministrave, udhëzim ose urdhër i Kryeministrit apo ministrave²³;

²² Frymëzuar nga vendimet nr.34, datë 28.05.2012, dhe nr.10, datë 18.03.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

²³ Shih vendimin nr.20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese, ku GJK iu kërkua shfuqizimi i disa

- » **Për interes publik ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve**²⁴

vendimeve të Këshillit të Ministrave, që kufizonin të drejtat e nëpunësve publikë të administratës publike për punësim pranë disa institucioneve, nëse ata ishin në konflikt interesi për shkak të lidhjeve nepotike me zyrtarë të këtyre institucioneve. GJK i shfuqizoi vendimet, duke u shprehur mes të tjerave, se duhej të ishin miratuar me një ligj të miratuar nga Kuvendi, jo me akt nënligjor, pra nga VKM.

²⁴ Shih vendimin nr.30, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese, ku para GJK u pretendua nga Shoqata “Pronësi dhe drejtësi”, se disa nga dispozitat të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” ishin të papajtueshme me Kushtetutën, kryesisht në drejtim të kufizimit të së drejtës së pronës. Ligji kishte parashikuar kufizimin për kthimin dhe kompensimin e tokës bujqësore deri në 60 ha. GJK vendosi rrëzimin e kërkesës. Ajo theksoi se një ndër kriteret kushtetuese që gjen zbatim në dispozitat ligjore të kundërshtuara është “*interesi publik*”. Çdo ndërhyrje ndaj pronës mund të justifikohet vetëm nëse është në interesin publik ose të përgjithshëm.

- » **Duhet respektuar parimi i proporcionalitetit.** Kjo do të thotë se masat kufizuese duhet t'i përgjigjen qëllimit, që synohet të arrihet nga ligjvënësi dhe duhen vlerësuar rast pas rasti²⁵;
- » **Mosdhunim i thelbit të së drejtës.** Kjo do të thotë se kufizimi nuk duhet të jetë i tillë, saqë të mohojë ekzistencën e vetë të drejtës,
- » **Jo tejkallim të kufizimeve të sanksionuara në KEDNJ.** Kufizimi nuk duhet të jetë më i ashpër se sa KEDNJ lejon²⁶.

Vlen të theksohet se Kushtetuta u ka dhënë marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, statusin e të bërit pjesë të leg-

25 *Shih* vendimin nr.16, datë 11.11. 2004 të Gjykatës Kushtetuese, ku GJK iu kërkua nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit të deklarojë si antikushtetues nenin 34 të ligjit për deklarimin e pasurisë, në të cilin theksohet se “të dhënat që përfitohen nga deklarimi... janë të lejueshme për publikun, në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. GJK theksoi se, detyrimi për deklarimin e të ardhurave dhe pasurisë personale si dhe mundësia e publikimit të tyre, nuk synojnë dëmtimin apo denigrimin e subjekteve deklaruese, por një transparencë dhe kontroll më rigoroz ndaj pasurimit apo raporteve të tyre financiare me persona të tretë. Nga ky këndvështrim, GJK çmoi se publiku kishte interes të ligjshëm, që përmes transparencës, të informohej më në detaje jo vetëm mbi punën dhe veprimtarinë, por edhe mbi të ardhurat, pasurinë dhe burimet e saj të personave të zgjedhur ose zyrtarë. Pra, ekuilibri i gjetur në ligj u vlerësua si e drejtë dhe e bazuar.

26 *Shih* vendimin nr.65, datë 10.12.1999 të Gjykatës Kushtetuese, ku GJK iu kërkua shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën të dënimit me vdekje, në kohë paqeje. Ajo theksoi se, Kushtetuta është hartuar duke u bazuar edhe në parimet që sanksionon Statuti i Këshillit të Evropës, ku në nenin 3 të tij thuhet: “Çdo anëtar i Këshillit të Evropës pranon parimin e përparësisë të së drejtës dhe parimin në bazë të të cilit çdo person nën juridiksionin e saj duhet të gëzojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore”. Në këtë aspekt edhe qytetarët shqiptarë si pjesë e kësaj bashkësie evropiane, ku heqja e dënimit me vdekje është bërë një domosdoshmëri, nuk mund të bëjnë përjashtim..

jislacionit të brendshëm, që do të thotë se dispozitat e këtyre marrëveshjeve kanë të njëjtin efekt si e drejta vendase dhe shkelja e tyre mund të pretendohet nga individët në të njëjtën mënyrë si dhe për ligjet e brendshme²⁷. Ndërsa KEDNJ ka një status të veçantë, “më të privilegjuar” në Kushtetutën shqiptare, pasi kufizimet që kjo konventë vendos në lidhje me të drejtat e njeriut, në asnjë mënyrë nuk mund të tejkalohen nga sistemi i brendshëm ligjor.

Gjykata Kushtetuese në një vendim të saj është shprehur se, KEDNJ si instrument i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ofron vetëm një standard minimum të mbrojtjes së të drejtave dhe shtetet nuk pengohen të shkojnë përtej këtij kufiri.²⁸

Gjykata Kushtetuese ka shtjelluar kuptimin e parimeve të nenit 17 të Kushtetutës për kufizimin e të drejtave, dhe jurisprudenca është në zhvillim e sipër.

27 **Neni 122 i Kushtetutës.**

28 *Shih* vendimin nr.38, datë 23.12.2003, ku GJK iu kërkua nga një prokuror të shfuqizonte vendimin e Gjykatës së Lartë. Kërkuesi me dekret të Presidentit ishte transferuar nga një prokurori në një tjetër, dekret, të cilin e kishte ankumuar në gjykatë. Gjykata e Lartë pushoi gjykimin me argumentin, se dekretet e Presidentit, duke përfshirë edhe ato të largimit apo transferimit të prokurorëve, nuk mund të kundërshtohen në gjykatë pasi ato janë të natyrës kushtetuese dhe jo akte administrative. Ky kufizim ishte i mbështetur dhe në jurisprudencën e GJEDNJ që e kishte justifikuar kufizimin e aksesit në gjykatë të një kategorie të caktuar funksionarësh publikë. GJK e shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Lartë, duke u shprehur se kërkuesit i ishte mohuar e drejta e ankimit në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. KEDNJ përcakton një minimum të drejtash që duhet të respektohen nga vendet anëtarë, por këto vende nuk pengohen të ofrojnë një mbrojtje më të madhe se sa KEDNJ.

USHTRIMI NR. 6	Kryeministri nxorri Urdhrin “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”, sipas të cilit, organet e varësisë së Këshillit të Ministrave, drejtoritë përkatëse të marrëdhënieve me shtypin, nuk duhet të komunikojnë me median dhe të jepnin informacione në lidhje me detyrën zyrtare që duhet të përmbushnin, pa marrë më parë pëlqimin e Ministrit. Shoqata e gazetarëve pretendon se, ky është dhunim i lirisë së medias për të kryer funksionin e saj në interes të transparencës, dhe shkelje e së drejtës për informacion të publikut të gjerë.
PYETJE	Cilat janë të drejtat kushtetuese në diskutim në këtë çështje? Si qëndrojnë ato në raport me njëra –tjetrën? Në opinionin tuaj, a është urdhri në përputhje me kriteret dhe kërkesat kushtetuese të kufizimit
OBJEKTIVI	Të kuptohet rëndësia e njohjes së kriterëve kushtetuese të kufizimit të të drejtave themelore të njeriut. Të ndërjegjësohen për konkurrimin midis disa qëllimeve në rastet e parashikimeve ligjore apo nënligjore dhe tensionin që mund të sjellë mes aktorëve të ndryshëm (qeveri, shoqata, publik, etj) mos gjetja e ekuilibrave kushtetuese.

Parimet e sipërpërmendura janë shtjelluar gjithashtu në nivel ligjor, si parime që udhëheqin veprimtarinë e përditshme të administratës publike. Ligjet ndryshohen shpesh, dhe nëpunësit duhet të mbajnë parasysh këtë fakt. Megjithatë, vlen të citohet Kodi i Procedurave Administrative të vitit 2014 (KPA), që sanksionon disa parime bazë, për sa vijon:

“1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor. (parimi i ligjshmërisë); si dhe:

“1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është:

- a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës;*
- b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe*
- c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë. (parimi i proporcionalitetit)²⁹.*

²⁹ Nenet 4 dhe 12 të KPA.

Ligjvënësi jo rastësisht u ka kushtuar rëndësi tre parimeve, konkretisht, të ligjshmërisë, të mbrojtjes së interesit publik, ashtu si dhe të proporcionalitetit, pasi janë këto parime që duhet të orientojnë marrëdhëniet e administratës publike me individët.

Në kryerjen e funksioneve administrative, nëpunësit publikë duhet të kenë parasysh përmbajtjen dhe frymën e ligjit, të cilin zbatojnë në fushën përkatëse, ashtu si dhe të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit.

3.1.4 Cili është organi që bën interpretim përfundimtar të Kushtetutës?³⁰

Një nga detyrat e rëndësishme të drejtësisë kushtetuese, pavarësisht se çfarë sistemi mbrojtjeje zbatohet, është mbrojtja e standardeve kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në Shqipëri, organi që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës është Gjykata Kushtetuese³¹.

Kontrolli kushtetues i veprimtarive administrative rrjedh nga detyrimi i administratës publike, për të vepruar sipas parimit të kushtetutshmërisë dhe nga respektimi i parimit të shtetit të së drejtës, sipas të cilit mbrojtja kundër cenimit të të drejtave të gjithkujt nga ndërhyrjet e pushtetit publik duhet të jetë sa më e plotë.

Mbrojtja kushtetuese që i është ngarkuar GJK-së, mund të realizohet vetëm kur zbatimi i Kushtetutës dhe më pas zbatimi i normave ligjore dhe nënligjore nga administrata publike është i kontrollueshëm. Edhe GJEDNJ ka theksuar, në lidhje me kontrollin e akteve të pushtetit ekzekutiv, se:

30 Të gjithë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, janë të disponueshme *on-line* në faqen zyrtare <http://www.gjk.gov.al/>.

31 Neni 124 i Kushtetutës.

“...Do të ishte në kundërshtim me shtetin e së drejtës nëse diskrecioni juridik që i jepet ekzekutivit, të shprehej në termat e një pushteti të pakufizuar. Si rrjedhim, ligji duhet të përcaktojë koordinatat e çdo kompetence diskrecionale që u jepet autoriteteve kompetente, si dhe mënyrën e ushtrimit të saj me qartësi të mjaftueshme, me qëllim që duke marrë parasysh karakterin legjitim të aktit në fjalë, t’i garantojë individit mbrojtje të përshtatshme nga ndërhyrjet arbitrare”³².

Me fjalë të tjera, nëpunësit e administratës publike kanë një hapësirë të lejuar për të vepruar me diskrecion, por brenda kompetencave që u jep ligji. Diskrecioni u lejohej atyre, nisur nga domosdoshmëria e respektimit edhe e parimit të efikasitetit në veprimtarinë e administratës publike. Ky pushtet nuk është i pakufizuar, por i justifikuar për arritjen e një qëllimi të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht mënyrat për ta arritur atë, duke i lënë një hapësirë vlerësimi zgjedhjeje vetë organit të administratës publike.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, veçanërisht në rastet kur bëhet fjalë për të drejtat themelore të njeriut, ka theksuar se interpretimi përfundimtar i normës kushtetuese është në kompetencë të Gjykatës

32 Çështja Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi 8691/79, vendim i datës 2 gusht 1984. Z. Malone u akuzua për vjedhje dhe po gjykohej nga gjykatat britanike. Ai ngriti pretendime para GJEDNJ, se gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes së tij para gjykatës, telefonat e i tij ishin përgjuar me autorizimin e Policisë, duke e cënuar jetën private dhe familjare. Ky autorizim nuk ishte i kontrollueshëm sipas sistemit ligjor dhe ishte i bazuar në një direktivë jo të detyrueshme dhe të papublikuar të autoriteteve britanike. Direktiva nuk kishte fuqinë e ligjit dhe autoritetet nuk kishin detyrimin ta zbatonin atë. Për rrjedhojë, sipas GJEDNJ ndërhyrja e autoriteteve në jetën private të aplikantit nuk plotësonte kriterin “në përputhje me ligjin”.

Kushtetuese. Gjithashtu, shumë standarde janë përpunuar nga GJK lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dhe siç e theksuam më lart, kjo jurisprudencë është në zhvillim e sipër.

Individët gjithmonë e më shumë po bëhen të varur ndaj aparatit administrativ, për shkak të shërbimeve që ky i fundit ofron, duke u kthyer nga qytetarë në subjekte. Mirëqenia e individëve varet shumë nga marrëdhënia e tyre me qeverinë dhe qeverisjen. Çështje

të ndryshme administrative, si: eficientia, efektiviteti, qëndrueshmëria, koherenca, qartësia e qëllimeve, vendimmarrja, transparencja, hierarkia, llogaridhënia, ekonomizimi, menaxhimi, paanësia, kompetencat, konfliktet e kompetencave, delegimi i kompetencave, procedurat administrative, prekin dhe ndërthuren me temat kushtetuese të ndarjes dhe ekuilibrit të pushteteve, parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë si dhe shtetit të së drejtës.

<p>USHTRIMI NR. 7</p>	<p>Subjekti doganor X i është vënë një gjobë doganore nga dega e doganës Y. Ai e ka ankimuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave referuar Kodit Doganor. Sipas këtij kodi, për të pasur të drejtën e ankimit pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave duhet të shlyente fillimisht 40% të masës së gjobës së vendosur nga autoritetet doganore. Nëse ankesa nuk pranohej, apeluesi duhet të paguante pjesën që mbetet prej 60% të gjobës, dhe mund të ankohej kundër vendimit pranë autoriteteve gjyqësore brenda 30 ditësh nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës.</p>
<p>PYETJE</p>	<p>A mendoni se përbën kufizim të së drejtën së aksesit të individëve, parapagimi i gjobës në masën 40% para ankimit administrativ? Po parapagimi në masën 60% para ushtrimit të së drejtës për ankim në gjykatë? A ka ndërhyrje në të drejtat kushtetuese të individit në këtë çështje? Nëse po, mbi çfarë kriteresh kushtetuese, duhet vlerësuar?</p>
<p>OBJEKTIVI</p>	<p>Ndërgjegjësim për ballafaqimin midis interesave të ndryshme të mbrojtura nga Kushtetuta. Diskutim për ekuilibrimin që duhet të ketë në rastin konkret nga njëra anë, mbi të drejtën e shtetasve për të pasur një akses efektiv në një proces të drejtë administrativ/gjyqësor dhe, nga ana tjetër, mbi interesin e shtetit për të vjelë në mënyrë efektive detyrimet doganore.</p>



Disa koncepte administrative kanë status kushtetues dhe/ose ndërlidhen me çështje të natyrës kushtetuese, prandaj dhe interpretimet e Gjykatës Kushtetuese janë me vlerë edhe në këtë këndvështrim për t'u ditur nga administrata publike.

3.1.5 Si ndikon kontrolli kushtetues në veprimtarinë e përditshme administrative?

Mund të thuhet se qeverisja kushtetuese është një nga llojet e qeverisjes, e cila, përveçse në shtetin e së drejtës dhe në drejtimin e shtetit, ndikon edhe në mirëqenien dhe cilësinë e jetës së individëve. Kontrolli kushtetues është ai që shpeshherë ndërhyr në politikën qeverisëse, në veprimet e ligjvënësive dhe ekzekutivitet, duke i kufizuar ose duke u hapur rrugë sipërmarrjeve të ndryshme me natyrë administrative.

Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet juridiksionit të saj, ushtron ndikim të dukshëm në çështje të së drejtës administrative. Kjo gjykatë me jurisprudencën e saj gjatë kontrollit kushtetues ndihmon në unifikimin e koncepteve dhe standardeve administrative, edhe pse nuk e ka qëllim në vetvete. Konkretisht, Gjykata Kushtetuese, ka si kompetencë të saj edhe kontrollin normativ të ligjeve dhe akteve nënligjore nëse janë në përputhje me Kushtetutën³³.

Në varësi të vendimmarrjes së kësaj gjykate, varet shpeshherë dhe veprimtaria administrative e zakonshme e nëpunësve civilë. Në këtë aspekt, nëpunësve publikë u duhet që të interpretojnë ligjet, aktet nënligjore, të nxjerrin aktet e veta, që në thelb janë tregues të procesit të vendimmarrjes administrative, që duhet të jetë në përputhje me standardet kushtetuese. Edhe veprimtaria e përditshme e administratës, sjelljet apo qëndrimet e nëpunësve shpesh janë të drejtuara drejt shqetësimeve kushtetuese³⁴.

33 Neni 131/a dhe "c" i Kushtetutës.

34 David H. Rosenbloom/James D. Carroll: "Toward Constitutional Competence. A casebook for public administrators", 1990, Prentice Hall Inc. fq.2, cit: Toska

E drejta administrative është e ndërtuar dhe qëndron mbi dy kolona: *legjislacioni*, ku përfshihen ligjet dhe aktet nënligjore; dhe *jurisprudenca* e krijuar nga gjykatat, ku rol të rëndësishëm kanë gjykatat administrative, por edhe Gjykata Kushtetuese. Nëpunësit civilë duhet të kenë njohuritë bazë kushtetuese, për ta drejtuar vendimmarrjen dhe veprimet administrative në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut³⁵.

Disa veprime administrative specifike, edhe pse me qëllim arritjen e standardeve administrative të kërkuara, mund të shkelin Kushtetutën dhe të mos respektojnë të drejtat e njeriut në disa mënyra dhe për një numër arsyesh. Administrata publike ka një diskrecion të konsiderueshëm në formulimin e politikave publike, në përcaktimin e mjeteve për t'i arritur këto objektiva, si dhe në zbatimin e tyre. Megjithatë, pikërisht ky diskrecion mund të sjell dhe tension lidhur me parimin kushtetues të shtetit të së drejtës, i cili kërkon që çdo lloj veprimtarie t'i nënshtrohet Kushtetutës dhe ligjit. Prandaj, dhe administrata publike duhet të jetë pajisur me aftësitë analitike për të reduktuar rrezikun e antikushtetueshmërisë së veprimeve të saj.

Duke përmbledhur sa më sipër, mund të thuhet se, që të respektojnë të drejtat e njeriut në nivel administrativ, nëpunësit civilë duhet të veprojnë në përputhje me standardet e kërkuara kushtetuese për zhvillimin e veprimtarisë së tyre administrative.

E. "Kontrolli mbi veprimtarinë administrative sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë", ISBN 9928-04-157-1, Shtator 2013, fq.10.

35 *Shih* për më tepër Toska E. "Kontrolli mbi veprimtarinë administrative sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë", ISBN 9928-04-157-1, Shtator 2013, fq.9.

3.2 KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (1950)³⁶

3.2.1 Të përgjithshme

Sistemi ndërkombëtar i të drejtave të njeriut në Evropë vepron më së shumti nën mburojën e Këshillit të Evropës, anëtare e cilit është edhe Shqipëria, që nga viti 1995. Akti ndërkombëtar që shpreh detyrimet e shteteve anëtare të KiE për respektimin e të drejtave themelore të njeriut është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose KEDNJ, e miratuar nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës³⁷. KEDNJ ka edhe 16 protokolle shtesë³⁸, jo të gjitha të ratifikuara nga çdo shtet anëtar.

Qëllimi i miratimit të KEDNJ është dhënia e një garancie ndërkombëtare në vijim të sistemit mbrojtës kombëtar, si dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore sipas angazhimeve të marra nga shtetet anëtare, duke i detyruar këto të fundit, që kur vendosin për një çështje të të drejtave të njeriut

36 Teksti i harmonizuar në anglisht i KEDNJ me protokollet, si dhe informacion mbi shtetet që kanë ratifikuar protokollet, mund të gjendet on-line në: http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf, vizituar me datë 22.09.2015.

37 Përveç KEDNJ, mund të përmendim edhe dokumente të tjera rajonale/europiane të Këshillit të Evropës; si p.sh. Karta Sociale Evropiane (1961) e rishikuar (1996 dhe 1998). Lista e plotë e traktateve dhe konventave të Këshillit të Evropës mund të aksesohet on-line në: <http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ListeTraites.asp?CM=8&CL=ENG>, vizituar me datë 10.11.2015

38 Prot.1, neni 1 – e drejta e pronës; Prot. 1, neni 2 – arsimimi; Prot. 1, neni 3 – e drejta e votës; Prot. 4 – mosburgim për shkak paaftësie paguese, levizje e lirë, debim; Prot. 6 – kufizim i denimit me vdekje; Prot. 7 – krimi dhe familja; Prot. 12 – Diskriminimi; Prot. 13 – Heqja e denimit me vdekje; Prot. 11 (Prot. 2, 3, 5, 8, 9 dhe 10 janë tejkaluar nga Prot.11); Prot. 14 ndjek Prot.11, me fokus përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit të GJEDNJ. Prot.15 dhe 16 janë hapur për nënshkrim dhe ratifikim nga shtetet anëtare të Konventës. Shqipëria ka ratifikuar Prot. nr.15 me datë 4 nëntor 2015 dhe Prot. nr.16 me datë 22.07.2015.

t'u referohen gjithnjë e më shumë standardeve dhe parimeve të GJEDNJ.

3.2.2 Cilat të drejta sanksionon KEDNJ?

Të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura nga KEDNJ janë të ngjashme me ato të shtjelluara në Kushtetutën shqiptarë, si: e drejta e jetës, e drejta për respektim të integritetit fizik, e cila nuk lejon veprime të tilla si tortura, trajtimet ç'njerëzore ose degraduese, si skllavëria, robëria, ose puna me dhunë apo e detyruar, e drejta e lirisë dhe sigurisë personale, e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare, e drejta për të krijuar familje, dhe barazia mes burrit dhe gruas. Këto të drejta plotësohen nga ato të një karakteri *procedural*, si e drejta për një gjykim të drejtë dhe brenda një afati sa më të arsyeshëm, si dhe e drejta për një ankim efektiv.

Në vazhdim, KEDNJ mbron disa të drejta *vetjake* të lidhura me personin: e drejta e lirisë së mendimit, e besimit dhe e fesë, e drejta e lirisë së shprehjes, e drejta e lirisë për t'u mbledhur dhe për të krijuar organizata, përfshirë dhe sindikata; e drejta për zgjedhje të lira dhe demokratike, e drejta për respektimin e pronës dhe pasurisë, përfshirë dhe shpronësimin e drejtë në rast të një shpronësimi të lejueshëm, vetëm për qëllime publike, e drejta për t'u arsimuar në gjuhën amtare, e drejta e personit për të mos u dëbuar nga shteti shtetësinë e të cilit ka, si edhe e drejta për të lëvizur dhe qëndruar lirisht në territorin e një shteti, ku ai gjendet në mënyrë të ligjshme.

Si me të drejtat në Kushtetutën tonë, edhe duke iu referuar KEDNJ, rezulton se të drejtat nuk kanë karakter *absolut*, përveç ndalimit të torturës dhe trajtimit ç'njerëzor dhe

degradues, dënimit për një vepër që në kohën e kryerjes nuk ishte vepër penale, si dhe lirisë së mendimit. Ato kanë karakter *relativ*, në kuptimin që mund të kufizohen, dhe kufizimi është i justifikuar vetëm në rastet e nevojës dhe të domosdoshmërisë për të përmbushur një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve³⁹. Siç e kemi trajtuar më sipër, Kushtetuta shqiptare i referohet këtij parimi, duke theksuar në nenin 17/2 se asnjë kufizim i një të drejte në Shqipëri nuk lejohet n.q.s. tejkalon kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

Qëllimi kryesor i KEDNJ është të mbrojë individin nga veprimet arbitrare të autoriteteve publike, pra u kërkon shteteve që në kuadrin e detyrimeve negative, fillimisht të mos ndërhyjnë në të drejtat e njeriut si dhe të mos i dhunojnë ato. Përveç këtij elementi, KEDNJ vendos dhe detyrime pozitive të qenësishme për “respektimin” efektiv të të drejtave. Në të dy kontekstet, duhet të ekzistojë një ekuilibër i drejtë ndërmjet interesave konkurruese të individit dhe komunitetit në tërësi; dhe në të dy kontekstet, shteti gëzon një hapësirë të caktuar vlerësimi.⁴⁰

Sipas doktrineve së “*instrumentit të gjallë*” dhe “*efektivitetit dhe praktikitetit*”, të shpalosura dhe të përpunuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, KEDNJ duhet parë si një instrument i gjallë, për t’u interpretuar nën dritën e kushteve aktuale, që do të thotë se ajo duhet t’u përgjigjet kërkesave të kohës dhe sigurisht të mbajë një ekuilibër ndërmjet kreativitetit gjyqësor dhe qëllimit të të drejtave të parashikuara në të⁴¹.

39 *Shih* nenet 3, 4, dhe 7/1 të KEDNJ.

40 *Shih* nenet 8, 9, 10, 11 të KEDNJ.

41 Çështjet: Keegan kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikim nr. 28867/03, vendimi i datës 26 maj 2006, Sylvester kundër Austrisë, aplikim nr. 36812/97 dhe

Bazuar në këtë doktrinë, të drejtat janë zgjeruar aq shumë sa nuk mbrojnë vetëm interesat “më tepër” të rëndësishme të individëve. Në çështjen *Hatton dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkuesi u ankua për fluturimet e natës në aeroportin e Londrës *Heathrow*, të cilat ndotnin ajrin dhe shqetësonin gjumin e banorëve që jetonin rreth zonës. GJEDNJ u shpreh se:

“Neni 8 i KEDNJ mbron të drejtën individëve për jetën e tyre private dhe familjare, shtëpinë dhe korrespondencën. Konventa nuk shprehet për të drejtën specifike të një ambienti të pastër dhe të qetë, por kur një person është drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë i prekur nga zhurmat dhe pluhuri, atëherë pretendime të tilla mund të prekin standardet e kërkuara nga neni 8”⁴².

Interpretimi i të drejtave në KEDNJ është realizuar në mënyrë të zgjeruar, sidomos në çështje të jetës private dhe familjare të sanksionuara në nenin 8 të KEDNJ, ku GJEDNJ trajtoi dhe arriti të japë një përkufizim gjithëpërfshirës dhe të zgjeruar të konceptit mbi “jetën private”, duke u shprehur:

“...e drejta për jetë private është një term i gjerë dhe koncept jo shterues. Ky term përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të një personi. Prandaj dhe mund të përmbledhë aspekte multidimensionale të jetës dhe identitetit social të tij. Elementë si; gjinia, emri, orientimi seksual, jeta seksuale, përfshihen në sferën e jetës private të mbrojtur nga neni 8. Përtej emrit të një personi, jeta private mund të përfshijë dhe mjete të tjera identifikimi apo që e lidhin me familjen.

nr. 40104/98, vendim i datës 24 prill 2003.

42 Aplikimi nr. 6022/97, vendim i datës 2 tetor 2001, prg.94-107.

“Informacioni për shëndetin e një personi është element i rëndësishëm i jetës private. Gjykata për më tepër vlerëson se identiteti etnik është një element tjetër tepër i rëndësishëm. Neni 8 mbron të drejtën e individit për zhvillim personal, të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie sociale me qenie të tjera njerëzore apo dhe jashtë planeti. Koncepti i jetës private për më shumë përfshin elementë të lidhur me të drejtën e një personi për të mbrojtur imazhin/reputacionin e tij.”⁴³

3.2.3 Cili është organi mbikqyrës për KEDNJ?

Mbrojtja e të drejtave të parashikuara në KEDNJ realizohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, shpesh e quajtur thjesht “Gjykata e Strasburgut” ose e përdorur në tekste të ndryshme me shkurtimein “GJEDNJ”. Asaj gjykate mund t’i drejtohen individët për dhunim të të drejtave të tyre të parashikuara në KEDNJ. Shtetet anëtare të Konventës mund të gjobiten nga GJEDNJ për shkeljet, dhe kjo e drejtë e Gjykatës së Strasburgut i jep asaj rëndësi të madhe, në Shqipëri dhe në shtetet e tjera anëtarë.

Për të ushtruar të drejtën e ankimit pranë GJEDNJ, individët duhet të kenë kaluar të gjitha shkallët e ankimit efektiv brenda shteteve përkatëse dhe ankimi duhet bërë brenda një afati prej gjashtë muajsh⁴⁴ nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm⁴⁵.

43 Po aty.

44 Afat, i cili do të shkurtohet në katër muaj me hyrjen në fuqi të Protokollit nr.15, neni 4, që ndryshon nenin 35 të KEDNJ.

45 Neni 35 i KEDNJ (kushtet e pranueshmërisë), i shtuar me Protokollin nr.14, me një paragraf të tretë sipas të cilit: Gjykata deklaron çdo kërkesë individuale të bërë në bazë të Nenit 34 të papranueshme, kur mendon se: a) kërkesa është e papajtueshme me dispozitat e Konventës ose protokollin e saj, haptazi e pabazuar ose një

Sistemi i mbrojtjes nga GJEDNJ vendos në ekuilibër mbrojtjen kombëtare (Kushtetuta dhe ligjet në zbatim të saj) me atë ndërkom-bëtare të të drejtave të njeriut dhe e bën sistemin e mbrojtjes funksional. GJEDNJ duhet parë nga individët si shkallë e fundit e ankimit. Gjithmonë është e preferueshme që të drejtat të rivendosen në vend brenda sistemeve kombëtare, duke iu kursyer kohë dhe burime financiare viktimave të shkeljes.

GJEDNJ penalizon shtetin përkatës në rast identifikimi të shkeljes së të drejtave themelore të njeriut dhe jo organet përkatëse të administratës publike, ose nëpunësit e tyre, që kanë kryer shkeljen. Në këto kushte, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve është i rëndësishëm. Shpeshherë mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet organeve administrative si dhe mosveprimi i tyre mund të bëhen burim i shkeljes së të drejtave themelore të njeriut.

Ka shumë çështje konkrete kundër Shqipërisë të gjykuara apo që janë në gjykim nga GJEDNJ; një nga ato është *Bajrami kundër Shqipërisë*.⁴⁶ Aplikanti u ankua se organet kompetente vendase nuk bënë ato përpjekje që pritëshin prej tyre për të garantuar respektimin e të drejtave të tij për një jetë familjare, pasi nuk kishin ndërmarrë hapa për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, që i jepte atij kujdestarinë e fëmijës.

shpërdorim të së drejtës për kërkesë individuale; ose b) paraqitësi i kërkesës nuk ka pësuar ndonjë dëm të konsiderueshëm, përveç kur respektimi i të drejtave të njeriut sipas përcaktimit të Konventës dhe protokolleve të saj kërkon shqyrtimin e kërkesës në lidhje me themelin e saj, me kusht që për këtë shkak asnjë çështje të mos refuzohet nëse nuk është shqyrtuar si duhet nga një gjykatë kombëtare.

46 Çështja Bajrami kundër Shqipërisë, aplikimi nr. 35853/04, vendim i datës 12 dhjetor 2006.

Sipas GJEDNJ, në rrethanat e çështjes, parvarësisht nga fakti se shtetit të paditur i lejohej një lloj hapësire, përpjekjet e autoriteteve shqiptare nuk ishin të duhura dhe efikase për të realizuar të drejtën e aplikantit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, i cili përcaktonte të drejtën e tij për t'u kujdesur për fëmijën pas divorcit. Autoritetet kishin neglizhuar të ndërmerrnin masat e nevojshme për të zbuluar vendndodhjen e së bijës, në zbatim të vendimit të kujdestarisë në favor të tij. Si rrjedhim, ishte shkelur neni 8 i Konventës dhe Shqipëria u gjobit.

Nuk duhet harruar, se institucionet publike si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, e kanë të domosdoshme, që të bashkëpunojnë ndërmjet tyre, pasi shteti si një i vetëm mban përgjegjësi për shkeljen e të drejtave të njeriut para GJEDNJ.

Gjithashtu, duhet marrë parasysh, se parimet dhe standardet e GJEDNJ gjithmonë e më shumë po bëhen burim referimi nga gjykatat shqiptare në vendimmarrjen e tyre. Për më tepër, kompetenca e GJEDNJ për të vendosur sanksione mbi shtetet që kanë kryer shkelje të të drejtave dhe lirive të parashikuara në KEDNJ, e bën ankimin pranë kësaj gjykate një armë të fuqishme në duart e qytetarëve, të drejtat e të cilëve mund të dhunohen nga administrata publike.

3.3 Instrumentet të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Përveç Kushtetutës shqiptare dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka edhe instrumente të tjera ndërkombëtare shumë të njohura në fushën e të drejtave të njeriut, të cilat janë ratifikuar nga Shqipëria ose janë instrumente të organizatave me rëndësi, siç

është BE për Shqipërinë. Ato përshkruhen shkurtimisht në vijim.

3.3.1 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948)

Qëllimi

E miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, kjo Deklaratë ose DUDNJ është akti i parë kushtuar vetëm të drejtave të njeriut. Kjo Deklaratë përmban 30 nene për të drejtat civile, politike si dhe të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore. Megjithëse, u miratua në formën e rezolutës e jo në formën e traktatit ndërkombëtar (për këtë arsye janë shfaqur mendime lidhur me faktin nëse dispozitat e saj janë të detyrueshme për zbatim ose jo), ajo përcaktoi një kuadër bazë në OKB, për përpjekjet në vazhdimësi lidhur me vendosjen e standardeve dhe zbatimin e tyre.

Këtë e vërteton edhe fakti se shumica e dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut kanë qenë të frymëzuara dhe janë mbështetur në parimet e Deklaratës. Prandaj, me të drejtë mund të thuhet se DUDNJ ka shërbyer si model për kushtetutat dhe aktet legjislativ të shume vendeve.

Cilat të drejta parashikon?

DUDNJ ka parashikuar me një qasje tërësore të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Në të parashikohen të drejtat politike dhe civile si pjesë e shtyllës së parë të DUDNJ, si p.sh.: e drejta për jetën, lirinë dhe sigurinë e një personi, e drejta për të mos u trajtuar çnjerëzisht, trajtimi i barabartë, e drejta e lëvizjes së lirë, e drejta e kërkimit të azilit, të disponimit të pronave, të pajisjes me shtetësinë përkatëse, të shprehjes lirisht të besimit, të marrjes pjesë në qeverisje në

mënyrë të drejtpërdrejtë ose përfaqësuese.

Të drejtat ekonomike dhe sociale janë parashikuar në shtyllën e dytë të Deklaratës. Këtu theksi i vihet të drejtës së secilit “si një anëtar shoqërie”, dhe të gëzimit të të drejtave në termat ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat duhet të arrihen “nëpërmjet përpjekjeve kombëtare”, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe burimet e secilit shtet. Këto nene artikulojnë, p.sh., të drejtën për punë, të drejtën për t’u organizuar kolektivisht, të drejtën për të patur një standard jetesë të mjaftueshëm, përfshirë të drejtën për arsimim dhe të drejtën për të qenë pjesëmarrës në jetën kulturore të komunitetit.

DUDNJ mbulon dy kategoritë kryesore të të drejtave të njeriut në një dokument të vetëm. Megjithatë, kategoria e të drejtave civile dhe politike është e ndryshme në natyrë dhe kërkon zbatim të menjëhershëm, ndërsa të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore kanë natyrë progresive dhe për rrjedhojë mjetet e përdorura për realizimin e tyre janë të ndryshme. Siç e kemi parë, Kushtetuta shqiptare bën një diferencim të ngjashëm.

3.3.2 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike⁴⁷ (1966)

Qëllimi

Kjo Konventë ose KDCP është një dokument i OKB-së, që ka si qëllim të posaçëm, parashikimin e të drejtave civile dhe politike.

Cilat të drejta parashikon?

Të drejtat e parashikuara në Konventë janë: e drejta për jetën, ndalimi i torturës dhe trajtimi çnjerëzor, e drejta për liri dhe siguri, liria

⁴⁷ Shteti shqiptar ka aderuar me ligjin nr.7510, datë 08.08.1991.

e lëvizjes dhe zgjedhja e vendbanimit, barazia para ligjit, e drejta për privatësi dhe jetë familjare, shtëpi dhe korrespondencë, liria e shprehjes, e drejta e organizimit dhe e drejta e anëtarësimit. Protokollin e dytë shtesë i KDCP ka parashikuar detyrimin për heqjen e dënimit me vdekje⁴⁸.

Organi mbikqyrës

Organ monitorues për mbrojtjen e të drejtave civile dhe politike dhe mbikëqyrjen e shteteve në plotësimin e detyrimeve të marra përsipër është Komiteti i OKB-së i të Drejtave të Njeriut, të cilit, nëpërmjet Protokollit të parë opsional i është dhënë dhe kompetenca e shqyrtimit të ankimeve individuale⁴⁹.

3.3.3 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁵⁰ (1966)

Qëllimi

Kjo Konventë ose KDESC ka si qëllim të posaçëm, parashikimin e të gjitha të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të njeriut. Si KDCP më sipër, kjo është një instrument i OKB-së.

Ajo detyron shtetet anëtare të ndërmarrin të gjitha hapat për realizimin e plotë të të drejtave si: e drejta për punë, e drejta për kushte të përshtatshme pune, një standard i mjaftueshëm për të jetuar, e drejta për sigurime shoqërore, e drejta për arsimim dhe e drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore.

KDESC detyron shtetet që të ndërmarrin hapa

⁴⁸ Shteti shqiptar ka aderuar me ligjin nr.9726, datë 07.05.2007.

⁴⁹ Shteti shqiptar ka aderuar me ligjin 9725, datë 07.05.2007

⁵⁰ Shteti Shqiptar ka aderuar me ligjin nr.7511, datë 08.08.1991.

individuale si dhe përmes asistencës ekonomike ndërkombëtare dhe bashkëpunimit, në maksimumin e burimeve të tyre, me qëllim arritjen progresive të të drejtave deri në realizimin e plotë të tyre.

Organi mbikqyrës

Monitorimi i respektimit të detyrimeve për shtetet anëtare të vendosura nga KDESK realizohet nga një organ monitorues i OKB-së, i parashikuar si Komiteti për të Drejtat Sociale dhe Ekonomike. Ky komitet shqyrton raportet e paraqitura nga shtetet rregullisht dhe mban komunikim të përhershëm me ta, me qëllim për të siguruar zbatimin efektiv të të drejtave të parashikuara nga Konventa. Njëpërmjet Protokollit shtesë i është dhënë dhe kompetenca e shqyrtimit të ankimeve individuale.

3.3.4 Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial⁵¹ (1965)

Qëllimi

Kjo Konventë, ose KEFDR, si edhe konventat e mësipërme është instrument i OKB-së. Ajo ka për synim të detyrojë shtetet palë të dënojnë diskriminimin racial dhe të zotohen të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë, një politikë të zhdukjes së çdo forme të diskriminimit racial dhe të ndihmojnë mirëkuptimin midis të gjitha racave. Konventa përmban 25 nene, nga të cilat 7 të parat janë të natyrës deklarative. KEFDR jep një përkufizim të gjerë sipas të cilit, “diskriminimi racial” nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të

⁵¹ Shteti shqiptar ka aderuar me ligjin nr.7768, datë 09.11.1993.

shkatërrojë ose të kompromentojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike.

Organi mbikqyrës

Monitorimi i respektimit të detyrimeve për shtetet anëtare të vendosura nga kjo Konventë realizohet nga një organ monitorues, i parashikuar si Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial, organ kompetent edhe për shqyrtim të ankimeve individuale.

3.3.5 Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave⁵² (1979)

Qëllimi

Kjo Konventë e OKB-së (e njohur zakonisht si “CEDAW” nga gërmat nistore të emërtimit në anglisht) u kërkon shteteve palë të marrin të gjitha masat e përshtatshme në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke përfshirë edhe legjislacionin, për të siguruar zhvillimin e plotë të grave dhe përparimin e tyre, me qëllim që t’u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut mbi bazën e barazisë me burrat.

CEDAW përkufizon “diskriminimin ndaj grave” si çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të vështirësuj ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore

⁵² Shteti shqiptar ka aderuar me ligjin nr. 7767, datë 11.05.1994.

të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.

Nga ana tjetër, CEDAW i jep njohje formale ndikimit të kulturës, traditës, modeleve sociale, stereotipeve të burrit dhe të gruas, si pengesa reale që kufizojnë gëzimin e plotë dhe efektiv të të drejtave themelore nga gratë (neni 5).

Organi mbikqyrës

Organ monitorues për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe mbikqyrjen e shteteve në plotësimin e detyrimeve të marra përsipër është Komiteti i OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave. Nëpërmjet Protokollit shtesë i është dhënë dhe kompetenca e shqyrtimit të ankimeve individuale⁵³.

3.3.6 Konventa për të Drejtat e Fëmijës⁵⁴ (1989)

Qëllimi

Shtetet anëtare të kësaj Konvente të OKB-së, duhet të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmijët të jenë efektivisht të mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, vepërimitarive, mendimeve të shprehura ose bindjeve të prindërve, të përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tyre. KDF ka dhe tre protokolle opsionale, i pari “Mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura” (2000)⁵⁵, i dyti “Për mbrojtjen e shitjes së fëmijëve, prostituiimit dhe pornografinë me fëmijë” (2000), si dhe protokollin e tretë

53 Shteti shqiptar e ka ratifikuar në datë 17.04.2003.

54 Shteti shqiptar e ka ratifikuar në datë 11.12.1991.

55 Shteti shqiptar ka aderuar me ligjin nr.9833, datë 21.12.2007

opsional “Mbi procedurat e komunikimit” (2011)⁵⁶.

Cilat të drejta parashikon?

Të drejtat e parashikuara në KDF janë të karakterit civil, politik, social ekonomik dhe kulturor, ku subjekt bartës dhe gëzues i tyre është fëmija, nën moshën 18 vjec. Parimet kryesore të përfshira në këtë konventë janë:

- » të drejtat e fëmijës duhen respektuar pa diskriminim;
- » interesi i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata më e lartë;
- » zhvillimi i fëmijës duhet të mbështetet në maksimumin e mundshëm;
- » opinioneve të fëmijës në çdo çështje për të cilën ai preket duhet t’u jepet pesha e duhur.

Organi mbikqyrës

Organ monitorues i realizimit të detyrimeve të marra përsipër nga shtetet anëtare të KDF është Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Ky komitet ka të drejtën e shqyrtimit të ankimeve, nëse shteti ka pranuar kompetencën e Komitetit në këtë drejtim.

3.3.7 Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar⁵⁷ (2006)

Qëllimi

Kjo Konventë e OKB-së ose KPAK ka si qëllim

56 Shteti shqiptar e ka ratifikuar në datë 29.05.2013. Për më tepër mbi procedurat e ankimit pranë Komitetit, shih *on-line*: <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRC/Pages/CRCIndex.aspx>, vizituar me datë 15.10.2015.

57 Shteti shqiptar e ka ratifikuar me ligjin nr. nr.108, datë 15.11.2012

limi të nxisë, mbrojtje dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Ajo përkufizon dhe konceptin “Personat me aftësi të kufizuar” si individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

Në qendër të KPAK qendrojnë parimet e respektit për dinjitetin e këtyre njerëzve si dhe mosdiskriminimi ndaj tyre dhe të drejtat e lidhura me to. Shtetet anëtarë të Konventës kanë detyrimin të marrin një sërë masash të duhura në këtë drejtim.

Organ mbikqyrës

Organ monitorues i realizimit të detyrimeve të marra përsipër nga shtetet anëtare të Konventës është Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Protokollin shtesë i jep këtij Komiteti të drejtën e shqyrtimit të ankesave individuale ose në grup.

3.3.8 Karta Themelore e të Drejtave të Bashkimit Evropian (2000)

Karta Themelore e të Drejtave të BE-së është një dokument gjithëpërfshirës dhe modern i të drejtave të individit, përfshirë, zhvillimet shkencore dhe teknologjike si dhe ndryshimet e fundit sociale. Kjo kartë u miratua në Këshillin Evropian, në qytetin francez *Nice*, më 7 dhjetor 2000, por efektet detyruese për Shtetet Anëtare të BE-së kanë filluar nga 1 dhjetor 2009, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës.

Edhe pse Shqipëria nuk është ende anëtare

e BE-së, si vend kandidat me aspirata më të larta në fushën e të drejtave të njeriut, vëmendja e veçantë i duhet kushtuar Kartës. Kjo vlen edhe më shumë për nëpunësit e administratës publike, të cilët kanë detyrime në lidhje me procesin e anëtarësimit të vendit.

Sipas nenit 111 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Shqipërinë, bashkëpunimi me BE-në dhe institucionet e tij synon zhvillimin e një administrate publike eficiente dhe të përgjegjshme në Shqipëri, e cila mbështet në veçanti vënien në zbatim të shtetit të së drejtës, funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore për të mirën e popullsisë shqiptare në tërësi, dhe të zhvillimit normal të marrëdhënieve midis BE-së dhe Shqipërisë⁵⁸. Praktika e vendeve që janë bërë anëtare të BE-së tregon se në procesin e përafrimit të legjislacionit, rol të rëndësishëm luajnë edhe punonjësit e administratës publike me mënyrën e tyre të të kuptuarit dhe të zbatuarit të legjislacionit të BE (*acquis* ose *acquis communautaire*)⁵⁹.

Karta reflekton të gjitha të drejtat e zhvilluara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, të gjitha të drejtat dhe liritë e parashi-

58 Kjo marrëveshje është e disponueshme *on-line*, <http://www.mie.gov.al/>, vizituar me datë 28.09.2015.

59 *Shih* për më shumë “Guide to the main administrative structures required for implementing the *acquis*”, *May 2005, Informal working document for guidance only*, mainly for use by experts working for the European Commission and by experts in partner countries who are engaged in a process of approximation of their legislation and administration with those of the EU. [Udhëzime në lidhje me strukturat kryesore administrative, të kërkuara për zbatimin e *acquis*, dokument pune jo zyrtarisht i miratuar nga KE, por ndihmues dhe orientues për ekspertët të punojnë me BE], e disponueshme *on-line* në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/enlargement_process/accesion_process/how_does_a_country_join_the_eu/negotiations_croatia_turkey/adminstructures_version_may05_35_ch_public_en.pdf, vizituar me datë 23.11.2015.

kuara nga KEDNJ, si dhe të drejtat dhe parime, që përbëjnë “traditën kushtetuese të përbashkët” të vendeve të BE-së dhe të instrumenteve të tjera ndërkombëtare.

Karta i parashikon të drejtat në gjashtë “tituj”, përkatësisht: dinjiteti, liria, barazia, solidariteti, të drejtat e qytetarit dhe drejtësia. Nën titullin “dinjiteti” garantohej e drejta për jetën, ndalimi i torturës, ndalimi i skllavërisë dhe denimit me vdekje. Nën titullin “liria” përfshihen e drejta e privatësisë, martesja, liria e mendimit, liria e shprehjes, e drejta e organizimit, e arsimit, e drejta për punë, e drejta e pronës dhe e drejta e azilit dhe strehimit; “barazia” përfshin të drejtat e fëmijës dhe të të moshuarve; “solidariteti” mbron të drejtat e të punësuarve dhe të drejta sociale si e drejta për kushte pune të favorshme, mbrojtje kundër largimit të padrejtë nga puna, akses në shërbimin shëndetsor; ndërsa nën titullin “qytetarët” përfshihen e drejta e votës, e drejta e levizjes së lirë, dhe nëntitulli i fundit “drejtësia” mbulon të drejta si ajo për një mjet ankimi efektiv, e drejta për një gjykim të drejtë, si dhe prezumimi i pafajësisë.

Karta ka kodifikuar me një qasje moderne, të drejtat e mbrojtjes së të dhënave personale, garancive mbi bioetikën⁶⁰ si dhe të drejtën e mirëadministrimit. Ajo e ka parë mirëadministrimin të lidhur ngushtë me të drejtat dhe liritë themelore, standard tashmë që pranohet gjerësisht si standard i qeverisjeve demokratike. Më poshtë, parimi i mirëadministrimit do të diskutohet më gjerësisht, me gjithë rëndësinë që ka për administratën publike të çdo vendi modern, anëtar i BE-së ose jo.

60 Disiplina e studimit të çështjeve etike në zbulimet dhe zhvillimet e biologjisë, mjekësisë dhe teknologjisë. Për më tepër *shih* <http://www.coe.fr/oviedo/edito-e.htm>, vizituar me datë 23.11.2015.

Cili është organi monitorues i Kartës?

Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) është gjykata kompetente, e cila shqyrton legjislacionin e BE-së ndër të tjera për mospërputhje me të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kartën, si dhe shqyrton përputhshmërinë e legjislacionit komunitar me legjislacionin e vendeve anëtare.

BE-së i është mundësuar të bëhet pjesë e KEDNJ, me hyrjen në fuqi të protokollit nr.14⁶¹ të KEDNJ⁶², por procedurat për ta arritur atë nuk janë përfunduar ende (mars 2016). Është finalizuar Draft-Marrëveshja e anëtarësimit të BE-së në KEDNJ⁶³. GJED iu kërkua nga Komisioni Evropian të shprehet lidhur me përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së të Draft-Marrëveshjes dhe me Opinionin nr.2/2013, GJED ka identifikuar disa probleme që duhen adresuar përpara anëtarësimit të plotë.

Disa mendime për mirëadministrimin

“Mirëadministrimi” vjen si koncept nga sistemi anglez. Është i formuluar *pozitivisht* si mirëadministrim ose *negativisht* si keqadministrim. Sipas deputetit anglez Richard Crossman, kryetar i dhomës së ulët britanike (*House of Commons*), keqadministrimi është “*paragjykim, neglizhencë, vonesë, mungesë kompetence, pakujdesi, absurditete, veprime pa vend, poshtërsi, perversitet, arbitraritet, e kështu me radhë...*”, njohur ndryshe si *Katalogu i Crossman-it*⁶⁴.

61 Shteti shqiptar e ka ratifikuar Protokollin nr.14, me datë 03.02.2006.

62 Neni 17 i Protokollit.

63 Për më shumë informacion mund t'i drejtoheni: <http://echrblog.blogspot.al/2013/04/accession-of-eu-to-echr-draft-agreement.html>, vizituar me datë 23.11.2015.

64 Për më shumë informacion mund t'i drejtoheni <http://hansard.millbanksystems.com/commons/1966/oct/18/parliamentary-commissioner-bill> vizituar me datë 23.10.2015.

Ndërsa, Kodi Evropian i Sjelljes së Mirë Administrative të BE-së paraqet më gjerë substancën dhe procedurën në lidhje me miradministrimin. Përkufizimi i dhënë nga Ombudsmani Evropian dhe i miratuar nga Parlamenti Evropian për keqadministrimin e veprimtarisë administrative të institucioneve të BE, është se:

*“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik nuk vepron në përputhje me një rregull apo parim i cili është i detyrueshëm për të”.*⁶⁵

Sipas Komisionit Evropian të BE, pesë parime të kombinuara formojnë bazën e mirëqeverisjes:

Transparenca: institucionet duhet të jenë të hapura për procesin e vendimmarrjes;

Pjesëmarrja: individët sistematikisht duhet të jenë pjesë e politikave dhe ligjbërjes, duke i pyetur dhe duke i marrë mendime;

Përgjegjësia: roli i gjithsecilit duhet të jetë i qartë dhe duhet të merret përsipër nga përgjegjësit realizimi i tij;

Efektiviteti: vendimet duhen marrë në kohën e duhur dhe duhet të sjellin rezultatin e duhur; si dhe


Koherenca: politikat duhen ndjekur dhe zbatuar me koherencën e duhur, duke shmangur ndryshueshmërinë⁶⁶

Duke iu referuar elementëve më sipër nga

65 The European Code of Good Administrative Behaviour [Kodi Evropian i Sjelljes së Mirë Administrative]. Për më tepër shih: http://ec.europa.eu/civil_society/code/index_en.htm, vizituar me datë 10.10.2015.

66 Communication from the Commission of 25 July 2001 “European governance - A white paper” COM(2001) 428 final - Official Journal C 287 of 12.10.2001 [Qeverisja europiane – Libri i bardhë, Komunikim i Komisionit i datës 25 korrik 2001], edisponueshme online: http://www.etsi.org/WebSite/document/aboutETSI/EC_Communications/Governance_com2001_428.pdf vizituar me datë 13.10.2015

Komisioni Evropian, konstatohet që në fakt të gjithë janë standarde të kërkuara administrative në ofrimin e shërbimeve publike nga administrata publike. Kjo do të thotë se brenda konceptit të mirëqeverisjes përfshihet dhe koncepti i mirëadministrimit, i cili, siç e theksuam më lart në Kartë, BE e sheh të lidhur ngushtë me të drejtat dhe liritë themelore.



Mirëadministrimi përfshin shumë elementë. Të bëhet një klasifikim shterues është e vështirë ndër të tjera sepse nuk është i rregulluar në mënyrë uniforme në të gjitha sistemet ligjore. Gjithsesi, nëpunësve civilë u ofrohen të 5 elementët e mirëadministrimit nga BE, për të reflektuar dhe diskutuar mbi to, si dhe për t'i ndërgjegjësuar për rëndësinë e mirëadministrimit dhe lidhjet që ka me të drejtat e njeriut dhe me kulturën, ku këto të drejta respektohen.

Siç mund të kuptohet dhe nga një tërësi dokumentesh ndërkombëtare, nëpunësit civilë kanë detyrime që janë të lidhura përveç se me respektimin e të drejtave të njeriut dhe me mirëadministrimin dhe qeverisjen demokratike. Sigurisht, sfidave të qeverisjes së një

vendi që udhëhiqet nga parimet e shtetit të administratë publike që ka standardet e du-
së drejtës, nuk mund t'i përgjigjet veçse një hura dhe të kërkuara evropiane të qeverisjes.

USHTRIMI NR. 8

Pjesmarrësit ndahen në grupe të vogla, dhe i kërkohet të japin raste konkrete për secilin element në veprimtarinë e tyre të përditshme, ose të institucionit ku punojnë, sipas skemës së prezantuar më sipër. Një përfaqësues i çdo grupi ftohet të tregojë se cilat situata apo raste do të konsiderohen si pjesë e administrimit të mirë, ose, anasjelltas, administrimit të keq



IV. Konteksti shqiptar për kulturën e të drejtave të njeriut; roli i etikës

Shqipëria, ashtu si vende të tjera të Evropës Lindore, duke filluar nga viti 1990⁷ ka kaluar në shumë reforma dhe procese ekonomike, politike, sociale, kulturore dhe juridike. Kalimi nëpër këto reforma është bashkëshoqëruar me paketa kushtetuese dhe ligjore, të cilat kanë qenë shpesh objekt i ndryshimeve, duke sjellë jo gjithmonë rezultate të pritshme.

Një nga arsyet përse procesi i reformave është kaq i vështirë gjendet në faktin se nuk mund të shkëputet nga konteksti, tradita, kultura dhe historia e vendit në fjalë. Në veçanti, krijimi i institucioneve të administratës publike, marrëdhëniet ndërmjet tyre, në kuptim të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit, si edhe respektimi i dinjitetit të individëve dhe të drejtave dhe lirive themelore të tyre, është shumë i lidhur me këto faktorë.

Të gjitha sistemet politike që kalojnë nga regjimet autoritare në demokraci kanë një nevojë të madhe për të forcuar institucionet publike. Shqipëria si një vend me demokraci të brishtë nuk përbën përjashtim nga kjo tendencë. Forcimi i institucioneve publike që ushtrojnë veprimtari administrative në shërbim të qytetarit nuk përbën qëllim më vete, por është në funksion të nevojës dhe detyrimit për të respektuar të drejtat themelore të njeriut dhe dinjitetin njerëzor.

Respektimi i dinjitetit njerëzor është i lidhur në një masë të madhe me integritetin dhe me etikën e sjelljes së institucioneve publike. Nuk ka respektim të dinjitetit njerëzor, nëse nuk ka qeverisje me integritet dhe etikë⁶⁷.

Etika është gur themeli për mirëqeverisjen, si dhe parakusht i legjitimitetit të veprimeve të një qeverie⁶⁸. Në lidhje me etikën është edhe koncepti “integritet”, madje në literaturën bashkëkohore shpesh sugjerohet që të trajtohen bashkarisht, për të dhënë rezultatet e duhura në drejtim të parandalimit të korrupsionit në administratë publike dhe forcimit të integritetit të administratës publike⁶⁹. Etika dhe integriteti nuk janë koncepte të lehta për t’u përkufizuar. Shumë përkufizime përdoren me mbivendosje ose me ndryshime të thella mes tyre.

Termi “integritet” vjen nga latinishtja “in-tan-

67 *Shih VKM nr.247, datë 20.03.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020”, pjesë e strategjisë është dhe forcimi i integritetit të administratës publike. E disponueshme on-line: http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages_files/15-04-01-05-52-47Strategjia_antikorupsion_2015_2020_dhe_plani_i_veprimit.pdf, vizituar me datë 8.11.2015*

68 Integrity Framework, OECD [Kudri i veprimtarisë për integritetin], e disponueshme on-line: <http://www.oecd.org/gov/44462729.pdf>, vizituar me datë 07.10.2015

69 Ethics training for public officials, [Trajtime të zyrtarëve publikë mbi Etikën], OECD, ACN, SIGMA, mars 2013, fq.9, e disponueshme on line; <http://www.oecd.org/corruption/acn/library/EthicsTrainingforPublicOfficialsBrochureEN.pdf>, vizituar me datë 07.10.2015

gere”, që do të thotë “i paprekur”. I referohet pakorruptueshmërisë si dhe gjendjes së të qenit i padëmtuar/papërlyer. Në fjalorin Anglisht të Oksfordit (FAO), renditen 3 kuptime të fjalës integritet: (i) të qenët pa asnjë pjesë apo element të hequr apo që mungon; të qenët i pandarë apo i pathyeshëm; plotësi materiale, tërësi. (ii) të qenët i padëmtuar apo i dhunuar; të qenët i kthjellët apo i pakorruptuar; gjendje e përsosur fillestare; qartësi; (iii) në kuptimin moral gjendje morale e pacenuar, pakorrupsion moral, pafajësi, pamëkatshmeri⁷⁰.

Megjithatë, edhe pse gjerësisht integriteti është shumë i lidhur me mungesën e mashtrimit dhe të korrupsionit, ai implikon dhe dinjitetin dhe standardet e sjelljes së duhur jodiskriminuese dhe jokërcënuese. Në këtë kontekst, është koncept pozitiv dhe i gjerë i lidhur edhe me kulturën.

Fjala “kulturë” vjen nga latinishtja, dhe do të thotë “të rrisësh, të ruash, të kultivosh”. Nga mesi i shekullit 19, kjo fjalë është lidhur me idetë për traditat kolektive dhe mënyrën e të jetuarit të shoqërive të ndryshme. Me “kulturë” kuptohet një element i trashëguar dhe një kuptim i përbashkët mbi të nga anëtarë të së njëjtës shoqëri.⁷¹

Një koncept më gjithëpërfshirës dhe institucional për kulturën e ka dhënë Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (*shih* më sipër Konventën përkatëse të OKB-së), si vijon:

“Kultura [...] nënkupton, inter alia, mënyrën

70 Cituar nga Stephen L. Carter “Integriteti”, Vernon Publishing, 2008, fq.30

71 Compass, “Manual for human rights education with young people” [Manuali për edukimin e të rinjve me të drejtat e njeriut], botim i rishikuar dhe përditësuar, Këshilli i Evropës, tetor, 2012, perifraxim, fq. 449.

e të jetuarit, gjuhën, gjuhën e shkruar dhe të folur, muzikën, këngët, komunikimin jo verbal, sistemin e besmimit dhe të fesë, ritet dhe ceremonitë, sportet dhe lojrat, metodat e prodhimit, ose teknologjinë, ambientin natyral, ushqimin, veshjet, strehimin dhe artin, traditat nëpërmjet të cilave individët ose grupe individësh dhe komunitet shprehin veten dhe kuptimin që i japin ekzistencës së tyre, dhe ndërtojnë pikëpamjet e tyre mbi botën duke prezantuar kryqëzimin e tyre me forca të jashtme që ndikojnë në jetën e tyre”.

Pra, kultura mund të konsiderohet si elementi nëpërmjet të cilit ne shikojmë dhe interpretojmë jetën dhe shoqërinë (mënyrë dhe stil të jetuari). Kjo nënkupton se kultura duhet parë si një sistem i tërë vlerash, simbolesh dhe praktikash, të cilat me kalimin e kohës prodhojnë standarde sjelljeje dhe të marrëdhënieve sociale në jetën e përditshme⁷².

Kultura lidhet gjithashtu me konceptin “etikë”, e cila do të thotë më shumë se sa t’u referohesh vetëm ligjeve dhe rregullave.⁷³ Kultura është pjesë e rëndësishme që dikton sjellje dhe veprime me etikë të individëve, dhe më pas po të këtyre individëve si mbajtës të funksioneve publike (nëpunësit publikë). Etika apo integriteti nuk është vetëm çështje e nivelit personal, pra përgjegjësi e çdo nëpunësi për sjelljen tij individuale etike ose jo, por është para së gjithash çështje institucionale, që do

72 Asbjorn Eide, Catarina Krause, Allan Rosas, “Economic, Social and Cultural Rights”, second revised edition [Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, botimi i dytë i rishikuar], Shtëpia botuese, Martinuss Nijhoff, 2001, fq.89.

73 lam L.Richter, Frances Burke, “Combating corruption, encouraging ethics, A practical guide to management ethics” [Të luftosh korrupsionin, të inkurajosh etikën - “Një udhëzues praktik mbi zbatimin e etikës], 2007, fq.4.

të thotë se institucionet duhet të strukturohen, të përcaktojnë procese, instrumente dhe strategji që inkurajojnë dhe mbështesin sjelljen etike dhe me integritet. Në këtë mënyrë fokusi mbi çështjet e integritetit i kalon institucionalizimit të tij, nëpërmjet institucioneve përkatëse. Profesorët e shquar të etikës organizative, Trevino dhe Nelson (2004) janë shprehur se: *“Të heqesh mollët e këqija nga një institucion përgjithsisht nuk do ia zgjidhë problemin joetik institucionit. Institucioni duhet të shqyrtojë brenda vetes nëse ka të rrënjosura praktika apo procedura që i bëjnë mollët të kalben”*.

Në vitin 2003, u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë “Ligji për Etikën”, duke synuar vendosjen e rregullave për etikën në administratën publike. Ligji për Etikën mbetet në fuqi, i pandryshuar, edhe sot, dhe vlen të lexohet dhe rilexohet nga çdo nëpunës publik. Por, sigurisht, thjesht listimi i parimeve për etikën në administratën publike nuk e ndryshon kulturën brenda ditës, ose brenda viteve.

Ka praktika që mund të kenë ndikim negativ në etikën dhe të drejtat e njeriut. Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut kërkojnë që praktikat dhe traditat e dëmshme të vihen në diskutim dhe të luftohen. Shumë praktika të dëmshme kërkojnë edukim pasi nuk mjafton vetëm miratimi i ligjeve dhe sanksionet, për t’i luftuar ato. Ndryshimi i tyre nuk mund të diktohet “nga lart”, por kërkon arsimin dhe edukim⁷⁴.

Sipas Ligjit për Etikën, në kryerjen e funksioneve, nëpunësi i administratës publike duhet të respektojë disa parime që kanë lidh-

74 Compass, “Manual for human rights education with young people” [Manual për edukimin e të rinjve me të drejtat e njeriut], botim i rishikuar dhe përditësuar, Këshilli i Europës], tetor, 2012, fq. 392-393.

je me ushtrimin e detyrës në mënyrë etike, në mënyrë të tillë, që besimi i publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik të ruhet e të rritet⁷⁵.

Po ky ligj trajton dhe procedurën e marrjes së dhuratave. Lind pyetja: si të zbatohen në jetën përditshme normat e etikës? Sa e vështirë apo sa problematike mund të jetë zbatimi i ligjit për etikën në situata të vështira për nëpunësin publik? Përpara cilave dilema ndodhet ai/ajo? Është e qartë që problemet nuk vijnë nga Kushtetuta, ligji, apo teoria, ato vijnë mbi të gjitha nga vështirësia në zbatim⁷⁶. Dhe kjo lidhet, pjesërisht, me kulturën e vendit dhe zakonet që ekzistojnë prej kohësh.

Veprimtaria administrative është veprimtari e institucioneve, por dhe e nëpunësve publikë, që në fund të fundit janë njerëz dhe si të tillë mund të gabojnë. Tundimet, dilemat morale, dobësitë, kultura përreth nesh, struktura organizative e institucioneve, stilet drejtuese dhe menaxheriale të titullarëve dhe *leadership*-it institucional, nuk e bëjnë të lehtë të vepruarin me etikë dhe integritet të nëpunësit publik edhe në qoftë se e dëshiron këtë gjë⁷⁷. Ndër të tjera, etika kërkon strukturë dhe organizim; ajo kërkon hapësirë për mendimet e nëpunësve civilë dhe diskutimin se çfarë dilemash ka dhe si t’i japë zgjidhje situatave të vështira⁷⁸.

Gjithsesi, nëpunësit publikë duhet të jenë gjithmonë ‘në kërkim të rritjes’, së besimit

75 Neni 3 i Ligjit për Etikën.

76 Henk Bruning, “Finding Inspiration and Integrity in Public Services, (...) To Be Honest” [Të gjes frymëzim dhe integritet në shërbimet publike], ISBN 978-94-9106-142-4, publikim i parë, botuar në Spanjë nga Caslon S.L. Madrid, 2014, fq.43. Për më tepër referojuni *on-line*: www.henkbruning.nl

77 Po aty, fq.93.

78 Po aty, fq.100.

të publikut ndaj sektorit administrativ-publik. Zakonet mund të ndryshohen edhe pse procesi nuk është i lehtë. Nën këndvështrimin e publikut, sjellja etike është domosdoshmëri, pasi ajo krijon besimin e duhur se qytetari po merret në konsideratë, edhe nëse në substancë nëpunësi publik nuk ka mundësi t'ia zgjidhë çështjen.

Gjithashtu, në momente të tjerë, nëpunësi publik bëhet pjesë e “publikut” i cili hyn në veprim dhe përballet me administratën për shërbime që mund të kërkojë edhe vetë prej saj si dhe për çështje të tjera, dhe sigurisht që do të përfitojë nga sjellja etike, si qasje mbizotëruese në administratë publike, edhe për shkak të rolit të tij personal në krijimin e një klime favorizuese ndaj respektimit të etikës.



Jo çdo çështje etike/administrative është çështje e të drejtave të njeriut, por gjithsesi në një shkallë të caktuar mund të kthehet në çështje e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor. Më e përshtatshme, është që çdo çështje të trajtohet në mënyrë etike, korrekte dhe të sjellshme, për mirëfunksionimin e jetës publike

USHTRIMI NR. 9

Në Ministrinë e Drejtësisë, u mbajt një seancë dëgjimore me grupet e interesit për projekt- ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronave. Disa shoqata që kanë objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e pronës kishin përfaqësues në këtë tryezë dhe dëshironin të paraqisnin pikëpamjet e tyre. Përfaqësues të Ministrisë gjatë këtij takimi në diskutim e sipër, për shkak se disa prej tyre, nuk artikulonin qartë pretendimet nga pikëpamja juridike, u ndërprisnin fjalën me arrogancë e nervozizëm, deri në përçmim.

PYETJE

A ka probleme etike kjo situatë? A është çështje e të drejtave të njeriut, trajtimi me dinjitet i përfaqësuesve të shoqatave në këtë rast? A përbën sjellja jo e duhur e administratës ndaj publikut, shkelje të të drejtave të njeriut? Deri ku mund të konsiderohet problem etike gjuha përçmuese, dhe ku ndahet me gjuhën e urrejtjes si shqetësim dhe viktimizim dhe për rrjedhojë dhe diskriminim dhe cënim i dinjitetit njerëzor? Po nëse në tryezë do të ishin vetëm specialistë juristë të çështjeve të pronësisë, që flasin me gjuhën e ligjit, a do të quhej i plotësuar detyrimi i administratës publike për të dëgjuar dhe grupet e interesit, para se të marrë vendimet e saj?

OBJEKTIVI

Diskutimi duhet të jetë i lirë dhe i gjerë; të trajtoj shumë çështje dhe dilema me rëndësi sa i përket etikës, ndërjegjësimit për rëndësinë e komunikimit etik të nëpunësit civil, metodave të konsultimit publik, si dhe respektimit të dinjitetit njerëzor nga nëpunësit publikë.

USHTRIMI NR. 10	X është nëpunës civil, pranë Sektorit të Politikave të Punësimit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Gjatë ditës ndodh që ai personalisht të pranojë deri 20 aplikime pranë sportelit. Ky pozicion pune e vë shpeshherë në presion, pasi komunikimi i përditshëm me publikun është i vështirë. Një ditë i paraqitet për aplikim një person që nuk dinte të shkruante dhe i kërkon ndihmë për plotësimin e formularit . Ai i përgjigjet: “Një person që nuk di të shkruajë vetëm pastruesin mund të bëjë”. Gjithsesi, formularin ia plotësoi.
PYETJE	Cilat elementë të etikës mund të vihen në diskutim në këtë çështje? Po në drejtim të të drejtave të njeriut, a konstatohet ndonjë shkelje? Nëse po, për çfarë shkelje bëhet fjalë?
OBJEKTIVI	Ky rast ofrohet për ndërgjegjësim për rëndësinë e komunikimit etik, për reflektim dhe zhvillim të aftësive vepruese me publikun.

USHTRIMI NR. 11	Një person me origjinë rome, pretendon para KMD se është ofenduar mbi bazën e origjinës së tij etnike/racore dhe besimit fetar nga autoritetet e spitalit shtetëror, ku qëndroi prej disa javësh me një sëmundje serioze, dhe sidomos nga një anëtar i personelit i spitalit me inicialet J.V. Në veçanti, kërkuesi pretendon se autoritetet përkatëse të spitalit i kanë adresuar atij fjalë të tilla si, “rom i ndyrë” dhe “jevg”, si dhe të tjera ofendime me bazë etnike/racore. Ai/ajo paraqiti dhe deklarata të personave që kanë qenë të pranishëm për të mbështetur vërtetësinë e deklaratave mbi komentet diskriminuese. Gjithashtu, ai pretendon se nuk është vizituar nga doktori në kohën e duhur, dhe pas vizitës, nuk i janë dhënë trajtimet mjekësore sipas porosisë së këtij të fundit nga stafi ndihmës mjekësor. Ai/ajo pretendon pamjaftueshmëri kujdesi shëndetësor dhe trajtim diskriminues, bazuar në gjuhën e urrejtjes
PYETJE	Konsideroni rastin në kontekstin e legjislacionit kombëtar ose përshkruani se si do të konsiderohej nga autoritetet kompetente situata. Në veçanti, merrni parasysh pyetjet specifike: <ul style="list-style-type: none"> • A është ky rast në rrezën e veprimit të Ligjit për Etikën apo legjislacionit të të drejtave të njeriut, konkretisht kundër diskriminimit? Në rastin konkret, ku qëndron kufiri ndarës mes të dyjave? • A është gjuha e përdorur në përputhje me standardet e kërkuara të etikës për një administratë publike moderne?
OBJEKTIVI	Familjarizim me situatat e ndryshme, ku potencialisht mund të lindë diskriminimi. Ndërgjegjësim për gjuhën e kujdesshme që duhet përdorur në komunikim me publikun.



V. E drejta për mosdiskriminim, barazia përpara ligjit

DISA KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

E drejta për të mos u mosdiskriminuar është një nga të drejtat e njeriut që preket më shumë në marrëdhëniet e administratës publike me qytetarët. Të gjithë mund të kemi paragjykimet kundër njerëzve të ndryshëm për shkaqe të ndryshme, por qenia “nëpunës civil” do të thotë që paragjykimet të lihen mënjanë dhe çdo qytetar të trajtohet me dinjitet.

Në Kushtetutë përcaktohet se të gjithë janë të barabartë para ligjit. Ndalohet diskriminimi mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhë, bindje politike, fetare e filozofike, gjendje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ose shkaqe të tjera. Askush nuk mund të diskriminohet nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive⁷⁹.

Ky parim themelor shtjellohet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (nr. 10221/2010), sipas të cilit, kushdo që ka pretendime të lidhura me diskriminimin të shkaktuar nga organet apo nëpunësit e administratës publike mund t’i drejtohet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me të drejta vendimmarrëse ndaj organit apo personit që ka shkaktuar diskriminimin, ose drejtpërdrejt në gjykatë. Paraqitja e ankimit përpara KMD nuk është kusht për të paraqitur një kërkesë padi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar

t’i drejtohet gjykatës, ose organeve të ndjekjes penale⁸⁰. *(shpjeguar më në detaj në vijim të këtij kapitulli).*

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë objektivisht në kushte të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Shprehja “barazia para ligjit” nënkupton faktin se organet zbatuese nuk duhet të zbatojnë ligjin në mënyrë të diferencuar për njerëz në të njëjtën situatë.

Arsyet për të cilat individët mbrohen nga diskriminimi përfshijnë, por nuk janë të kufizuara tek raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, qytetaria, origjina sociale dhe kombëtare, pronësia, paaftësia dhe gjendja familjare.

Koncepti “çdo situatë tjetër”, sipas GJEDNJ, do të thotë edhe pse shkaqe të tjera mund të mos jenë të përmendura shprehimisht, gjithsesi çdo individ mund të paraqesë pretendime për çdo lloj arsyeje tjetër, për të cilën ai mendon se po diskriminohet. Pra, lista e shkaqeve për të cilat një individ mund të kërkojë mbrojtje nuk është shteruese.

“Orientimi seksual”, si shkak tjetër, gjendet

79 Neni 18 i Kushtetutës.

80 Neni 34/2 i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

për herë të parë në jurisprudencën e Strasburgut në një çështje të vitit 1981⁸¹, me anë të të cilit u sfidua legjislacioni që kriminalizonte marrëdhënien mes personave të seksit të njëjtë në Irlandën e Veriut. ‘Seksualiteti’ u bë për herë të parë një shkak i arsyeshem për diskriminim, edhe pse nuk parashikohej në listën e arsyeve për diskriminim sipas nenit 14 të KEDNJ.

Në atë çështje, GJEDNJ u përqendrua në efektet e dëmshme që një legjislacion i tillë mund të kishte në orientimin seksual të një njeriu dhe në rastin konkret të aplikantit. Gjykata i dha përgjigje pyetjes, nëse legjislacioni në diskutim ishte akoma “*i nevojshëm në një shoqëri demokratike*” - *dy shtyllat e së cilës janë, toleranca dhe të qenit mendjehapur*⁸².

Edhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shtuar në mënyrë të shprehur “orientimin seksual”, si shkak diskriminimi, ndaj të cilit ofrohet mbrojtje kushtetuese dhe ligjore⁸³.

Ndërsa Protokollin 12 i KEDNJ ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashikuar nga ligji”. Në Raportin Shpjegues të KiE, shpjegohet se kjo dispozitë lidhet me diskriminimin:

- » në gëzimin e çdo të drejte specifikisht të dhënë një individ sipas ligjit kombëtar;
- » në gëzimin e një të drejte, që mund të dalë nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas ligjit kombëtar, d.m.th., ku një autoritet publik ka si detyrim sipas ligjit kombëtar të sillt në një mënyrë të caktuar;

81 Çështja Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikim nr. 7525/76, vendim i datës 22 tetor 1981.

82 Prg.54 i vendimit Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar.

83 Neni 1 i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- » nga një autoritet publik në ushtrimin e kompetencave diskrecionare (për shembull, akordimi i disa subvencioneve);
- » nga çdo veprim ose mosveprim tjetër i një autoriteti publik (për shembull, sjellja e oficerëve të policisë gjatë kontrollimit të një trazire)⁸⁴.

Testi kushtetues i diskriminimit “në ligj”

Kushtetuta duke sanksionuar parimin e barazisë, nuk i ka dhënë asaj kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar një-kohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjithashtu pranon kufizimet.

Në çdo rast konkret, fillimisht shtrohen pyetjet:

- » a ndodhemi përballë një trajtimi jo të barabartë?
- » a është kjo pabarazi e justifikuar?

Për të kontrolluar nëse ndodhemi para një justifikimi kushtetues dhe ligjor të trajtimit të diferencuar duhet të qartësohet (i) cili është shkak i diferencimit?; (ii) a është bërë diferencimi për një shkak të arsyeshem?; (iii) a është diferencimi në përpjestim të drejtë me shkakun?

Dallimi në trajtim do të konsiderohet diskriminues, kur nuk ka justifikim të arsyeshem

84 *Shih* për më tepër Protokollin nr.12 të KEDNJ, së bashku me Raportin Shpjegues, i disponueshem online: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Reports/Html/177.htm>, vizituar me datë 20.10.2015

e objektiv, kur nuk ndjek një “qëllim të ligjshëm” ose kur nuk ekziston “...marrëdhënie e arsyeshme dhe përpjesëtimore ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet”⁸⁵.

Që mjetet e përdorura të konsiderohen proporcionale, duhet që ato:

- » të jenë të duhura dhe të nevojshme për të arritur qëllimin;
- » të mos jenë më të ashpra se sa duhet për të arritur qëllimin;
- » të kenë efektin negativ më të voglin të mundshëm, nëse është e pamundur që të shmanget.

Justifikimi kushtetues duhet të jetë i pranishëm në çdo kufizim kushtetues. Për të plotësuar këtë kusht, duhet të kuptohen ar-

syet e diferencimit. Në rast se nuk ka asnjë shkak ose arsye për diferencim, atëherë ndodhemi para një shkeljeje. Për rrjedhojë, duhet parë nëse diferencimi është i bazuar ose jo.

Të njëjtat pyetje duhen shtruar, jo vetëm kur nëpunësi civil i trajton ndryshe personat, por edhe kur ai trajton të gjithë në mënyrë të barabartë pavarësisht se ato paraqiten me specifika të ndryshme.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shtjelluar këto parime. Sipas këtij ligji, parimi i barazisë nënkupton: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.⁸⁶



Mbani mend: Parimi i barazisë kërkon që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat të tjera ligjore.

Testi i diskriminimit “para ligjit”

Diskriminimi mund të shfaqet jo vetëm gjatë veprimtarisë ligjvënëse, por edhe gjatë veprimtarisë administrative të organeve të administratës publike⁸⁷. Nëpunësi civil duhet të ketë parasysh gjatë veprimtarisë administrative, të trajtojë individët që janë në kushte të njëjta në mënyrë të barabartë, dhe të shmangë diskriminimin për çfarëdo arsye.

Jo vetëm Kushtetuta dhe Ligji për Mbrojtjen

nga Diskriminimi, por edhe KPA e trajton këtë çështje. Në nenin 17, KPA parashikon se:

1. *Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë.*
2. *Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë.*
3. *Organi publik, gjatë ushtrimit të vep-*

⁸⁵ Vendimet nr.34, datë 20.12.2005; nr.39, datë 16.10.2007; nr.4, datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese

⁸⁶ Neni 2 i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁸⁷ Mosdiskriminimi shtrihet si mbrojtje edhe në fushën e marrëdhënieve private nga aktorë institucionalë privatë, apo persona fizikë ose juridikë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka të drejta mbikëqyrjeje dhe hetimi administrativ edhe ndaj tyre. Manuali nuk trajton këtë kategori, sepse i drejtohet administratës publike.

rimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjeg-

jësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër”.

Si shfaqet diskriminimi në veprimtarinë e administratës publike?

- » Diskriminimi shfaqet nëpërmjet veprimit ose mosveprimit administrativ, që do ta vendoste një person ose grup personash në një situatë të disfavorshme me të tjerët.
- » Ky veprim mund të bëhet nëpërmjet aktit administrativ individual ose normativ/kolektiv; kontratës administrative⁸⁸; çdo veprimi tjetër administrativ⁸⁹; mosveprimit administrativ; ose, më shpesh, thjesht nëpërmjet sjelljes së nëpunësit publik⁹⁰.
- » Siç e theksuam në kapitullin IV në lidhjen me kontekstin shqiptar, është e kuptueshme, se nëpunësit, si çdo njeri, mund të kenë paragjykime ose mendime përsa u përket kategorive të ndryshme njerëzish. Por profesionalizmi i shërbimit civil – dhe Kushtetuta, ligji shqiptar si dhe instrumentet ndërkombëtarë – kërkojnë një qasje tjetër, duke anashkaluar këto mendime.



Vini re: Parimi i barazisë çon në standardizimin e veprimtarisë së administratës publike, duke iu dhënë uniformitet dhe konformitet veprimeve dhe sjelljes së nëpunësit civil ndaj individëve.

Si jepet kuptimi i diskriminimit në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi?

- » Përkufizimi në ligjin shqiptar është i gjerë. Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të lidhur me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

88 Neni 3 i KPA.

89 Neni 3/11 i KPA, ku parashikohet se: “veprim tjetër administrativ”, është çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, që nuk plotëson kriteret për të qenë akt administrativ apo kontratë administrative dhe që sjell pasojë juridike për të drejtat subjektive dhe interesat legjitime.

90 Shih për më tepër Protokollin nr. 12 të KEDNJ, së bashku me Raportin Shpjegues, i disponueshëm online: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Reports/Html/177.htm>, vizituar me datë 13.11.2015.

Si shfaqet diskriminimi?

- » *Diskriminim i drejtpërdrejtë* - kur një person/grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person apo grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në shkaqet e parashikuara në ligj⁹¹
- » *Për shembull, ka diskriminim kur një qytetar që është duke pritur në sportelin e Zyrës së Gjendjes Civile për marrjen e një shërbimi trajtohet në mënyrë më pak të favorshme nga ç'trajtohet një qytetar tjetër që është duke pritur për të marrë të njëjtin shërbim vetëm sepse i pari ka miqësi me nëpunësin.*
- » *Diskriminim i tërthortë* - kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashikuara në ligj, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi nuk janë të përshtatshme, të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë⁹².
- » *Për shembull, rregullorja e brendshme e një institucioni përcakton se të gjithë nëpunësit mund të marrin pjesë në trajnime jo të detyrueshme në përputhje me pozicionin e tyre të punës, por në efekte praktike burimet njerëzore të disa drejtorive ishin nën kapacitet me infrastrukturë njerëzore, dhe asnjëherë nuk u jepej mundësia e largimit nga zyra; dhe për rrjedhojë nuk u krijohen shanse pjesëmarrjesh nëpër trajnime.*
- » *Diskriminim për shkak të shoqërimit* - kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të bashkuara për një nga shkaqet që përbën arsye diskriminimi, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë⁹³.
- » *Për shembull, kjo ndodh kur një avokat i cili shoqëron persona homoseksuale për t'i ndihmuar ato në një çështje administrative, trajtohet në mënyrë më ngadalë, sesa avoketërit për grupe të tjera.*
- » *Shqetësim* - ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet, që ka për qëllim apo efekt cënimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë. Fjala "ngacmim" përdoret gjithashtu në gjuhën e zakonshme për këtë lloj sjelljeje⁹⁴.

91 Neni 3/2 i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

92 Po aty, neni 3/3.

93 Po aty, neni 3/4.

94 Po aty, neni 3/5.

Si shfaqet diskriminimi?

- » Edhe “Gjuha e urrejtjes” përfshihet si formë e shprehjes së shqetësimit edhe në kuptim të Rekomandimeve të KiE⁹⁵, por edhe Direktivave të antidiskriminimit të BE⁹⁶.
- » *Për shembull, ndaj një qytetari të ardhur nga qyteti verior X, i cili kërkon një takim me titullarin e institucionit dhe edhe pse i shpjegohet që orari i pritjes fillon më vonë, ai këmbëngul për këtë takim dhe nëpunësi i sportelit, i drejtohet me fjalë fyese në lidhje me origjinën e tij nga veriu i vendit.*
- » *Udhëzim për të diskriminuar* - është një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, bazuar në shkaqet e diskriminimit.⁹⁷
- » *Për shembull, një titullar institucioni udhëzon nëpunësit e institucionit, që kategorinë e qytetarëve që vijnë nga zonat e varfra rurale të mos e kenë prioritet në trajtim, pasi sipas tij humbet kohë për këtë kategori të pashkolluar dhe që nuk dinë çfarë kërkojnë.*
- » *Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme* - ndodh kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara.⁹⁸
- » *Për shembull, kur një nëpunësi civil, i cili vuan nga një sëmundje e rëndë i duhet që të marrë trajtim dhe ta ndjekë sëmundjen në vazhdimësi, duhet t'i bëhet shpërndarja e arsyeshme të punës tek kolegë të tjerë; mosmarrja parasysh e këtij problemi mund të përbënte mohim të përshtatjes së arsyeshme.*
- » *Viktimizimi* - trajtimi i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë.⁹⁹
- » *Për shembull, kemi viktimizimin kur një qytetar ka botuar një artikull në gazetë për punë të dobët të Zyrës së Pasurive të Paluajtshme, dhe trajtohet keq, si hakmarrje, kur paraqitet pranë kësaj zyre për të marrë shërbimin përkatës.*

95 KiE me Rekomandimin nr. 97(20) ka dhënë këtë përkufizim: “Me gjuhë të urrejtjes duhet kuptuar të gjitha format e shprehjes të cilat shpërhapin promovojnë nxisin ose justifikojnë urrejtje raciale, ksenofobi, ose forma të tjera bazuar në mungesë tolerance e shprehur me nacionalizëm agresiv, etnocentrizëm, diskriminimin, armiqësi ndaj minoriteteve, migrantëve, dhe njerëzve me origjinë emigratore”. (përkthim jozyrtar).

96 Directive 2012/29/EC “Establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA, 25 tetor 2012, (Direktiva 2012/29/KE Mbështetja e viktimave); Directive 2000/43/EC “Implementing the principle of equal treatment between persons irrespective of racial or ethnic origin”, datë 25 qershor 2000 (Direktiva 2000/43/KE “Mbi mosdiskriminimin mbi baza raciale”).

97 Neni 3/6 i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

98 Po aty, neni 3/7

99 Po aty, neni 3/8.

Cili është organi monitorues i mbrojtjes nga diskriminimi?

- » Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është organi monitorues për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. KMD është organ vendimmarrës që kryen hetime administrative dhe merr vendime. Është krijuar me Ligjin në vitin 2011, d.m.th., është relativisht i ri, por në zhvillim e sipër¹⁰⁰.

Si vihet në lëvizje KMD?

- » KMD vihet në lëvizje me ankesë nga personat (fizikë ose juridikë), grup personash, organizatat me interesa legjitime, apo me iniciativë¹⁰¹.
- » Kjo do të thotë që një individ, i cili mendon që është trajtuar në mënyrë diskriminuese nga një nëpunësi civil mund të ankohet drejtpërdrejt te Komisioneri.

Cilat janë kompetencat e KMD?

- » të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar;
- » të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi;
- » të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të ligjit;
- » të vendosë sanksione administrative me gjobë,
- » të nxisë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit,
- » të monitorojë zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹⁰².

A mbahet përgjegjësi nga nëpunësit publikë, në rast të mosrespektimit të parimit të mosdiskriminimit?

- » Çdo person mban përgjegjësi, kur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka kryer një akt diskriminues në kuptimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Përgjegjësia individuale nuk e përjashton përgjegjësinë e shtetit. Personat fizikë mund të gjobiten në rast vërtetimi shkeljeje nga KMD.

100 Po aty, neni 21.

101 Po aty, neni 33.

102 Po aty, neni 32.



Në përmbledhje, duhet theksuar se parimi i mosdiskriminit e ka rëndësi qendrore në shtetin e së drejtës dhe në administratën publike moderne dhe profesionale, që po krijohet në Shqipëri.

Më poshtë jepen disa kazuse për ta shtjelluar këtë parim si dhe të për të dhënë shembuj konkretë të parimit në veprim.

USHTRIMI NR. 12	<p>Pranë një shtëpie azili shtetërore, jetonte personi X, një e moshuar që lëvizte me karrige me rrota. Ajo kishte nevojë për ndihmë specifike, konkretisht, të mbante temperaturën e trupit në një nivel të caktuar ngrohtësie gjatë natës, dhe t'i garantohej kjo nxehtësi në dhomën ku rrinte. Ajo u ankua pranë autoriteteve përkatëse, sipas të cilëve, asaj i garantohej e njëjta nxehtësi sikundër dhe të gjithë banorëve të shtëpisë. Ngrohja ishte me sistem qendror, kështu që sipas Drejtorit, të gjithë furnizoheshin njësoj; për rrjedhojë po trajtoheshin në mënyrë të barabartë para ligjit. Ankuesja pretendoi diskriminim dhe shkelje e së drejtës për trajtim njerëzor dhe dinjitoz.</p>	USHTRIMI NR. 13	<p>Pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit u paraqit një djalë/ose vajzë, për aplikim për punësim. Formulari i preferencave të punësimit, kishte të radhitura disa sektorë dhe pozicione pune, të cilat ai duhet të plotësonte bazuar në kualifikim dhe preferencën tij të parë. Sapo filloi të plotësonte formularin, nga nënpunësja i tha: "... tre vendet e para të punës mos i plotëso, sepse ngjan si vajzë/si djalë, nuk besoj se janë për ty ato pozicione...".</p>
PYETJE	<p>A jemi para diskriminimit në këtë rast? Në rast se po, në vlerësimin tuaj për çfarë lloj diskriminimi bëhet fjalë, i drejtpërdrejtë, i tërthortë, shqetësim, etj.? Po para ndonjë të drejte tjetër? Nëse ka diskriminim, sipas jush, mbi çfarë shkakut?</p>	PYETJE	<p>A jemi para diskriminimit në këtë rast? Në rast se po, në vlerësimin tuaj për çfarë lloj diskriminimi bëhet fjalë, i drejtpërdrejtë, i tërthortë, shqetësim, etj.? Po para ndonjë të drejte tjetër? Nëse ka diskriminim sipas jush, mbi çfarë shkakut?</p>
OBJEKTIVI	<p>Të kuptohen qasjet e nëpunësve civilë ndaj ofrimit të shërbimeve publike. Të rritet ndërgjegjësimi për aksesin në shërbime publike të të gjitha kategorive të njerëzve sipas veçorive të tyre, në kuadrin e detyrimeve pozitive që duhet të ndërmarrin organet publike..</p>	OBJEKTIVI	<p>Të kuptohen qasjet e nëpunësve ndaj situatës. Të rritet ndërgjegjësimi për respektimin e së drejtës së aksesit në shërbime publike të të gjitha kategorive të njerëzve</p>

Fëmija X, 6 - vjeçar sapo ka filluar klasën e parë. Që në javën e parë të shkollës mësuesja mendoi se fëmija ishte autik dhe kërkoi largimin e fëmijës nga klasa e tij. Drejtoresha e Shkollës e përjashtoi fëmijën nga shkolla me argumentin se nuk ka vende dhe ai i përkiste një zone administrative tjetër dhe për rrjedhojë dhe shkollës fillore pranë kësaj zone. Prindërit u ankuan pranë Ministrisë së Arsimit, e cila la në fuqi vendimin e Drejtoreshës, duke përsëritur argumentin që fëmija duhej regjistruar në shkollën përkatëse.

Prindërit e fëmijës këmbëngulin që arsyeja e vërtetë e ç' regjistrimit nga shkolla nuk është "zona", pasi ndryshe fëmija nuk do të ishte regjistruar që në fillim në atë shkollë. Sipas tyre, autoritetet po i shmangen detyrimeve dhe nuk kanë vullnet të marrin përsipër arsimimin e fëmijëve sipas standardeve të detyrueshme ligjore. Po sipas tyre, fëmija është në kushtet e ndjekjes së një shkolle të zakonshme, pasi ata vetë janë konsultuar me psikologë e mjekë që u kanë rekomanduar që është në interesin më të lartë të fëmijës, përfshirja dhe përfitimi në procesin mësimor dhe jetën sociale me fëmijët e tjerë që nuk kanë nevoja të posaçme

PYETJE

Konsideroni rastin në kontekstin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar ose përshkruani se si do të konsiderohej nga autoritetet kompetente situata. Në veçanti, merrni parasysh pyetjet specifike:

- A është ky rast në rrezën e veprimit të legjislacionit kundër diskriminimit? A jemi para diskriminimit? Nëse po, mbi çfarë baze? A bien detyrime mbi Shkollën në rastin konkret? Po mbi Ministrinë e Arsimit?
- Çfarë duhet të vendosej nga organet përkatëse? A mendoni se do të kishte vend për penalitete? Nëse po, ndaj kujt dhe si?

OBJEKTIVI

Familjarizim me trajtimin e kujdesshëm të situatave të cilat mund të përmbajnë potencialisht rrezikun e diskriminimit ndaj qytetarëve, dhe konkretisht ndaj fëmijës. Ndërgjegjësim për mundësinë e penalteteve dhe ndëshkimeve ndaj personave shkaktarë të diskriminimit.



VI. E drejta për informim

Neni 23 i Kushtetutës garanton të drejtën e informimit, duke përcaktuar se kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore dhe personave që ushtrjnë funksione shtetërore.

Ligji për të Drejtën e Informimit, në fuqi që nga viti 2014¹⁰³, parashikon këtë të drejtë dhe rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. KPA parashikon se:

“1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit.

2. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces”¹⁰⁴.

103 Ka pasur një ligj tjetër për informimin e publikut, në fuqi që nga viti 1999, por Ligji i ri për të Drejtën e Informimit është më i detajuar.

104 Neni 6 i Ligjit për të Drejtën e Informimit.

CILI ËSHTË QËLLIMI I SË DREJTËS PËR INFORMIM?

- » Njohja me informacionet nga autoritetet publike, ose mundësia për t'i njohur qytetarët, është një nga shtyllat e një shoqërie në të vërtetë demokratike. “Fshehtësia” është karakteristike e qeverive totalitare ose autoritare. Zhvillimi i kësaj të drejte është një nga sfidat kryesore të shoqërive post-komuniste, siç është Shqipëria.
- » Duhet theksuar se, si nëpunës civil, detyra juaj nuk është të mbani informacionet ‘sekrete’ por të informoni personat e interesuar që i kërkojnë, sipas kufijve të ligjit. Sigurisht, dallimi i “kufijve” të ligjit nuk është i lehtë për ta bërë në çdo rast, por parimi i dhënies së informacioneve duhet të jetë gjithmonë parimi udhëheqës.
- » Në përmbledhje, qëllimi i të drejtës për informim mund të përkufizohet si:

garantimi i njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë;

garantimi i formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë; nxitja e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë të autoriteteve publike¹⁰⁵.

105 Neni 1 i Ligjit Për të Drejtën e Informimit.

Cilat subjekte kanë të drejtë të informohen?

» Si çdo e drejtë e njeriut, e drejta për informimin u përket të gjithëve. Kjo përfshin personat fizikë (shtetas shqiptarë, të huaj, si dhe pa shtetësi), personat juridikë, organizata jo-qeveritare (OJQ) dhe përfaqësuesit ligjore të personave fizikë ose juridikë.

Çfarë kuptohet me të drejtën e informimit?

» Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

» Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.

» Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

» Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit¹⁰⁶.

Çfarë kuptohet me informacion publik?

» “Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Kjo do të thotë se autoriteti publik është i detyruar të japë informacion dhe dokumentacion të prodhuar nga vetë autoriteti, nga autoritete të tjera publike, ose nga subjekte private, por që disponohen nga autoriteti publik¹⁰⁷.

Cilat janë autoritetet e detyruara për të dhënë informacion?

» Organet administrative të parashikuara në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj;

» Shoqëritë tregtare, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve dhe ku ushtrohen funksione publike;

» Çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor, ose çdo lloj forme tjetër, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike¹⁰⁸.

106 Po aty neni 3.

107 Po aty, neni 2/2.

108 Po aty, neni 2/1.

Çfarë detyrimi ka autoriteti publik pas kërkesës ?

» Sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit, autoriteti publik që merr një kërkesë është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.

Si vepron me kërkesat për kërkim dokumentacioni?

» Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit:

një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta;

një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

Cilat janë afatet e detyrueshme ligjore për plotësimin e kërkesës për informim?

» jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të kërkesës, autoriteti publik duhet ta trajtojë, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur;

» jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë, kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër;

» të dyja këto afate mund të zgjaten me jo më shumë se 5 ditë pune, për një nga shkaqet e mëposhtme:

a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;

b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;

c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës¹⁰⁹.



Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim nga nëpunësi civil brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.

109 Po aty, neni 15.

Cilat janë rastet e kufizimit të kërkesës për informacion?

- » Ligji për të Drejtën e Informimit parashikon se e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, kufizimi është proporcional dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:
 - a) të drejtën për një jetë private;
 - b) sekretin tregtar;
 - c) të drejtën e autorit;
 - d) patentat.

- » Po kështu e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, kufizimi proporcional dhe nëse dhënia e informacionit *shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë* ndaj interesave të mëposhtëm:
 - a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
 - b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
 - c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;
 - d) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;
 - e) formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;
 - f) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor;
 - g) këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike;
 - h) mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare¹¹⁰.



Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkesës. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilit argument ligjor është bërë refuzimi.

Këto kufizime janë në përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

¹¹⁰ Po aty, neni 17.

A ka format të detyrueshëm dhënia e informacionit?

- » Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-albania.al* apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare në *Internet* të autoritetit publik¹¹¹.
- » Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik. Autoriteti publik bën të mundur që informacioni, i cili i është dhënë të paktën një herë, një kërkuesi, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen¹¹².

A ka detyrim për pagesë kundrejt informacionit që merr?

- » Dhënia e informacionit është si rregull pa pagesë. Por, ky shërbim i administratës publike mund të ofrohet edhe kundrejt një tarife, sipas disa kritereve: (i) të jetë e përcaktuar më parë; (ii) të jetë e bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të *Internet*-it dhe në mjediset e pritjes së publikut¹¹³.

Çfarë do të konsiderohet tarifë?

- » Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas. Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg¹¹⁴.

Cili është organi monitorues për zbatimin e kësaj të drejte nga autoritetet publike?

- » Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) është autoriteti përgjegjës, që mbikëqyr dhe monitoron, të drejtën për informim të individëve si dhe shqyrton ankimet administrative. KDIMDP është institucion i pavarur¹¹⁵.
- » Ankimi administrativ pranë KDIMDP bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; ose b) ka kaluar afati i parashikuar në ligj për dhënien e informacionit¹¹⁶.

111 Po aty, neni 14/1.

112 Po aty, neni 9.

113 Po aty, neni 13.

114 Po aty, neni 13, prg.1 dhe prg.2.

115 Po aty, neni 24.

116 Po aty, neni 24/2.

Si vepron KDIMDP, pas përfundimit të procedurës administrative?

- » Pas përfundimit të procedurës administrative, KDIMDP ka të drejtë:
 - a) të rrëzojë ankimin
 - b) të pranojë ankimin dhe të urdhërojë dhënien e informacionit nga autoriteti publik, brenda një afati të caktuar; si dhe
 - c) të vendosë sanksione administrative, d.m.th., një gjobë¹¹⁷

A ka penalizim për nëpunësit civilë, në rast mosrespektimi të së drejtës për informim?

- » Mosrespektimi i dispozitave të Ligjit për të Drejtën e Informimit” passjell përgjegjësi administrative për titullarin e institucionit, koordinatorin për të drejtën e informimit (*shih përshkrimin e koordinatorit më poshtë*) si dhe për çdo nëpunës publik. Veprimet dhe mosveprimet sipas ligjit, për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë¹¹⁸. Konkretisht, çdo nëpunës i autoritetit publik ka përgjegjësi administrative në lidhje me:
 - a) dëmtimin ose shkatërrimin e dokumenteve zyrtare, me qëllim shmangien e së drejtës për informim;
 - b) moszbardhjen e dokumenteve zyrtare në kundërshtim me rregullat në fuqi, me qëllim;
 - c) pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim.¹¹⁹



Vini re se krahas gjobës, KDIMDP mund të propozojë dhe marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësit civil¹²⁰.

Kush janë koordinatorët e së drejtës për informim, dhe në cilat raste mbajnë përgjegjësi administrative?

- » Sipas nenit 10 të Ligjit për të Drejtën e Informimit, në çdo autoritet publik, titullari cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Koordinatori mban përgjegjësi për rastet e mëposhtme:
 1. Refuzimin e dhënies së informacionit,
 2. Moskrijimin, mosmbajtjen, mospublikimin apo përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve që duhet krijuar në çdo institucion,
 3. Mosplotësimin e kërkesave për informacione të regjistruara brenda afatit dhe sipas mënyrës së parashikuar me ligj,
 4. Mosregjistrimin e kërkesës për informim, moscaktimin e një numri rendor për të si dhe mosdhënien e të dhënave të kontaktit të Koordinatorit,
 5. Mosdërgimin e kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik,
 6. Dërgimin e kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik, kur autoriteti që e ka dërguar e ka informacionin,
 7. Mosnjoftimin e kërkuesit se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër publik,
 8. Mosrespektimin e kërkesave për dhënien falas të informacionit,
 9. Refuzimin e paarsyetuar të preferencës së kërkuesit për mënyrën e dhënies së informacionit,
 10. Mosnjoftimin e kërkuesit për vendimin për zgjatjen e afatit për plotësimin e kërkesës,
 11. Moskryerjen e njoftimeve paraprake mbi koston e lartë të kërkesës, ose për nevojën për më shumë kohë për trajtimin e saj.

117 Po aty, neni 24/5.

118 Po aty, neni 18.

119 Po aty, neni 19/4.

120 Po aty, neni 21/3.

Po titullarët e institucioneve, në cilat raste mbajnë përgjegjësi, kur nuk ia kanë deleguar kompetencat nëpunësit më të lartë civil?

- » Ligji për të Drejtën e Informimit ka parashikuar përgjegjësinë ligjore administrative të titullarëve, për sa vijon:
 - a) Mosvënien në zbatim të programit institucional të transparencës;
 - b) Mosrishikimin e programit institucional të transparencës, brenda afatit;
 - c) Mosndjekjen e procedurave për rishikimin e programit institucional të transparencës;
 - d) Mosrespektimin e kërkesave për dhënie falas të informacionit, për qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore si dhe subjektet përfituese sipas ligjit nr.10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”¹²¹.
- » Megjithatë, nëpunësit më të lartë civilë (Sekretar i Përgjithshëm, Drejtor i Departamentit ose Drejtor Drejtorie të Përgjithshme të institucioneve, ose pozicione të barazvlefshëm me to¹²²), mbajnë përgjegjësi për të gjitha kompetencat, që titullarët mund t’ia delegojnë sipas ligjit, në lidhje me respektimin e kërkesave të të drejtës për informim, për sa vijon:
 - a) Mosvënien në zbatim të programit institucional të transparencës;
 - b) Mosrishikimin e programit institucional të transparencës, brenda afatit;
 - c) Mosndjekjen e procedurave për rishikimin e programit institucional të transparencës;
 - d) Mospërcaktimin paraprakisht të një tarife, mospublikimi, ose caktimi i tarifave abuzive për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit¹²³.



Në përmbledhje, duhet theksuar që parimi i së drejtës për informim ka një rëndësi qendrore në shtetin e së drejtës dhe në administratën publike moderne dhe profesionale, e cila po krijohet në Shqipëri. Pa informacion asnjë shoqëri nuk mund të bëjë progres dhe nuk mund të marrë vendime të shëndetshme për të tashmen dhe të ardhmen e saj.

USHTRIMI NR. 15	Qytetari X ka kërkuar në kërkesën me datë 26.05.2015, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit pajisjen me informacion dhe dokumentacion të të gjithë objektit në pronësi të tij të prishur nga ky Inspektorat. Deri në datë 08.06.2015, qytetari nuk i u dërgua dokumentacioni i kërkuar. Ai u paraqiti edhe një herë para sportelit pas kalimit të afatit 10 ditor dhe aty iu tha se nëpunësit janë shumë të zënë me punë në terren dhe nuk kanë pasur kohë për të shqyrtuar kërkesën e tij.
PYETJE	Sipas mendimit tuaj, ç’duhet të bëjë qytetari? A duhet të vazhdojë të presë? Çfarë duhet të bënte sportelisti, nëpunës publik, a duhet ta orientonte qytetarin X për hapat e mëtejshme? Çfarë detyrimi ka Inspektorati në rastin konkret? Nëse ankohet tek KIMDHP, çfarë hapash mund të ndërmerret kjo zyrë?
OBJEKTIVI	Ndërgjegjësim për rëndësinë e respektimit të së drejtës për informim të individëve dhe rritjes së transparencës së administratës publike.

121 Po aty, neni 13/4.

122 Sipas klasifikimit të nenit 19/4 të Ligjit për Nëpunësin Civil.

123 Po aty, neni 19/2.

USHTRIMI NR. 16	Personi X i kërkon dokumentacion Këshillit të Ministrave, që ka lidhje me miratimin e një vendimi të Këshillit të Ministrave, konkretisht kopje të këtij vendimi, të pabotuar akoma në Fletore Zyrtare. Nëpunësi X, staf i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, i cili ka kompetencën e shqyrtimit të kësaj kërkesë, nuk është i sigurve nëse ky dokumentacion mund të vihet në dispozicion të qytetarit.
PYETJE	Çfarë do të bëni, nëse jeni nëpunësi përgjegjës për dhënien e informacionit? Si do t'i përgjigjeni qytetarit? A duhet që të pyetet Drejtori, të refuzohet dhënia e dokumentacionit, apo të njoftohet kërkuesi që do të studiohet ligji dhe përgjigja të jepet më vonë? Keni një mendim tjetër?
OBJEK-TIVI	Të ndihmohen nëpunësit publikë t'u përgjigjen situatave me efektivitet dhe në zbatim të ligjit. Të ndihmohen për të ndërtuar një kulturë administrative, ku të kuptohet se nevoja e individit për informacion është thelbësore dhe ka prioritet.
USHTRIMI NR. 17	Një OJQ me fokus dhe objekt të veprimtarisë mbrojtjen e mjedisit, iu drejtua Ministrisë së Mjedisit për marrjen e disa dokumenteve administrative që kishin lidhje me ndërtimin e një stacioni nuklear. Ky informacion iu mohua me pretendimin se ishte objekt i kufizimeve, konkretisht të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve si sekreti industrial, siguria kombëtare rreziku i akteve terroriste dhe shëndeti publik. OJQ ngriti pretendimin se, duke iu refuzuar dhënia e dokumentacionit administrativ, i është mohuar e drejta për informim..
PYETJE	Konsideroni rastin në kontekstin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar ose përshkruani se si do të konsiderohej nga autoritetet kompetente situata. Në veçanti, merrni parasysh pyetjet specifike: Për çfarë të drejtash bëhet fjalë në këtë çështje? A konkurrojnë me njëra-tjetrën? Nëse ka kufizim të drejtash, cilin test duhet të kalojë kufizimi?
OBJEK-TIVI	Familjarizim me dispozitat ligjore, procedurat dhe sistemin e ankimit administrativ për nëpunës të administratës publike. Analiza e rastit në kontekstin e Ligjit për të drejtën për Informim..



VII. E drejta e mbrojtjes së të dhënave personale

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, KEDNJ, dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, parashikojnë të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe jetën private. Sigurisht, ky parim konkurren me të drejtën e informimit, dhe raporti i këtyre të drejtave duhet kuptuar dhe të merret parasysh. KDIMDP i mbulon të dyja këto të drejta.

Sipas Kushtetutës, asnjë person nuk mund të detyrohet të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me disa përjashtime. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij dhe kushdo ka të drejtën të kërkojë ndreqjen e të dhënave ose fshirjen e të dhënave të pavërteta, të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin¹²⁴.

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale shtjellon këtë të drejtë, duke përcaktuar rregullat për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të këtyre të dhënave. Gjithashtu, KPA parashikon (në nenin 9) se:

1. Organi publik ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre.

2. Detyrimi për mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin shtrihet edhe mbi nëpunësin publik, gjatë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

124 Shih nenin 35 të Kushtetutës.

<p>Cili është subjekt i të dhënave personale?</p>	<p>» Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “subjekt i të dhënave personale” është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale”¹²⁵.</p>
<p>Çfarë janë të dhënat personale?</p>	<p>» “Të dhëna personale” janë çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social¹²⁶.</p> <p>» Sipas përkufizimit të sipërm të të dhënave personale, element të tyre mund të jenë: emri, mbiemri, atësia, mëmësia, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, arsimi, profesioni, kombësia, shtetësia, gjendja civile, etj. Shembuj të tjerë përfshijnë fotografitë e individëve, regjistrimet e të dhënave në telefonin celular e fiks, informacione për llogaritë bankare apo për policat e tyre të sigurimit, të dhënat në rrjetet tregtare, regjistrimet tek mjeku, në hotel, aeroporte, në aktet gjyqësore e të policisë, etj.</p>
<p>Çfarë janë të dhënat sensitive?</p>	<p>» “Të dhëna sensitive” janë çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale¹²⁷. Të dhënat sensitive marrin trajtim të veçantë sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe sipas instrumentale ndërkombëtare përkatës. Të dhënat sensitive kanë të bëjnë me jetën e prekshme, shqisore, intime, të ngushtë.</p>
<p>Çfarë konsiderohet “pëlqim” i subjektit të të dhënave?</p>	<p>» Të dhënat personale mund të përdorën, në raste të caktuar, me “pëlqim të subjekteve të të dhënave”. Ky pëlqim është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij¹²⁸.</p>

125 Neni 3/6 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

126 Po aty, neni 3/1 .

127 Po aty, neni 3/4.

128 Po aty, neni 3/24.

Çfarë konsiderohet “vendimarrje automatike”?

- » Vendimarrja automatike është një lloj vlerësimi për individët, i kryer krejtësisht në mënyrë automatike pa ndërhyrjen e individit¹²⁹. Vendimarrja automatike ndodh kur kompjuterët programohen për të vlerësuar informacionin për individët që kërkojnë një shërbim apo përfitim të veçantë (p. sh. kredi) përkundrejt kritereve të përcaktuara. Vendimi nëse këta individë mund ta përfitojnë shërbimin apo përfitimin varet krejtësisht nga rezultati i gjeneruar nga ky vlerësim automatik.
- » Çdo person ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve të cilat shkaktojnë efekte ligjore për të ose ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ai, si dhe në rastin kur vendimi është bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave që synojnë të vlerësojnë disa aspekte personale që lidhen me të, veçanërisht efektivitetin në punë, besueshmërinë ose sjelljen¹³⁰.
- » Një person mund të jetë “subjekt” i një vendimi automatik kur merren masa për të mbrojtur interesat e tij të ligjshme, veçanërisht duke përfshirë në vendim këndvështrimet e tij¹³¹.

Ku bazohet mbrojtja e të dhënave personale?

- » Për përdorimin e saktë të të dhënave personale, Ligji përmban përcaktime specifike, si vijojnë:
 - a. duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
 - b. duhet të grumbullohen për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe përpunuar në përputhje me këto qëllime;
 - c. duhet të jenë të mjaftueshme dhe të lidhura me qëllimin e përpunimit, duke mos e tejkaluar këtë qëllim;
 - d. duhet të jenë të sakta dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen;
 - e. duhet ndërmarrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo korigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej;
 - f. duhet të jenë mbajtur në atë formë, që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.¹³²

Cili konsiderohet kontrollues?

- » Kontrollues konsiderohet çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci, apo ndonjë organ tjetër që, vetëm ose së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimi të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale¹³³.

129 Po aty, neni 3/23.

130 Po aty, neni 14/1.

131 Po aty, neni 14/2.

132 Po aty, neni 5

133 Po aty, neni 3/5.

Çfarë detyrimesh ka kontrolluesi?

- » Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij. Në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare.
- » Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale.
- » Kontrolluesi kryen vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me ligjin.
- » Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së subjektit të të dhënave, informon subjektin e të dhënave për kryerjen apo moskryerjen e bllokimit, korrigjimit ose të fshirjes.
- » Kontrolluesi informon marrësin e të dhënave personale për korrigjimin ose fshirjen dhënave personale, të transmetuara para korrigjimit apo fshirjes.¹³⁴

Çfarë të drejtash ka subjekti i të dhënave?

- » Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është mjaft i detajuar në të drejtat që ia jep subjekteve. Shkurt, ato janë:
 - a. *e drejta për akses*, pa pagesë, me kërkesë me shkrim, dhe të marrë informacione të caktuar nga Kontrolluesi¹³⁵;
 - b. *e drejta për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen*¹³⁶, pa pagesë, në rrethana të caktuara¹³⁷;
 - c. *e drejta për të kundërshtuar*. Subjekti i të dhënave ka të drejtë, pa pagesë, t'i kërkojë Kontrolluesit të mos fillojë ose, nëse përpunimi ka filluar, të ndalojë përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë si dhe të informohet përpara përhapjes për herë të parë të të dhënave personale për këtë qëllim¹³⁸.

134 Po aty, neni 18-19.

135 Po aty, neni 12.

136 Në lidhje me fshirjen ose ndryshe "të drejtën për të harruar", GJED, në çështjen Costeja kundër Google, me vendimin nr.131/12, të maj 2014, u shpreh për detyrimin e fshirjes së të dhënave të kërkuesit nga Google, për shkak të respektimit të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale të individit, kur përfshihet dhe detyrimi për fshirjen e të dhënave sipas rrethanave apo kritereve të caktuara.

137 Neni 13 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

138 Po aty, neni 14-15.

Cili është organi monitorues për mbrojtjen e të dhënave personale?

- » Komisioneri për Informimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) është, siç shihet nga emërtimi, autoriteti përgjegjës që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale si dhe, siç u shpjegua në kapitullin e mëparshëm, të drejtën për informimin.
- » KDIMDP është institucion i pavarur dhe kontrollon përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale nga
 - a. kontrollues të vendosur në Republikën e Shqipërisë;
 - b. misionet diplomatike ose zyrat konsullore të shtetit shqiptar; dhe
 - c. kontrollues, të cilët nuk janë të vendosur në Republikën e Shqipërisë, por që e ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet përdorimit të çdo mjeti, që ndodhet në Republikën e Shqipërisë.
- » Ndër kompetencat kryesore të KDIMDP për mbrojtjen e të dhënave personale janë dhënia e autorizimit në raste të veçanta, për përdorimin e të dhënave personale, sensitive, për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, kontrollimi i përpunimit të të dhënave, zgjidhja e ankimeve të çdo personi për përpunimet e të dhënave personale¹³⁹.
- » KDIMDP ka të drejtë të kryejë hetime, të urdhërojë bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose të pezullojë përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale, të japë udhëzime përpara se përpunimet të kryhen dhe të sigurojë publikimin e tyre¹⁴⁰.

Si vihet në lëvizje KDIMDP?

- » Çdo person i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme në lidhje me të dhënat personale mund të bëjë ankim tek Komisioneri, ta njoftojë atë ose të kërkojë ndërhyrjen e tij¹⁴¹. KDIMDP mund të ndër marrë nisma edhe me iniciativën e vet nëpërmjet *shqyrtimit të njoftimeve* që janë të detyruar t'i dërgojnë Kontrolluesit për të dhënat personale që ata përpunojnë, nëpërmjet kontrolleve të programuara nga zyra e KDIMDP, hetimit administrativ dhe inspektimit.

Ndaj kujt mund të bëhet ankimi?

- » Ankimi mund të bëhet kundër marrësit të të dhënave, Kontrolluesit, përpunuesit dhe transferuesit.

139 Po aty, neni 31.

140 Po aty, neni 30.

141 Po aty, neni 16.

A ka të drejtë të kompensohet subjekti i të dhënave personale i dëmtuar?

- » Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kompensim "Kontrolluesit" për dëmin e shkaktuar¹⁴².
- » Kompensimi kërkohet me një kërkesë drejtuar gjykatës sipas nenëve të K.Pr.Civile, pasi kërkuesi ti jetë drejtuar Komisionerit dhe ky i fundit të ketë dalë me një vendim lidhur me shkeljen e të drejtave, në përpunimin e të dhënave personale të individit.



Duhet theksuar se nëpunësi civil që harton, përpunon, lëshon, vë në dispozicion dokumente të ndryshme zyrtare, duhet të ketë kujdes me respektimin e të dhënave të karakterit personal. Në të njëjtën kohë, detyrimi për respektimin e të dhënave me karakter personal, nuk duhet t'i shërbejë nëpunësit civil si justifikim sistematik për refuzimin e komunikimit të të dhënave. Në rast dyshimi, këshilla e Zyrës së KDIMDP duhet kërkuar.

Fushat ku duhet bërë kujdes me trajtimin e të dhënave personale të individëve janë të shumta (p.sh. gjendja civile, pronat, arsimi, shëndeti, tatimet dhe taksat, policia dhe gjyqësori, etj), po ashtu dhe detyrimet specifike për nëpunësit dhe administratën publike. KDIMDP ka prezantuar në *website*-in zyrtar gamën e gjerë të legjislacionit në këtë drejtim¹⁴³.

USHTRIMI NR. 18

X është pronar dhe qiradhënës i një lokali me qera. Atij i ofrohet për marrje me qira të ambientit, personi Y, subjekt tregtar i regjistruar pranë QKR. Pronari i drejtohet Drejtorisë së Tatim - Taksave dhe i kërkon që t'i japë informacion për detyrimet tatimore dhe detyrime të tjera në lidhje me qiramarrësin e lokalit me qira, pasi dëshiron të jetë i sigurt për qëndrueshmërinë financiare të qiramarrësit, përpara se të nënshkruante qiranë.

PYETJE

A duhet dhënë ky informacion? A mbrohet nga ligji për të dhënat personale informacioni i kërkuar. Ju, si do të vepronit? Po nëse kërkuesi i këtij informacioni do të ishte avokati i angazhuar rregullisht me prokurë nga pronari X, si do të vepronit? Ju si nëpunësi përgjegjës, në rast dyshimi, a do t'i drejtoheshit KDIMDP, me qëllim që ky i fundit të shprehet në lidhje me natyrën e këtij informacioni?

OBJEKTIVI

Të identifikohet informacioni që duhet dhënë, deri në çfarë niveli dhe për çfarë arsyesh dhe kufizimet në lidhje me të dhënat personale. Thellim në metodologjinë e identifikimit të informacionit që duhet dhënë dhe atij që nuk duhet dhënë, sipas dy ligjeve të kësaj fushe, atij për informim dhe të dhënat personale.

¹⁴² Po aty, neni 17.

¹⁴³ Për më tepër ju lutem referojuni faqes zyrtare të KDIMDP; <http://idp.al/index.php/sq/legjislacion-te-dhena/165-ligje>, vizituar me datë 24.10.2015.

USHTRIMI NR. 19	<p>Pranë Ministrisë së Transporteve është ndjekur dhe realizuar procedura e shpronësimit publik dhe e kompensimit për efekt shpronësi për një pjesë trualli, pronësi e babait të personit Y, për arsye të ndërtimit të një objekti për interes publik. Ky i fundit, pra Y, duke qenë se i ati nuk i tregon lidhur me masën e shpronësimit të përfituar në vlerë monetare, i drejtohet Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun në Ministri, dhe i kërkon informacion me gojë mbi shumën e përfituar nga i ati për shkak të shpronësimit. Ndërkohë, lista e pronave që janë objekt shpronësi, sipërfaqja dhe çmimi për shpronësimet publike sipas vlerës së metrit katror në varësi të zonave të shpronësimit janë publikuar on line në faqen e internetit të Ministrisë së Transporteve. Ju nuk jeni i sigurtë, nëse ky informacion është i një natyre personale, i cili mbrohet nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p>
OBJEKTIVI	<p>Përballje me dilema të ndryshme me impakt ligjor. Njohje me detyrimet për publikim informacioni, për qëllime publike, për aq sa është e nevojshme dhe kriteret që duhen respektuar në këtë drejtim. Njohje me procedurat ligjore të mbrojtjes së të dhënave personale dhe ndërgjegjësim për kujdesin e duhur në shpërhapje të një informacioni të natyrës private. Familjarizim me procedurat që duhen ndjekur në rast të mosdijenisë së trajtimit të kërkesës së qytetarit.</p>
USHTRIMI NR. 20	<p>Në vitin 2008 personi X paraqitet për mjekim pranë Spitalit Shtetëror. Gjatë vizitës paraprake mjekja e pyet se kur kishte kryer marrëdhënie seksuale për herë të parë dhe me sa partnerë në jetën e saj. Ajo i përgjigjet se: "... kishte kryer marrëdhënie seksuale që në moshën 15 vjeç dhe kishte kryer marrëdhënie seksuale me meshkuj të ndryshëm". Kalon 7 vjet dhe shtetësja X rikthehet tashmë për të lindur në të njëjtin spital. Spitali i përditëson të dhënat mjekësore të saj mbi të njëjtën dosje të hapur që nga viti 2008. Gjatë vizitave të kryera në shtatzëni ajo i kërkon spitalit korigjimin e thënies së saj me argumentin se mund t'i dëmtojë reputacionin dhe t'i bëjë jetën e përditshme familjare, tashmë të stabilizuar, më problematike, duke pasur parasysh se këto të dhëna mund të përhapshin nga pakujdesia, ose të transferoheshin edhe tek autoritete të tjera për qëllime shkencore laboratorike. Spitali e refuzoi kërkesën e saj për fshirjen e të dhënave.</p>
PYETJE	<p>A jemi para mbrojtjes së të dhënave personale? Refuzimi i spitalit a dhunon të drejtën e personit X për t'i respektuar të drejtën për jetë private? Si qëndron e drejta e personit X në raport me mbledhjen e informacionit për qëllime të interesit publik, si kërkimet shkencore për kancerin e mitrës tek gratë? A ishte e justifikuar dhe e nevojshme, ruajtja e thënies së saj pas disa vitesh? Nëse ka kufizim të drejtash, cilin test duhet të kalojë kufizimi?</p>
OBJEKTIVI	<p>Familjarizim me detyrimet ligjore të autoriteteve publike dhe të drejtat e individëve për mbrojtjen e të dhënave personale. Analiza e rastit në kontekstin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p>

USHTRIMI NR. 21	<p>Ministria e Arsimit dhe e Sportit ka nisur procesin e shpërndarjes dhe plotësimit nga ana e prindërve të pyetësorit të gjendjes shëndetësore të nxënësit. Nëpërmjet këtij pyetësi kontrolluesi (Ministria) synon njohjen e gjendjes shëndetësore të nxënësve, me qëllim që të sigurohet mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të tyre. Rezulton se kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e mbajtjes së këtyre të dhënave të përpunuara në kuadër të administrimit të pyetësorëve. Gjithashtu rezulton se subjekti i të dhënave, nuk është informuar (në përmbajtjen.</p>
PYETJE	<p>A duhet patjetër afat konkret? Po pëlqimi i subjektit të të dhënave duhet marrë? Si do ta konsideronte KDIMDP këtë rast? Nëse e konsideron shkelje të ligjit, çfarë veprimesh ndërmerr?</p>
OBJEKTIVI	<p>Familjarizim me dispozitat ligjore, procedurat dhe sistemin e ankimit administrativ për nëpunës të administratës publike. Analiza e rastit në kontekstin e Ligjit për të dhënat personale.</p>
USHTRIMI NR. 22	<p>Subjekti X, pretendon për përpunim të paligjshëm të të dhënave personale nga kontrolluesi Ministria e Punëve të Brendshme. Ai pretendon se i janë përpunuar të dhëna personale,(emri, mbiemri, datat e lëvizjeve hyrje-dalje, nga territori i Republikës së Shqipërisë), nga një bazë të dhënash, Qendra e Përpunimit të të Dhënave, (Sistemi TIMS), e cila administrohet nga kontrolluesi, Ministria e Punëve të Brendshme. Mbledhja, përpunimi, trajtimi i informacioneve nga kjo Qendër bëhet me qëllim ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e krimeve. Sipas subjektit X, këto të dhëna i janë vënë në dispozicion Universitetit Y, me qëllim verifikimin e disiplinës në punë.</p>
PYETJE	<p>A ka të drejtë subjekti X? Si do ta konsideronte KDIMDP këtë rast? Nëse e konsideron shkelje të ligjit, çfarë veprimesh ndërmerr?</p>
OBJEKTIVI	<p>Njohja me dispozitat ligjore, procedurat dhe sistemin e ankimit administrativ për nëpunës të administratës publike. Analiza e rastit në kontekstin e Ligjit për të dhënat personale.</p>



VIII. Të drejta “në veprim” të lidhura me veprimtarinë e administratës publike

Në tre kapitujt e mëparshëm, kemi trajtuar tri prej të drejtave kryesore të njeriut, që mund të prekin punën e përditshme të administratës publike: e drejta të mos u diskriminuar, e drejta e informimit si dhe e drejta për t’iu mbrojtur të dhënat personale. Në këtë kapitull, do të trajtojmë disa nga të drejtat procedurale për një proces të rregullt administrativ”.

Sipas përkufizimit klasik për administratën publike, objektivi themelor i administratës është realizimi i veprimtarive të saj, me sa më pak shpenzime materiale dhe njerëzore. Për rrjedhojë, *eficienca* e administratës në përdorimin e burimeve publike qëndron në themel të parimeve të funksionimit të saj, por ky parim administrativ duhet balancuar me të drejtat e individit dhe sidomos garancitë procedurale që duhet t’i respektohen atij. Këto garanci janë mire përcaktuar në instrumentet e të drejtave të njeriut, që kemi shpjeguar më sipër.

8.1 TË DREJTA TË KARAKTERIT PROCEDURAL NË KËNDVËSHTRIM TË PROCESIT ADMINISTRATIV

Një ndikim të madh në veprimtarinë e administratës publike kanë standardet e vendosura në termin ‘proces i rregullt’ ligjor. Këto standarde duhet të gjejnë zbatim edhe

në procedimet administrative, në mënyrë që ato të përfundojnë brenda afateve kohore sa më të përshtatshme, të jenë të arsyetuara, të paanshme dhe të drejta.

Paanësia, arsyetimi dhe arsyeshmëria e kohëzgjatjes së vendimmarrjes janë vlera administrative, përveçse standarde kushtetuese. Sigurisht që standardet e kërkuara për procesin e rregullt ligjor mund të konkurrojnë me interesat e administratës publike për eficiencë në veprimet e saj. Ky kryqëzim i interesave e ka një mbrojtës procedural, që është shqyrtimi gjyqësor i veprimeve administrative të organeve të administratës, të cilët në emër të eficiencës mund të anashkalojnë të drejtën kushtetuese të individëve për proces të rregullt ligjor.

Neni 42 i Kushtetutës, po aq sa vendos standarde kushtetuese për gjykatat, vendos standarde dhe për organet e administratës publike. Lidhur me këtë standard, GJK ka theksuar se:

“...Sipas nenit 42/2 të Kushtetutës, kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Gjykata Kushtetuese vëren se kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore”.

Konkretisht edhe në KPA, e drejta për një proces të rregullt është përcaktuar shprehimisht (neni /2), ku parashikohet se: *“Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor”*.

Kjo e drejtë është reflektuar në vijimësi në shumë dispozita të KPA, si: e drejta për t’u dëgjuar, e drejta për të pasur një vendim të arsyetuar, e drejta për informim dhe akses në dosje lidhen drejtpërdrejt me elementet thelbësore të procesit të rregullt ligjor, si një e drejtë kushtetuese e individit.

Jo të gjithë nëpunësit e administratës publike do të përfshihen në procedimet administrative, por duhet të dini parametrat themelore, sipas KPA-së dhe instrumentet për të drejtat e njeriut e përmendura më sipër.

Si fillon procedura administrative?

- » me kryerjen e çdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e procedurës së filluar kryesisht;
- » me paraqitjen e kërkesës përpara organit publik, në rastin e procedurës së filluar me kërkesë .

8.1.1 E drejta për akses (aktiv dhe pasiv)

E drejta e aksesit është e drejta për t’iu drejtuar organit nga çdo subjekt, palë në procedurën administrative. Kjo palë mund të jetë:

- a. personi me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;
- b. personi ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo

synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative;

- c. personi me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative;
- d. mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.

Po në këtë të drejtë përfshihet dhe *e drejta e aksesit pasiv* të individit, që do të thotë se organi publik që zhvillon procedurën administrative, përfshin si palë në procedurë çdo person tjetër, të ndryshëm nga subjekti që ka filluar procedurën ose ndaj të cilit ka filluar procedura, i cili mund të identifikohet si person që ka interes në procedurën administrative¹⁴⁴.

8.1.2 E drejta për përfaqësues

Çdo person që ka filluar me kërkesën e tij një procedurë administrative para organeve publike ose që bëhet pjesë e një procedimi administrativ të filluar nga organi administrativ, mund t’i kryejë të gjitha veprimet procedurale nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur prej tij ose kryesisht¹⁴⁵. Ky përfaqësues mund të jetë përfaqësues ligjor ose ndonjë person tjetër i caktuar nga personi ndaj të cilit orientohet procedura administrative.

8.1.3 E drejta për t’u informuar/njoftuar

E drejta për t’u njoftuar duhet të respektohet nga organet e administratës publike kur procedura administrative fillohet nga organi publik¹⁴⁶. Ky i fundit njofton të gjitha palët në

144 Neni 33 i KPA.

145 Neni 35- 38 i KPA.

146 Neni 42 i KPA.

proces për fillimin e veprimeve, me shkrim apo në një takim me palën dhe përmban këto të dhëna:

- a. adresën postare dhe/ose elektronike të organit publik, që zhvillon procedurën dhe nëpunësin përgjegjës për të;
- b. informacion lidhur me kompetencën e organit publik, qëllimin e procedurës dhe çështjet për të cilat do të merren vendime;
- c. palët në procedurën administrative;
- d. informacion për të drejtën e njohjes së

dosjes dhe zyrën ose vendin ku mund të njihet dosja;

- e. informacion për të drejtën e palës për të dëgjuar, mënyrat dhe afatin e ushtrimit të kësaj të drejte;
- f. datën e fillimit të procedurës dhe afatin brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi përfundimtar, në rast se zbatohet një afat i tillë.

Kur njoftimi bëhet me takim, organi publik mban procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer¹⁴⁷.



Vini re: Palët kanë të drejtë në çdo rast të njihen me dokumentet mbi çështjen e filluar dhe të marrin kopje të tyre, pas njoftimit për fillimin e procedurës administrative.

8.1.4 E drejta për t'u dëgjuar

E drejta e njoftimit gëzohet nga individit edhe në fazën para dhënies së vendimit përfundimtar, që në këtë fazë transformohet në të drejtë për t'u dëgjuar¹⁴⁸. E drejta për t'u dëgjuar në procedimet administrative mund të konsiderohet ndoshta parimi më i rëndësishëm i lidhur ngushtë me konceptin e procesit të drejtë.

E drejta për t'u dëgjuar lidhet ngushtësisht me të drejtën për t'u mbrojtur, me të drejtën për të zhvilluar një proces kontradiktor gjykimi, me qëllim që secila palë të ketë mundësinë të paraqes përpara organit kompetent të gjitha argumentat e nevojshme, apo mjetet juridike që i vlejnjë një zgjidhje sa më të drejtë të çështjes. Prandaj dëgjimi i palëve në një

proces administrativ mbetet një detyrim ligjor dhe kushtetues.

Mënyrën se si palët do ta realizojnë ushtrimin e kësaj të drejte sigurisht që mund ta zgjedhin vet, por organi administrativ nisur nga rrethanat e çështjes mund të vendos rast pas rasti që ato të shprehen me shkrim apo me gojë. E rëndësishme është që kjo e drejtë të mos u mohohet palëve, pavarësisht se forma e ushtrimit të saj mund të ndryshojë sipas rrethanave konkrete.

Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes¹⁴⁹.

Kërkimi i mendimit të palëve në proces është

147 Neni 42 i KPA.

148 Neni 87/3 i KPA.

149 Neni 47 i KPA.

një kategori e ndryshme nga komunikimi me palët. Ndërsa komunikimi është një mekanizëm i cili gjen zbatim në fillimin e procedimit kur palët e interesuara informohen në lidhje me organin që ka filluar procedimin, datën e fillimit të procedimit dhe qëllimin e procedimit, kërkimi i mendimit të palëve, përdoret pasi procedimi ka filluar.

Kjo e drejtë ushtrohet në çdo formë të përshtatshme dhe brenda afatit të caktuar nga organi publik. Palët për ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar mund të përdorin mjete si: komente dhe vlerësim të provave të administruara, komente për rezultatet e hetimit dhe për perspektivën dhe rezultatin e mundshëm të procedurës konkrete¹⁵⁰.

Organi administrativ që zhvillon procedurën administrative, duhet të ketë parasysh se vetëm në disa raste përjashtimore individit përjashtohet nga kjo e drejtë.¹⁵¹

8.1.5 E drejta për t'u mbrojtur

E drejta për t'u mbrojtur është pjesë e rëndësishme e një procesi të rregullt ligjor. Sipas nenit 31 të Kushtetutës, *“kushdo ka të drejtë... ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij (...)*”. Edhe pse në Kushtetutë kjo e drejtë është vendosur në kontekstin penal, ajo është po aq e rëndësishme edhe në çështjet administrative.

E drejta e personit për të patur mundësitë për përgatitjen e mbrojtjes, nënkupton që duhet të bëhet i mundur organizimi i mbrojtjes në mënyrën e duhur që t'i parashtrojë organit vendimmarrës argumentet themelore në mbrojtje të vet pa kufizime. Realizimi i ushtrimit të së drejtës për një mbrojtje efektive lidhet jo vetëm me njohjen paraprake të fak-

150 Neni 88 i KPA.

teve e provave, por dhe me dhënien e kohës së mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.

E drejta për t'u mbrojtur është e ndërvarur nga disa elementë të tjerë, po aq thelbësor, që ndiqen gjatë një procesi administrativ, si:

- » e drejta për t'u informuar brenda një afati sa më të shkurtër, në mënyrë të hollësishme;
- » e drejta për të pasur kohën dhe mundësitë e domosdoshme për përgatitjen e mbrojtjes;
- » e drejta për t'u mbrojtur vetë, ose me ndihmën e një mbrojtësi;
- » e drejta për të marrë në pyetje, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët, ekspertët, etj.

E drejta për t'u mbrojtur efektive është më tepër se qasja formale për të plotësuar këtë detyrim ligjor. Ajo është tërësia e procedurave që e bëjnë individin të ndjehet i mbrojtur efektivisht përballë veprimeve të administratës publike.

8.1.6 Arsyetimi i vendimeve

Organi publik, në çdo rast, është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura.¹⁵²

Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë – jo vetëm vendimet e gjykatave, por edhe vendimet administrative.

151 Neni 89 i KPA parashikon se: “Individi përjashtohet nga e drejta për t'u dëgjuar, vetëm kur: a) marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet për shkak të vonesës interesit publik; b) palët kanë paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative; c) gjatë zhvillimit të procedurës administrative rezultojnë qartë se vendimi do të jetë tërësisht në favor të palës; ç) në një procedurë administrative që bazohet në një procedurë konkurruese publike; ose kurd) është parashikuar shprehimisht me ligj”.

152 Neni 48 i KPA.

Vendimi mund të kontrollohet nga organ ankimor administrativ, ose gjykatë; dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin tregohen me qartësi faktet dhe ligji i zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në marrjen e vendimit. Organi duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve. Vendimi në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje.

Në tërësinë e tyre, aktet, siç janë ato administrative, duhen konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë.

Argumentimi duhet të jetë gjithashtu i mjaftueshëm për të mbështetur pjesën urdhëruese të aktit administrativ. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin logjik.

Vendimet administrative në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit administrativ¹⁵³. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban organi administrativ lidhur me çështjen në gjykim.

153 Neni 90/1 i KPA parashikon se: "Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative".

KU QËNDRON RËNDËSIA E ARSYETIMIT?

- » Dhënia e arsyeve informon personat e interesuar për shkaqet që qëndrojnë pas vendimeve të administratës, të cilat ndikojnë negativisht tek të drejtat dhe liritë e tyre.
- » Arsyetimi që i bëhet një akti lehtëson kontrollin hierarkik administrativ dhe gjyqësor dhe i jep kuptim të drejtës për ankim.
- » Ndihmon në zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, d.m.th., sa më i arsyetuar një akt aq më shumë kundraargumente mund të jepen nga individit që pretendon paligjshmërinë e tij.
- » Disiplinon administratën me sjelljen e duhur administrative

Arsyetimi i saktë i vendimit është një mënyrë e sigurt që gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve. Ky efekt do të jetë akoma më i madh nëse palët do ta përjetojnë këtë vendim si pasojë normale e një procesi të rregullt, në të gjithë komponentët e tij. Midis arsyetimit dhe legjitimitetit të vendimit ekziston një lidhje e ngushtë, dhe prandaj, nëse arsyetimi mungon ose ka defekte të tilla që tejkalojnë kufijtë e logjikes juridike, kjo passjell cenim të vetë legjitimitetit të vendimit administrativ.

Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, sepse arsyetimi është pikërisht përgjigja e dhënë argumenteve të ngritura nga palët. Prandaj dhe organi vendimmarrës duhet të zbatojë këtë standard kushtetues dhe administrativ të procesit.

8.1.7 E drejta për ankim

Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit, ka rëndësi që ankimi të realizohet

si në aspektin formal/procedural ashtu edhe substancial.¹⁵⁴

E drejta e ankimit presupozon të drejtën e qytetarit për t'iu drejtuar një organi që ka nxjerrë aktin ose organit publik epror¹⁵⁵, pranimin e ankimit, ekzistencën e organit për shqyrtimin e ankimit, afatet optimale të shqyrtimit, shqyrtimin objektiv, kontrollin përfundimtar ndaj ankimit dhe një garanci për rehabilitim të mundshëm si pasojë e shqyrtimit dhe pranimit të ankimit.

Ankimi administrativ ndaj një veprimi administrativ është mjete ligjor që individi ka të drejtë ta ushtrojë dhe të shfrytëzojë. Megjithatë sjellja dhe qëndrimet e nëpunësit nuk duhet të jenë të tilla që me arrogancë, t'i sugjerojë individit, rrugën e ankimit në organe të tjera administrative apo gjykatë, kur ndërkohë çështja mund të zgjidhet nga ai me autoritetin që ligji i ka dhënë.

8.1.8 E drejta për kohëzgjatje të arsyeshme të procesit

Është dukuri shumë e njohur, se procedimet shqiptare, edhe gjyqësore, edhe administrative, shpesh zgjaten për një kohë jashtëzakonisht të gjatë.

Kohëzgjatja e arsyeshme e procesit është standard i kërkuar i nenit 6 të KEDNJ si dhe nenit 42 të Kushtetutës. Në qoftë se afati i arsyeshëm nuk respektohet, individi mund të ngrejë pretendime për shkelje të së drejtës së tij për proces të rregullt ligjor.

KPA ka të përcaktuar standardin e afatit të arsyeshëm si afat i përfundimit të procedurës administrative. Kështu, nëse ligji ose aktet

nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit¹⁵⁶. Për t'ju përmbajtur afateve sa më të arsyeshme të procesit, duhen patur parasysh kriteret si, kompleksiteti i çështjes, sjellja e individit, dhe sjellja e organeve administrative¹⁵⁷.

Afati ligjor dhe afati i arsyeshëm janë standarde të ndryshme. Brenda afatit ligjor për zgjidhjen e çështjes, kur ky është i përcaktuar me ligje të veçanta, organi administrativ ka detyrimin e zgjidhjes së çështjes brenda afatit sa më të arsyeshëm.

Pavarësisht nga detyrimi i administratës publike për njohje dhe zbatim rigoroz të procedurave administrative dhe elementëve të sipërpërmendur, mund të themi se në administratat publike bashkëkohore po vihen në zbatim dhe qasje joformaliste në lidhje me plotësimin e kërkesave të qytetarëve. Kështu p.sh. Holanda, e ndjekur nga disa vende të tjera, po zbaton një projekt-pilot, i titulluar "Qasja proaktive jo-formale në shërbimet publike", (The Informal Pro-Active Approach Model for government services), i cili aplikon metodën e zgjidhjes së numrit të lartë të ankesave administrative duke i shmangur burokracitë.

154 Nenet 130 dhe 131 i KPA.

155 Neni 134 i KPA.

156 Nenet 53 – 57 i KPA.

157 Shih vendimet nr.13, datë 14.04.2010 dhe nr.14, datë 15.04.2010 të GJK.

USHTRIMI NR. 23	<p>Një qytetar, pensionist, banor i një shtëpie private ankohet lidhur me vendosjen e kazanëve të plehrave që i ka shumë afër oborrit të shtëpisë së tij. Ai ka paraqitur ankesë pranë Bashkisë, pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Agjencisë së Ruajtjes së Mjedisit. Gjtithashtu është përpjekur të marrë kontakte personale me këto institucione duke u paraqitur në sportelet administrative. Nga këto institucione konsiderohet si një “person i bezdisur”, pasi vazhdon të këmbëngulë për lëvizjen e plehrave nga vendi i paracaktuar nga Bashkia, edhe pse ajo rrugicë nuk ka shumë hapësirë për vende të tjera të vendosjes së kazanëve.</p> <p>Të treja institucionet, duke zbatuar rregullat procedurale i kanë kthyer përgjigje se ankesa e tij do të merret në konsideratë, por ai ndjehet i pakënaqur, pasi akoma asgjë nuk po bëhet për ndryshimin e vendit të vendosjes së kazanëve të plehrave. Ndërkohë ai ndjehet i zhgënjyer nga organet administrative, që nuk e marrin seriozisht shqetësimin e tij dhe sipas tij ankesa i ka mbetur vetëm në një copë letër.</p>
PYETJE	<p>Si mund të mbahet një qasje më pak formale në këtë çështje? Si mund të trajtohet qytetari ndryshe nga qasja formale, e komunikimit zyrtar, nëpërmjet dhënies së përgjigjes me shkrim për ankesën e tij?</p>
OBJEKTIVI	<p>Ndërgjegjësim për të kuptuar se me trajtimin e çështjes vetëm nga pikëpamja procedurale formale, qytetari ndjehet i pakënaqur. Si qenie njerëzore ata duan të flasin për shqetësimet e tyre dhe për më tepër të dëgjohen nga nëpunësit publikë dhe të ndjehen të përfillur. Prandaj dhe nëpunësit publikë duhet të nërthurrin procedurën formale me procesin e dëgjimit të qytetarëve, me qëllim që ky i fundit të perceptojë se vendimmarrjet janë të drejta. Ndërgjegjësimi se komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët sjell predispozitë prej tyre për të besuar në llojin e vendimmarrjes edhe pse mund të mos jetë e favorshme për ta, dhe për pasojë, kjo qasje zvogëlon rastet e ankimeve të mëtejshme dhe ngarkesën e punës së administratës publike.</p>

USHTRIMI NR. 24	Pranë Këshillit Bashkiak po diskutohej çështja e aplikimit dhe e mbledhjes së taksave lokale. Shoqata e familjeve në nevojë kërkoi të ishte pjesë e kësaj mbledhjeje. Nga Bashkia nuk u lejuan përfaqësuesit e saj, me argumentin se mendimet e tyre mund t'i paraqisnin me shkrim. Ata kundërshtuan duke thënë se do të dëshironin të dëgjoheshin dhe jo të dërgonin mendimet me shkrim.
PYETJE	A jemi para ndonjë shkeljeje të elementëve procedurale të procesit administrativ? Si do të silleshit ju si nëpunës civil?
OBJEKTIVI	Njohje dhe familjarizim me procedurat administrative tepër të zakonshme për administratën publike në raport me individët. Ndërgjegjësim për trajtimin e çdo individit me prioritet, pasi çdo shkelje procedurale, mund të passjellë shkelje të të drejtave themelore të njeriut.
USHTRIMI NR. 25	Një kryefamiljare, e ve me dy femijë, në vështirësi ekonomike, i ishte ndërprerë pensioni familjar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, mbi 6 muaj, duke mos e orientuar dhe shpjeguar arsyet e ndërprerjes. Ajo pretendon se me këto të ardhura jetonte ajo dhe fëmijët e saj; prandaj dhe vonesa i kishte shkaktuar probleme me mbijetesën, pamundësi për ushqim dhe veshje.
PYETJE	A jemi para ndonjë shkeljeje të elementëve procedurale të procesit administrativ? Po të ndonjë të drejte themelore substanciale? Si do të silleshit ju si nëpunës civil?
OBJEK-TIVI	Njohje dhe familjarizim me procedurat administrative, tepër të zakonshme për administratën publike në raport me individët. Ndërgjegjësim për trajtimin e çdo individit me prioritet, pasi vonesat dhe zvarritjet administrative mund të passjellin shkelje të të drejtave themelore të njeriut.
USHTRIMI NR. 26	Një grup qytetarësh ankohen pranë Agjencisë së Ruajtjes së Mjedisit për ndotje dhe zhurma, që u shkaktoheshin për shkak të një subjekti që ushtronte aktivitet të prodhimit dhe shitjes së bukës, në katin e parë të pallatit ku ata banonin. Agjencia ndërmori hapa për të kryer ekspertizën përkatëse për të matur nivelin e ndotjes. Një përfaqësues i banorëve me profesion inxhinier mjedisor kërkoi të ishte asistonte në këtë proces. Kjo kërkesë iu mohua nga Agjencia, me argumentin se nuk ishte e nevojshme.
PYETJE	A jemi para ndonjë shkeljeje të elementëve procedurale të procesit administrativ? Si do të silleshit ju si nëpunës civil?
OBJEK-TIVI	Njohje dhe familjarizim me procedurat administrative, kujdes i duhur ndaj kërkesave të qytetarëve dhe trajtim sipas legjislacionit

USHTRIMI NR. 27	Një qytetar kishte plotësuar formularin e vetdeklarimit nga ALUIZNI për legalizimin e objektit. Edhe pse kishte vite që i drejtohej institucionit për ecurinë e procedurës së legalizimit, ky institucion nuk i kthente asnjë përgjigje. Ai ankohej se moslegalizimi i objektit dhe vonesat i kishin sjellë probleme me gëzimin e objektit në mënyrë të plotë.
PYETJE	A jemi para ndonjë shkeljeje të elementëve procedurale të procesit administrativ? Si do të silleshit ju si nëpunës civil ?
OBJEKTIVI	Njohje dhe familjarizim me procedurat administrative, tepër të zakonshme për administratën publike në raport me individët. Ndërgjegjësim për trajtimin e çdo individi me prioritet, pasi çdo shkelje procedurale, passjell shkelje të të drejtave themelore të njeriut.
USHTRIMI NR. 28	<p>Shtetësja X ka paraqitur një ankesë, sa i përket kundërshtimit të rezultatis të shpallur për të si pjesëmarrëse kandidate, në provimin e shtetit të organizuar për profesionin e farmacistit, dhe rivlerësimit të tezës së provimit nga Agjencia Kombëtare e Provimit. Ajo pretendon se mbas mbarimit të provimit dhe nxjerrjes rezultateve, kishte arritur të merrte vetëm 46 pikë nga maksimumi prej 100 pikësh, duke u cilësuar si një kandidate e pasuksesshme.</p> <p>Nga verifikimi që ka bërë, për aq sa pati mundësi, ka konstatuar që, për disa nga përgjigjet e dhëna në provim edhe pse të sakta i është konfirmuar zero pikë. Ky fakt ka ndikuar në vlerësimin e saj përfundimtar në provim. Mbi këto të dhëna, ajo ngre dyshimin se ndoshta për shkak të një gabimi njerëzor në korrigjim, fleta e saj e provimit duhet korrigjuar..</p>
PYETJE	A duhet shqyrtuar ankimi i shtetases nga AKP? A ka dëm të shkaktuar ndaj saj dhe për çfarë? Cilat janë të drejtat substanciale edhe procedurale të diskutueshme, në rastin konkret?
OBJEKTIVI	Nëpunësit civilë të aftësohen me njohuri mbi të drejtat e natyrës procedurale administrative. Të kuptojnë problematikat që mund të shoqërojnë individin për shkak të një trajtimi jo me kujdesin e duhur administrativ të situatës përkatëse. Të kuptojnë se mosmarrja në konsideratë e një ankimi në dukje jo dhe aq i rëndësishëm, mund të sjellë dhunim të të drejtave themelore të njeriut dhe përballje të organit përkatës me konflikte gjyqësore me individin.

8.2. DISA TË DREJTA TË PËRZGJEDHURA TË KARAKTERIT SUBSTANCIAL

Siç e keni parë në kapitujt II dhe III, fusha e të drejtave dhe lirive të njeriut, sipas Kushtetutës shqiptare dhe instrumentave të shumta ndërkombëtare, është mjaft e gjerë. Deri tani, jemi fokusuar mbi disa të drejta, ku veprimtaria e administratës publike në përgjithësi preket më shumë.

Kemi theksuar, që të gjitha të drejta të njeriut formojnë një unitet dhe janë të pandarë, por më poshtë do të diskutojmë shkurtimisht disa të drejta substantive që janë qendrore në jetën e shoqërisë shqiptare, si dhe, pse jo, në punën e disa sektorëve të administratës.

8.2.1. E drejta e pronës

E drejta e pronës përbën një nga të drejtat themelore të njeriut. Ajo garantohet nga nenet 41 dhe 42 e Kushtetutës. Në nenin 41 përcaktohet se:

1. *E drejta e pronës private është e garantuar.*
2. *Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.*
3. *Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.*
4. *Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundërt një shpërblimi të drejtë.*
5. *Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.*

Kjo e drejtë është trajtuar gjerësisht dhe nga GJK, e cila ka theksuar, ndër të tjera, se:

“Kushtetuta pranon në mënyrë pohuese se e drejta e pronësisë mund të kufizohet. (...) E drejta e pronësisë është e garantuar, por jo e paprekshme. (...) Kjo e drejtë është e garantuar, nëse në rast të kufizimit të pronësisë private (shpronësimi apo kufizime që barazohen me shpronësimin), shteti merr përsipër që të respektojë kufizimin në përmbushje të një interesi publik, kundërt një shpërblimi të drejtë dhe në respektim të së drejtës së ankimit të individit të cenuar për masën e shpërblimit”¹⁵⁸

Sigurisht, në 25 vitet e fundit, interpretimi dhe zbatimi i këtij parimi dhe këtyre kufizimeve janë bërë objekt i gjyqeve, mosmarrëveshjeve dhe diskutimeve pa fund.

Edhe Protokollin Shtesë Nr.1 i KEDNJ trajton këtë çështje. Sipas nenit 1 të tij, si elementë përbërës të së drejtës së pronësisë janë, veç të tjerash, interesa materiale dhe jomateriale, si patenta, aksione, e drejta për pension, e drejta për të dhënë me qira, e drejta për të ushtruar një profesion, e drejta për aktivitet ekonomik, etj¹⁵⁹.

Ky nen përmban tre rregulla mbi bazë të të cilave bëhet kontrolli, nëse kemi të bëjmë me cenim të së drejtës së pronës. Kështu:

- rregulli i parë lidhet me *gëzimin e lirë* të pronës në qetësi nga kushdo pronar i saj;
- » rregulli i dytë lidhet me *kufizimin sipas kushteve të sakta* të së drejtës së pronësisë;
- » rregulli i tretë u njeh shteteve të drejtën *për të kontrolluar përdorimin e pronës* në përputhje me interesin e përgjithshëm,

¹⁵⁸ Vendimi nr.35, datë 10.10.2007 i GJK.

¹⁵⁹ Objekt i së drejtës së pronësisë mund të jenë edhe paga, shpërblime, sigurimet shoqërore e shëndetësore, etj., mjafton që qëllimi dhe funksioni i tyre të përputhen me qëllimin dhe funksionin e për të cilin shërben pronë: pra, sigurimin e kushteve të nevojshme të jetesës.

duke vënë në zbatim ligje që i gjykojnë të nevojshme për këtë qëllim¹⁶⁰.

Të tre këto rregulla i përgjigjen të njëjtit qëllim: garantimin e pronarit nga ndërhyrje të tilla të shtetit që mund të arrijnë deri në atë pikë sa të rrezikojnë ekzistencën e vepërimitarisë fitimprurëse që ai ushtron.

Për rrjedhojë, sipas Kushtetutës si dhe sipas KEDNJ, e drejta e pronës mund të kufizohet, por vetëm duke plotësuar kriteret për kufizimet; si shpronësimi me ligj, për qëllime dhe interesa publike, duke respektuar parimin e proporcionalitetit si dhe kundrejt shpërblimit të drejtë. Për shpronësimet që bëhen për interesa publike, GJEDNJ ka theksuar se autoritetet kombëtare kanë një marzh më të gjerë vlerësimi, sepse janë ato që hartojnë strategjitë ekonomike të zhvillimit, por pa kaluar kufijtë e arsyeshem¹⁶¹.

GJEDNJ ka nxjerrë një vendim *pilot*¹⁶² për

160 *Shih* Manualin e të Drejtave të Njeriut nr.4, E drejta e pronës, Këshilli i Europës, 2001. Për një kuptim më të gjerë mbi të drejtën e pronës sipas GJEDNJ, në lidhje me të gjitha problematikat e saj në vendet postkomuniste të Evropës lindore, mund t'i referoheni *website*: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Source/Documents/HRTF/TR%2002.11/Caselaw10022011_ALB.pdf, vizituar me datë 15.10.2015

161 Po aty.

162 GJEDNJ vepron me tri tipe të vendimeve pilot: 1. Vendim pilot i plotë, ku Gjykata identifikon në mënyrë të qartë se në atë vendim ka aplikuar procedurën e një vendimi pilot. 2. Vendim quasi pilot, ku Gjykata identifikon problemet strukturore apo sistematike të sistemit, por ajo nuk e identifikon vendimin si pilot, duke mos dhënë përshkrim të masave të përgjithshme që duhen marrë nga shteti përkatës. 3. Vendime të tjera që adresojnë probleme sistematike, ku gjykata nuk aplikon në mënyrë të qartë nenin 46 të KEDNJ, por parashtron se çështja ngre probleme serioze sistematike, të cilat duhet të merren në konsideratë nga shteti përkatës.

Për më tepër, shih "Responding to Systematic Human Rights Violations: An Analysis of Pilot Judgments of the European Court of Human Rights and their Impact at the National Level", [Përgjigja ndaj shkeljeve sistematike të së drejtës: Një analizë e vendimeve Pilot të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe ndikimi të tyre në nivel kombëtar], e disponueshme online, <http://www.amazon.com/Responding-Systemic-Human-Rights-Violations/dp/9400000413>, vizituar me datë 22.10.2015.

Shqipërinë në këtë drejtim, dhe kjo lidhet me trajtimin e së drejtës së pronës nga legjislacioni dhe autoritetet shqiptare. Konkretisht, në çështjen *Manushaqe Puto kundër Shqipërisë*¹⁶³, në të cilën është konstatuar shkelje nga organet administrative për moszekzekutim vendimi, GJEDNJ ka theksuar se:

"...Gjykata tashmë ka konstatuar shkelje të ngjashme të Nenit 6 § 1 të Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës në çështje të tjera në lidhje me vonesat në zbatimin e vendimeve administrative dhe të formës së prerë për pronat në lidhje me Shtetin e paditur .

"Shteti përkatës duhet të marrë masa të përgjithshme, me qëllim që të sigurojë një mënyrë efektive të së drejtës për kompensim.

"Si fillim gjykata konstaton se ligji mbi pronësinë është ndryshuar shumë shpesh, të paktën 7 herë për periudhën 2004-2010. Megjithëse ndryshimet legjislative reflektojnë çështje në evoluim, kompleksiteti i dispozitave, praktika jokonsistente gjyqësore dhe ndryshimet frekvente do të kontribuojnë në mënyrë të paevitueshme në mungesë të sigurisë juridike përgjithësisht.

Shteti duhet të shmangë ndryshimet e shpeshta të legjislacionit dhe para se të bëjë ndryshime duhet të ekzaminojë implikimet financiare dhe ligjore.

(...) Ashtu siç e pranoi dhe qeveria në planin e veprimit, autoriteteve iu mungon një informacion i plotë dhe i besueshëm mbi numrin e përgjithshëm të vendimeve administrative që

163 Aplikimet nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, vendim i datës 31 korrik 2012.

njohin të drejtat e pronësisë dhe që përcaktojnë kompensim, të dala që nga viti 1993. Të dhënat e sakta do t'iu mundësonin autoriteteve përlogaritjen e faturës së kompensimit, si dhe mekanizmat e kompensimit.

(...)

Vendimmarrja mbi llojin e kompensimit kërkon maksimumin e transparencës dhe të eficiencës me qëllim rritjen e besimit të publikut. Do të ishte në interesin e përgjithshëm që rezultatet të bëhen publike, dhe të njoftohen me mjete komunikimi të ndryshme të aksesueshme.

(...)

“Ashtu si dhe propozimet e qeverisë në planin e veprimit të cilit i mungonin afate të përcaktuara, gjykata nuk mund të theksojë afate realiste dhe detyruese për çdo hap të procesit. Shtrirjet e shpeshta të afateve nuk i japin zgjidhje procesit dhe tronditin besimin e publikut në të.

(...)

Është e rëndësishme që me qëllim sigurimin e zbatimit të masave të përgjithshme, burime njerëzore dhe materiale të jenë në dispozicion të autoriteteve kompetente, si dhe koordinimi mes disa organeve me qëllim shkëmbimin e informacionit. Aty ku është e mundur, autoritetet mund të vendosin shkrirjen e institucioneve që krijojnë paralelizma apo dualizime kompetencash. Krijimi i strukturave të reja institucionale nuk duhet parë si një shtesë e re e procesit, por duhet justifikuar.¹⁶⁴

Administrata publike duhet të informohet në lidhje me vendimmarrjen e GJEDNJ kundër Shqipërisë, jo vetëm në rastet e vendimeve pilot, por më tepër për rastet konkrete, kur shkelja ka ardhur nga moszbatimi i ligjeve.

¹⁶⁴ Prg.110-118.

Gjithsesi, ky vendim pilot tregon jo vetëm problematikën komplekse të pronave në Shqipëri, por jep dhe udhëzime për mënyrën se si duhet të menaxhohet nga administrata publike procesi i kompensimi të pronave, në mënyrë të përshtatshme dhe si duhet të funksionojë administrata publike në tërësi, për të fituar besimin e publikut.

Kështu, transparenca, efica, komunikimi me publikun dhe marrja e mendimit të tyre, punë e mirë parapërgatitore para ndërmarrjes së hapave të ndryshëm ligjore administrativë, koordinimi, bashkëveprimi midis organeve duhet të jenë pjesë e një kulture administrative pune dhe për më tepër, pjesë e përhershme dhe në vazhdimësi e një administrate profesionale dhe të përgjegjshme për detyrat e saj.

GJEDNJ në raport me ankesat kundër Shqipërisë ka hasur probleme të përsëritura me vonesa në ekzekutimin e vendimeve administrative në çështje pronësie, ku ka konstatuar shkelje të nenit 6/1 dhe nenit 1, Protokollit 1 të KEDNJ¹⁶⁵.

Dihet që pas viteve 90', janë miratuar në Shqipëri një tërësi ligjesh, me synimin e riparimit të padrejtësive të trashëguara nga regjimi i mëparshëm, lidhur me garantimin e së drejtës për pronë private. Nuk mohohet se paketat ligjore ndër vite, si mekanizëm dhe instrument për zgjidhjen e çështjes së pronave kanë patur problematika në parashikimin në nivel legjislativ¹⁶⁶ dhe në zbatimin e tyre.

Kompleksiteti është reflektuar dhe në nevojën për interpretim dhe respektim të dimension-

¹⁶⁵ Çështjet Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, aplikimi nr.38222/02, vendim i datës 13 nëntor 2007, prg. 45-53 dhe 75-84; Hamzaraj kundër Shqipërisë, prg. 24-27 dhe 38-43; Nuri kundër Shqipërisë, prg. 26-29 dhe 35-40, 3 shkurt 2009.

¹⁶⁶ Për më shumë, shih vendimin nr.1, datë 06.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

it kushtetues të së drejtës së pronës, bashkëshoqëruar me një jurisprudencë të konsiderueshme të gjykatave të të gjitha niveleve. Kuptohet, se është vështirë për nëpunësit jo juristë – por edhe juristët – për t’u marrë me këtë ceshtje komplekse. Por përpjekjet duhen bërë për t’i kuptuar dhe për t’i zgjidhur problemet e mundshme.

Detyrimi parësor për respektimin e së drejtës së pronës u mbetet organeve administrative, si organet drejtpërdrejt zbatuese të së drejtës kushtetuese të pronës. Për nëpunësit e administratës publike është e rëndësishme të kenë një familjarizim të përgjithshëm me këtë të drejtë kushtetuese, tepër problematike në kontekstin shqiptar, e lidhur edhe me të drejta të tjera si; e drejta për strehim, e drejta për standard jetese, e drejta për aktivitet ekonomik, e drejta për mirëqenie ekonomike, etj.

USHTRIMI NR. 29	Një grup shtetasish bashkëpronarë të pasurive të paluajtshme janë ankuar për mospërfundim të procedurave të shpronësimit edhe pse ndërtimi i objektit ka filluar. Sipas tyre, edhe pse janë shpronësuar për interes të ndërtimit të një vepre publike, procedurat administrative për efekt shpronësimi nuk po përfundojnë.
PYETJE	Si do të trajtohet ky rast në kuadrin së drejtës së pronës? A kanë të drejtë ankuesit në lidhje me pretendimet e tyre?
OBJEKTIVI	Njohje me procedurat administrative dhe me të drejtat e individëve për pronat e tyre. Ndërgjegjësim për standardet kushtetuese të detyrueshme për t’u respektuar nga administrata publike në lidhje me të drejtën pronës.

USHTRIMI NR. 30	Një grup banorësh kërkojnë vlerësim të ri në përcaktimin e tokave të shpronësuar për ndërtimin e një hidrocentrali. Ata nuk janë të kënaqur me shpërblimin.
PYETJE	Si do të trajtohet ky rast në kuadrin së drejtës së pronës? A kanë të drejtë ankuesit në lidhje me pretendimet e tyre?
OBJEKTIVI	Njohje dhe familjarizim me procedurat administrative dhe me të drejtat e individëve për pronat e tyre. Ndërgjegjësim për standardet kushtetuese të detyrueshme për t’u respektuar nga administrata publike në lidhje me të drejtën pronës.
USHTRIMI NR. 31	Zonja X ka aplikuar dhe depozituar dosjen e saj në Komisionin e Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave Fier që në vitin 1995, më vonë me krijimin e Agjencisë, dosja e Zonjës X është transferuar në këtë Agjenci. Ajo ende sot nuk ka një përgjigje nga organi administrativ në lidhje me aplikimin e saj. Zonja ankohet se edhe pas 20 vitesh që ka depozituar aplikimin, nuk ka marrë përgjigje për pronat e saj.
PYETJE	Si do të trajtohen ky rast në kuadrin së drejtës së pronës? A ka të drejtë ankuesja në lidhje me pretendimet e saj?
OBJEKTIVI	Njohje dhe familjarizim me procedurat administrative dhe me të drejtat e individëve për pronat e tyre. Ndërgjegjësim për standardet kushtetuese të detyrueshme për t’u respektuar nga administrata publike në lidhje me të drejtën e pronës.

8.2.2 E drejta për arsim

Një e drejtë tjetër me shumë rëndësi për çdo individ është ajo për arsimimin. Neni 57 i Kushtetutës përcakton se:

1. *Kushdo ka të drejtën për arsimim.*
2. *Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.*
3. *Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë.* 4. *Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.*
4. *Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.*
5. *Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.*
6. *Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj”.*

Edhe KEDNJ sanksionon këtë drejtë. Sipas nenit 2 të Protokollit 1 të saj, “Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike”.

E drejta për arsim është një e drejtë thelbësore për ushtrimin dhe gëzimin e disa të drejtave të tjera. E drejta për punë, e drejta për një nivel të caktuar mirëqenie, e drejta për sigurime shoqërore si dhe të drejta të tjera ekonomike nuk mund të gëzohen në mënyrë të plotë pa respektimin e së drejtës për arsim me të gjithë

përbërësit e saj e saj. Kjo vlen gjithashtu për të drejtën për të marrë pjesë në jetën kulturore, për të gëzuar perfitimet e shkencës apo për të marrë arsimim sa më të kualifikuar mbi baza aftësie; asnjë nuk mund të gëzohet plotësisht pa arsimimin përkatës.

Duke qenë se kjo e drejtë është e lidhur me një tërësi të të drejtash të tjera të individëve, sikundër e drejta për informim, e drejta për punë, e drejta për mirëqenie ekonomike, është e rëndësishme që nëpunësit e administratës publike të kenë një familjarizim të përgjithshëm me konceptet dhe standardet kryesore për këtë të drejtë kushtetuese.

E drejta për arsimim bën pjesë edhe tek të drejtat e ashtuquajtura të drejtat solidariteti, sepse nga konventat e ndryshme shtetet janë të detyruar të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin edhe në këtë fushë. Boshllëku në lehtësirat dhe infrastrukturën për arsimim mes vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, kërkon politika aktive në fushën akademike mes vendeve, në nivel ndërkombëtar.

E drejta për arsimim përfshin disa elementë:

E drejta për t’u arsimuar: E drejta për t’u arsimuar përbën elementin më domethënës brenda së drejtës për arsimim. Në këtë element, përfshihen detyrimet pozitive të shtetit të ndërmarrë masa, në mënyrë që: arsimi filloz i detyrueshëm të jetë i aksesueshëm dhe falas për të gjithë¹⁶⁶; arsimi i mesëm i përgjithshëm të jetë i mundshëm për të gjithë,¹⁶⁷ arsimi i mesëm profesional dhe i lartë të jetë i aksesueshëm për të gjithë mbi baza aftësie¹⁶⁸, dhe që fëmijëve me aftësi të kufizuara t’u sigurohen programe të veçanta.

167 Po aty, neni 57/2.

168 Po aty, neni 57/3.

169 Po aty, neni 57/4.

Koncepti i arsimimit është dhënë edhe nga GJEDNJ sipas të cilit, “arsimimi i fëmijëve është një proces tërësor; prandaj dhe në çdo shoqëri, të rriturit duhet t’i transmetojnë besimin, kulturën dhe vlerat e tjera të rinjve, nëpërmjet mësimimit ose udhëzimeve, të cilat veçanërisht i referohen njohurive dhe zhvillimit intelektual”¹⁷⁰.

Në lidhje me diskutimin, nëse neni 2, i Protokollit 1, zbatohet dhe për arsimimin e lartë, dhe universitar, GJEDNJ, ka theksuar se:

“(…) Ndërsa fjalia e parë e nenit 2 të Protokollit 1... sanksionon aksesin në arsimin fillor dhe të mesëm, nuk ka ndalim të qartë mes arsimit të lartë dhe të tjerave forma arsimore. Në një sërë dokumentesh Këshilli i Europës i ka dhënë rëndësi arsimit universitar si element për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe forcimit të demokracisë¹⁷¹. Arsimi i lartë është një instrument që ndikon në përparimin e njohurive dhe është një pasuri kulturore dhe shkencore për individin dhe shoqërinë. Rrjedhimisht, është e vështirë të mos mendosh se...[Protokollit] ...të mos aplikohet për arsimin e lartë. Edhe pse ky paragraf nuk i detyron shtetet të krijojnë institucione të arsimit të lartë, çdo shtet që i krijon ata duhet të bëjë përpjekjet për akses efektiv në këto institucione të individëve”¹⁷².

Akses të barabartë: Përpjekjet për të eliminuar *de jure* dhe *de facto* diskriminimin dhe përshatja e masave specifike u siguron grupeve në disavantazh akses në gëzimin e të drejtave

170 Çështje Campbell dhe Cosans kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 25 shkurt 1982.

171 Në këtë kontekst shih Rekomandimin e Këshillit të Europës nr. 1998, dhe nr.1353, 1998.

172 Çështja Leyla Şahin kundër Turqisë, aplikimi nr. 44774/98, vendim i datës 10 nëntor 2005 prg.136-137. Për më tepër mund t’i referoheni, botimit “Mbi të drejtat kulturore sipas jurisprudencës së GJEDNJ”, i disponueshëm on line: http://www.echr.coe.int/Documents/Research_report_cultural_rights_ENG.pdf

jtave sociale, kulturore dhe ekonomike sipas parimeve të Limburgut¹⁷³.

Çdo lloj diferencimi i paarsyeshëm, jo objektiv, bazuar në racë, seks, gjini, origjinë shoqërore apo kriteri tjetër diskriminues, i pasqyruar në legjislacionin mbi arsimin apo praktikën e organeve të përfshira në këtë fushë, do të përbënte dhunim të kësaj të drejte.

Edhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka dhënë rëndësi luftës ndaj diskriminimit, me fokus të veçantë në sistemin arsimor¹⁷⁴.

Liria për të zgjedhur: E drejta për t’u arsimuar është e vetmja e drejtë, ku individit ka detyrimin të arsimohet deri në përfundim të arsimit fillor. Për të gjitha liritë/ të drejtat e tjera, shteti ka detyrime të veprojë apo mosveprojë, por individit mbetet i lirë t’i ushtrojë apo t’i gëzojë ato.

Përderisa arsimimi ka si objektiv kryesor, zhvillimin e personalitetit dhe talentit të fëmijës dhe pjesmarrjen e tij në shoqëri, një përfshirje e madhe e vetë fëmijëve në marrjen e vendimit për shkollim është e inkurajuar. Në të njëjtën kohë, instrumentet ndërkombëtare mbrojnë me forcë edhe lirinë e prindërve për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre.

Testi i zbatuar prej GJEDNJ, ka qenë nëse shteti në realizimin e kurrikulave është sjellë në mënyrë objektive, pluraliste dhe kritike. Nëse jo, atëherë ai (shteti) është i detyruar t’i garantojë fëmijëve përjashtim nga marrja pjesë në leksione në përputhje me atë ç’ka prindërit duan.

E drejta për të krijuar institucione arsimore pri-

173 Parimet e Limburgut mbi zbatimin e Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. (UN doc. e/cn.4/1987/17).

174 Kreu III “Mbrojtja ng diskriminimi në fushën e arsimit”, nenet 17-19.

vate: Kjo e drejtë i njihet kujdo në përputhje me kriteret përkatëse ligjore, që mund të ndryshojnë brenda hapësirës së vlerësimit të çdo vendi, por që duhet të plotësojnë standardet minimum të vendosura nga aktet ndërkombëtare, të detyrueshme për zbatim. Diskutimi në këtë element do të ishte, a duhet shteti t'i stimulojë dhe përkrahë financiarisht institucionet private siç vepron me ato publiket.

Liria akademike: E drejta për arsimim përfshin dhe lirinë akademike. Shteti duhet të garantojë lirinë e nevojshme për kërkimin shkencor dhe krijimin shkencor. Elementë të lirisë akademike janë vendosur në mënyrë të qëndrueshme në ato vende, të cilat njohin dhe respektojnë parimet e lirisë intelektuale dhe politike.

Edhe pse liria akademike ka karakteristika e saj të veçanta ajo është gjithmonë pjesë e një aspekti më të gjerë të të drejtave njerëzore. Shkalla e lirisë akademike varet nga shumë faktorë, p.sh. nëse shkolla është publike dhe për nga niveli i saj, d.m.th., a është fillore, kolegji apo universitet. Lirinë akademike mund ta ndajmë në dy lloje: *liri akademike individuale*, e cila mbron profesoratin dhe raportin e saj me administratën e universiteteve dhe *liri akademike institucionale*, e cila mbron universitetet nga ndërhyrja e pushtetit shtetëror.

Mbrojtja e nxënësve nga masat disiplinore degraduese: Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal¹⁷⁵.

Shteti është para detyrimit për të marrë të gjitha masat që fëmijët të trajtohen me dinjitet, detyrim ky si për shkollat publike dhe private. Shteti duhet të marrë përsipër përgjegjësinë

për kontrollin dhe mbikqyrjen e trajtimit të fëmijëve si në shkolla private ashtu dhe në ato shtetërore, që të jenë në përputhje me standardet e kërkuara të trajtimit njerëzor.

Sikundër u theksua më lart, kjo e drejtë ka disa elementë dhe passjell efekte zinxhir edhe në të drejtat e tjera. Nëpunësit e administratës publike, duhe të kenë parasysh se jo të gjithë qytetarët kanë të njëjtin nivel arsimor, formim profesional dhe kulturë të përgjithshme për artikullimin e interesave të tyre. Në këto kushte, gjatë veprimtarisë administrative, ata duhet të ndihmojnë qytetarët dhe t'i orientojnë maksimalisht drejt kërkimit të të drejtave të tyre, mënyrës se si t'i kërkojnë, kujt t'i drejtohen, duke i mirëkuptuar në raste të një niveli të dobët arsimor.

Nëpunësi publik, duhet t'i qaset kësaj të drejte, nëpërmjet tre mënyrave:

- » së pari, duke kuptuar se ekzistojnë nivele të ndryshme arsimimi, (vetëm arsimit fillores është i detyrueshëm) ai përballet me qytetarë që e pasqyrojnë dhe reflektojnë këtë diferencë, dhe për pasojë duhen trajtuar me kujdes, për të kuptuar nevojat dhe shërbimet që ata kërkojnë prej administratës publike;
- » së dyti të kuptojnë se kjo e drejtë lidhet me gëzimin e shumë të drejtave të tjera dhe për pasojë, nëse sektori ku punojnë është i lidhur me arsimim profesional, të mesëm apo trajnime/specializime të çfarëdo lloji të siguruara nga strukturat shtetërore, ata duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për të inkurajuar individët e interesuar për rëndësinë e arsimimit/edukimit profesional, e cila është e lidhur pazgjidhshëmrisht edhe me të drejtën për punësim dhe standardin e jetesës;
- » së treti, në kuptim më të gjerë, ata vetë në kuadër të së drejtës për zhvillim personal, të ndërjegjësohen për të drejtën që kanë

175 Neni 54/3 i Kushtetutës.

për të mësuar, për t'u trajnuar në lidhje me formimin profesional, dhe për të përparuar në sektorët publikë ku punojnë praktikisht,

me qëllim që të drejtat dhe liritë themelore të mund të gëzohen edhe nga ata si nëpunës publikë¹⁷⁶.

USHTRIMI NR. 32

Shtetasja shqiptare X është rezidente në Angli. Ajo është nena e një femije 9 vjeç, i cili ka disa probleme shëndetësore me diabetin dhe ka një trajtim dhe protokoll të posaçëm trajtimi në vazhdimësi. Nga një gjyq divorci me të shoqin, asaj iu la kujdestaria e fëmijës me vendim gjykate të shtetit anglez. Gjatë verës, fëmija erdhi në Shqipëri tek gjyshërit nga nëna. Babai, të cilit gjykata i kishte dhënë të drejtën e takimit shkoj ta takonte dhe të kalonte kohë me të. Herën e parë e realizoi takimin, e mbajti dy orë fëmijën dhe e ktheu përsëri tek shtëpia e gjyshërve. Herën e dytë e mori dhe nuk e ktheu më. Po vinte shtatori, koha kur fëmija duhet të fillonte shkollën; e shqetësuar e ëma kthehet në Shqipëri dhe njofton autoritetet përkatëse për rrëmbimin e fëmijës.

Ajo ndoqi të gjitha procedurat e brendshme të njohjes së vendimit të gjykatës angleze dhe të ekzekutimit nga zyra e përmbarimit. U paraqit pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe i kërkoi vënie në lëvizje, ndërsa iu tha se nuk ishte kompetencë e Ministrisë, u paraqit pranë Komisarariatit të Policisë, të cilët nuk u treguan të gatshëm për të bashkëpunuar. U paraqit në doganat përkatëse, për t'i lajmëruar mbi rrezikun e kalimit të kufirit, të cilët iu përgjigjen se në fokus të punës kanë kapjen e mallrave kontrabandë. Ndërkohë, të gjitha këto veprime të saj dhe përbalje me sportelet shtetërore zgjatën më shumë se dy muaj.

PYETJE

Për cilat të drejta të fëmijës bëhet fjalë? Çfarë roli kanë organet përkatëse në këtë proces? Në varësi të përgjigjeve të dhëna nga organet përkatëse, a ju duket gatishmëri dhe efektivitet si dhe përgjegjshmëri qëndrimi dhe përgjigjet e tyre? Po në kuadrin e bashkëpunimit dhe koordinimit, a janë qasur si duhet organet përkatëse publike? Po ju si do të sillleshit në këtë kontekst?

OBJEKTIVI

Ky rast ofrohet për të identifikuar, mësuar dhe kuptuar të drejtat e fëmijës si dhe detyrimet e organeve për bashkëpunim. Nëpërmjet këtij shembulli synohet ndërgjegjësimi me të drejtat e fëmijës, ndërgjegjësimi për rëndësinë e bashkëpunimit të organeve administrative ndërmjet tyre, si dhe rritja e përgjegjshmërisë së nëpunësve për të qenë pro aktivë në zbatimin e vendimeve gjyqësore.

8.2.3 E drejta për kujdes shëndetësor

Kushtetuta parashikon se shtetasit përfitojnë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti. Neni 55 i Kushtetutës përcakton se:

1. Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.

2. Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.

176 Neni 38 i Ligjit për Nëpunësin Civil, përcakton se: "Nëpunësi civil ka të drejtën të përmirësojë aftësitë profesionale nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike, donatorë të huaj apo të ardhurat vetjake. Ndërsa, neni 55/1/b i po këtij ligji përcakton se: Nëpunësi civil pezullohet, me kërkesë të tij, për periudha studimi më shumë se 1 muaj deri në 2 vjet.

Kjo dispozitë përmban dy pjesë: pika 1, thekson se e drejta për këtë kujdes duhet të jetë “e barabartë” për shtetasit, por nuk përcakton nivelin e këtij kujdesi, ndërsa pika 2, përcakton të drejtën për sigurimin shëndetësor, sipas procedurës së caktuar me ligj, por edhe një herë, pa caktuar nivelin minimum të kushteve dhe kritereve.

Kjo e drejtë mund të jetë konsideruar si e drejtë e karakterit ekonomik dhe social, por edhe me një aspekt kulturor të saj. Është e drejtë ekonomike dhe sociale, pasi ajo kërkon të mbrojë individët nga vuajtjet sociale dhe nga padrejtësitë ekonomike në drejtim të gëzimit të shëndetit, ndërkohë është kulturele, pasi kërkon që shërbimet shëndetësore të jenë mjaftueshëm të aksesueshme, edhe sipas kontekstit kulturor të individit.

Një përkufizim vizionar dhe i gjerë mbi të drejtën për shëndet është përcaktuar në preambulën e Kushtetutës së Organizatës Botërore të Shëndetit, sipas së cilës, me shëndet kuptohet:

“[...] një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale, dhe jo thjesht mungesë sëmundjeje.”¹⁷⁷

Siç dihet, çështjet e nivelit të kujdesit shëndetësor, të kushteve për ta ofruar, si dhe të mbrojtjes nëpërmjet sigurimeve shëndetësore janë çështje të vështira dhe problematike në shumë vende, jo vetëm në Shqipëri. Megjithatë, e drejta për kujdes shëndetësor duhet konsideruar me seriozitet nga çdo nëpunës apo organ i administratës publike, i cili dëshiron t'i

sigurojë qytetarëve të vet dinjitet njerëzor.

Duhet mbajtur mend se kjo e drejtë është thelbësore për mirëqenien fizike dhe mendore, integritetin fizik të një individit, dhe për rrjedhojë dhe për dinjitetin njerëzor.

Nëpunësit e administratës publike edhe pse mund të mos punojnë në sektorin e shëndetësisë, por në sektorë të tjerë, tepër të rëndësishëm për një jetë cilësore për individët, duhet të kenë në konsideratë faktin se nëse veprimtaria e tyre administrative çënon qoftë edhe në mënyrë të tërthortë mirëqenien fizike, mendore apo sociale të qytetarëve, ata mund të bëhen bashkëfajtorë në cenimin e së drejtës për shëndet të individëve.

Për shembull, qytetarë të cilët për çështjet e pronës kanë kaluar vite nëpër dyert e administratës publike, por edhe të gjykatave kanë kërkuar pranë GJEDNJ, edhe dëmshpërblim për shqetësimin/stresin e krijuar nga komunikimet e zvarritura dhe joefektive të administratës publike, me pasoja në shëndetin e qytetarëve.

Faktikisht GJEDNJ, edhe pse shumicën e jurisprudencës e ka të zhvilluar për të drejta civile dhe politike, gjithsesi ka dhe çështje të cilat janë të ndërlidhura me të drejtën për kujdes shëndetësor, edhe pse jo e sanksionuar shprehimisht në KEDNJ, por e zhvilluar nga tri dispozita të saj:

- » neni 2 (e drejta e jetës), që ka shërbyer si bazë për pretendime në lidhje me abortin, me të drejtën “për të vdekur” (eutanzia) si dhe me burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe financiare në sistemin shëndetësor, që mund të venë në rrezik shëndetin dhe jetën;
- » neni 5 (e drejta për liri dhe siguri), e cila ka shërbyer si bazë për pretendime në kontekstin e shëndetit mendor dhe fizik;

177 Kjo Kushtetutë ishte e miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Shëndetit, New York, 19 qershor -22 korrik 1946, hyrë në fuqi me 7 prill 1948. Ndryshime i janë bërë me Rezolutat e Asamblesë Botërore të Shëndetësisë, hyrë në fuqi me 3 shkurt 1977, 20 janar 1984, 11 korrik 1994 dhe 15 shtator 2005.

- » neni 8 (e drejta për jetë private dhe familjare), që ka shërbyer për pretendime të lidhura me procedurat mjekësore, me të drejtën e informimit mbi kujdesin shëndetësor si dhe me të drejtën për integritet moral dhe fizik.¹⁷⁸

Konkretisht, mund të përmendim, disa qëndrime ilustrative të GJEDNJ:

- » *Aksesi në të dhënat mjekësore:* Aplikantët, tetë gra rrome, nuk mund të mbeteshin shtatzënë pas trajtimit në dy spitalet e ndryshme. Dyshonin se kjo kishte ndodhur, pasi ishin sterilizuar gjatë qëndrimit në spital. Ato u ankuan, pasi nuk mund të merrnin të dhënat e dosjes së tyre mjekësore. GJEDNJ u shpreh se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës, pasi aplikantët nuk ishin lejuar dhe nuk u ishte dhënë akses për informacion nga dosjet personale mjekësore.¹⁷⁹
- » *Mungesë trajtimi të duhur mjekësor:* Aplikanti u mbrojt pas vdekjes para GJEDNJ nga një organizatë jo-qeveritare. Kishte vdekur në moshën 18 vjeç në një spital psikiatrik. I braktisur nga familja dhe i vendosur në një jetimore, ai ishte diagnostikuar me HIV-AIDS dhe ndërkohë vuante dhe nga një sëmundje mendore. GJEDNJ, u shpreh se ka pasur shkelje të nenit 2 të KEDNJ në thelb dhe procedurë, pasi personi ishte vendosur në institucionet mjekësore, të cilat nuk kishin pajisjet e duhura për trajtimin e tij; ai ishte transferuar nga një spital në tjetrin, pa i bërë një kontroll të saktë. Autoritete spitalore kishin dështuar në dhënien e kujdesit të

duhur shëndetësor. Autoritetet në dijeni të situatës së vështirë - mungesë personeli, pamjaftueshmëri ushqimi, ngrohjeje, në mënyrë të paarsyeshme e kishin vendosur jetën e tij në rrezik. Ndërkohë, që pas vdekjes nuk kishin bërë hetimet e duhura mbi rastin.¹⁸⁰

- » *Konfidencialiteti i të dhënave të lidhura me gjendjen shëndetësore:* Aplikanti pretendoi që është shpërndarë informacioni privat në lidhje me gjendjen e tij mendore dhe trajtimin psikiatrik. GJEDNJ u shpreh se, shpërhapja e informacioni para një trupi gjykues për gjendjen mendore të aplikantit dhe trajtimit mjekësor të tij, ishte i panevojshëm në çështjen në shqyrtim para gjykatës. Këto detaje nuk ishin të rëndësishme për zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes në fjalë, dhe ka pasur shkelje të nenit 8 të KEDNJ.¹⁸¹
- » *Diskriminimi për shkaqe shëndetësore:* Aplikanti, një qytetar Usbek, pretendoi diskriminim, për shkak se autoritetet ruse i kanë mohuar lejen e qëndrimit, me argumentin se ishte me virusin HIV/AIDS dhe përbënte rrezik për shëndetin publik. GJEDNJ u shpreh se ka pasur shkelje të nenit 8 së bashku me nenin 14 të KEDNJ. Edhe pse është e vërtetë që masat e marra duhet të ndjekin një qëllim legjitim, si ai i mbrojtjes së shëndetit publik, në rastin në fjalë, kufizimet në lidhje me kategorinë e personave të prekur me HIV nuk justifikohen me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik.

178 Për më tepër referohuni në website: http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Health_ENG.pdf, vizituar me datë 12.10.2015.

179 Çështja K.H. dhe të tjerë kundër Republikës së Sllovakisë, aplikimi nr. 32881/04, vendim i datës 28 prill 2009.

180 Çështja Center of Legal Resources në emër të Valentin Câmpeanu kundër Republikës së Rumanisë, vendim i datës 17 korrik, 2014.

181 Çështja Panteleyenکو kundër Ukrainës, vendim i datës 29 qershor 2006.

Në çështjen konkrete, duke mos marrë në konsideratë grupin vulnerabël, të cilit i përket, mungesën e një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm dhe vlerësimin individual të aplikantit, autoritetet kanë tejkaluar hapësirën ngushtë të vlerësimit, prandaj dhe aplikanti ka qenë viktimë e diskriminimit mbi shkaqe shëndetësore.¹⁸²

Detyrimi parësor për respektimin e së drejtës për kujdes shëndetësor u takon nëpunësve civilë, si nëpunësit që drejtpërdrejt kontaktojnë me qytetarët për dhënien e shërbimeve të ndryshme. Veprimtaria e tyre duhet të kenë në qendër kujdesin ndaj qytetarit, sepse në të kundërt një veprim apo sjellje jo duhur, e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, mund të pasjellë edhe cenim të gjendjes fizike apo emocionale, dhe për rrjedhojë edhe të së drejtës për shëndet. Në këtë prizëm nëpunësit e administratës publike/ organet administrative duhet të kenë një familjarizim të përgjithshëm me konceptet dhe standardet kushtetuese, por edhe ndërkombëtare mbi të drejtën për shëndet.

USHTRIMI NR. 33

Një grua shtatzënë iu drejtua spitalit shtetëror për ndihmë mjekësore për ardhjen në jetë të fëmijës. Infermierja e spitalit refuzoi t'i jepte ndihmën e parë, pasi gruaja vinte nga një zonë e thellë dhe e varfër e qytetit dhe sipas infermieres, pacientja nuk duhej t'i ishte drejtuar atij spitali, por një tjetri ku përfshihej dhe zona e saj administrative

PYETJE

Para cilës së drejtë jemi në këtë rast? Po nëse ka diskriminim sipas jush, mbi çfarë shkakut?

OBJEKTIVI

Të kuptohen qasjet e nëpunësve publike ndaj ofrimit të shërbimeve publike në përgjithësi, por edhe në veçanti në sistemin shëndetësor. Të rritet ndërgjegjësimi për aksesin në shërbime publike të të gjitha kategorive të njerëzve.

182 Çështja Kiyutin kundër Rusisë, vendim i datës 10 mars 2011.



IX. Edhe ju nëpunësit keni të drejta!

9.1 KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

Ky Manual kryesisht është përqendruar tek sjellja e nëpunësve civilë në marrëdhëniet me publikun, me qëllim që ata të respektojnë të drejtat e liritë themelore të këtyre të fundit si dhe për t'i ndihmuar ata në krijimin e një kulture të të drejtave të njeriut në administratën publike shqiptare.

Por nuk mund të mos pranohet se të drejtat dhe liritë themelore të radhitura në Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare mbrojnë dhe janë të zbatueshme edhe për nëpunësit vetë, dhe në këtë kapitull të fundit të Manualit do të hulumtojmë disa aspekte të këtij fakti.

Sigurisht, Kushtetuta dhe Administrata Publike janë në një marrëdhënie jo të thjeshtë. Kushtetuta krijon një sistem tre-dimensional të ndarjes së pushteteve, d.m.th., legjislativi, gjyqësori dhe ekzekutivi. Administrata publike nuk vendoset lehtësisht në këtë skemë. Por një nga testet e vërteta të një qeverisjeje të përgjegjshme është prodhimi i administratës së mirë. Një administratë publike moderne dhe cilësore nuk e ka të vështirë përshatjen të standardeve dhe kërkesave kushtetuese, duke konsideruar dhe respektuar ndarjen dhe balancimin e pushteteve¹⁸³.

Kushtetuta mbron administratën publike në disa raste. E përmend termin “funksionarë publik” në nenin 81/e, ku sanksionon domosdoshmërinë e miratimit me tre të pestat të ligjeve për statusin e funksionarëve publikë¹⁸⁴. Ndërkohë, neni 107 i Kushtetutës përcakton termin “nëpunës publik”.¹⁸⁵ Sipas këtij neni: “1. Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit. 2. Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji. 3. Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohet me ligj”.

Termet e ndryshme gjenden në ligje të ndryshme lidhur me të punësuarit në administratë publike, si nëpunës civil, nëpunës publikë,

183 Mjafton t'i referohemi jurisprudencës së konsiderueshme të GJK mbi mosmarrëveshjen e kompetencave dhe pavarësinë e gjyqësorit, për të kuptuar dimensionin kushtetues të marrëdhënieve mes tre pushteteve.

184 Neni 81, sanksionon se: “1. Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës. 2. Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit: a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta; b) ligji për shtetësinë; c) ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore; ç) ligji për referendumet; d) kodet; dh) ligji për gjendjen e jashtëzakonshme; e) ligji për statusin e funksionarëve publikë; ë) ligji për amnistinë; f) ligji për ndarjen administrative të Republikës”.

185 Shih dhe vendimin nr.10, datë 06.03.2014 të GJK, mbi ligjin për administratën gjyqësore.

funksionarë publikë, zyrtarë publikë, ndërsa legjislacioni shqiptar me “nëpunës civil” kupton vetëm ata nëpunës që gëzojnë këtë status sipas Ligjit për Nëpunësin Civil.

Disa shtete përpiqen të harmonizojnë legjislacionin e shërbimit civil me atë mbi punësimin në përgjithësi, ndërsa në shtete të tjera duke përfshirë Shqipërinë, shërbimi civil përkufizohet dhe trajtohet me një ligj të posaçëm. Nuk ka një përgjigje evropiane për pyetjen se çfarë është nëpunësi civil¹⁸⁶. Gjithashtu, detyrat dhe kompetencat e një nëpunësi civil varen nga ligjet kombëtare të çdo vendi¹⁸⁷. Madje, sipas praktikave më të mira të Bashkimit Evropian, edhe nëpunësit e administratës gjyqësore kanë statusin e shërbimit civil, specifik në përputhje me karakteristikat që i përshtaten organizimit gjyqësor, p.sh. në Francë, edhe punonjësit e administratës gjyqësore konsiderohen nëpunës civilë¹⁸⁸.

Me gjitha konsiderata e mësipërme, mund të kuptohet se statusi dhe, për rrjedhojë, edhe të drejtat e nëpunësve civilë kanë elementë komplekse, por thelbësor është fakti, se të drejtat e njeriut, siç e kemi theksuar shumë herë më sipër, u përkasin të gjithëve.

186 Study intended for the Ministers responsible for Public Administration of the Member States of the European Union, Luxembourg, 8 June 2005, In collaboration with the Luxembourg Presidency of the Council of the European Union, “A new space for public administrations and services of general interest in an Enlarged Union”, (Një hapësirë e re për administratat publike dhe shërbimet e një interesi të përgjithshëm në një Bashkim Evropian të zgjeruar) e disponueshme: http://www.mju.gov.si/fileadmin/mju.gov.si/pageuploads/mju_dokumenti/pdf/ETUDE_un_nouvel_espace_pour_les_adm_pub_EN.pdf, fq.16, vizituar me datë 4.11.2015.

187 Po aty, fq.17.

188 “Republic of France, Public Administration Country Profile”, (Profili i administratës publike në Francë) OKB, prill 2006, fq.15. Për më tepër referoju materialit online: <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/un/unpan023308.pdf>, vizituar me datë 20.11.2015

Çfarë elementesh të veçantë duhen marrë parasysh për nëpunësit publikë?

Sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, koncepti i administratës publike nuk mund të zhbejë aplikimin e rregullave të Komunitetit për lëvizjen e lirë të punonjësve. Sipas GJED-së, kriteri i përjashtimit duhet të jetë *funksional*, dhe jo *institucional*, bazuar në detyrat, përgjegjësitë e zyrtarit në postin e caktuar me qëllim që përcaktimet kombëtare sipas ligjeve të vendeve përkatëse për konceptin funksionar publik, apo të punësuar në shërbime publike të mos pengojnë zbatimin e legjislacionit komunitar¹⁸⁹.

Administrata publike mbulon shërbime publike dhe pa qenë i nevojshëm ushtrimi i pushtetit publik, si pjesë e sovranitetit shtetëror dhe mbulon interesa të përgjithshme shtetërore në ato raste kur këto shërbime mund të ofrohen dhe në mënyrë private. Duke u identifikuar qartë nga ligjvënësi shqiptar, lloji i shërbimeve publike, që mund të ofrohen vetëm nga shteti, lloji i shërbimeve publike që ofrohen si pasojë e një partneriteti shtet-privat, pozicionet në administratë publike, natyra e funksioneve, detyrat përkatëse në përputhje me funksionin, edhe identifikimi i kategorisë e funksionarëve publikë, mbi të cilët duhet të veprojnë kufizime të caktuara të të drejtave dhe lirive themelore të individit, edhe trajtimi i të drejtave dhe detyrave të nëpunësve civilë në kontekstin e marrëdhënies së tyre të punësimit mund të bëhet detyrë më e lehtë¹⁹⁰.

189 Komisioni i Komunitetit Ekonomik Evropian kundër Dukës së Luksemburgut, vendim i datës 2 korrik 1996

190 E gjithë kjo sipërmarrje në fakt konvergjon me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ku reformimi i administratës publike është detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (neni 111).

Në lidhje me mosmarrëveshjet e punësimit, referuar shqyrtimit të së drejtës për akses në gjykatë të individit në cilësinë e “funksionarit publik”, jurisprudenca e GJEDNJ ka njohur vështirësi në përcaktimin e natyrës së përgjegjësive dhe statusit të funksionarit publik si edhe evidentimin e kategorisë së nëpunësit publik, sipas fushës ku ai vepron.

Sipas GJEDNJ-së, ka raste kur nuk zbatohet neni 6 (garancitë procedurale të procesit gjyqësor) të KEDNJ mbi punonjësit në një sektor publik, por kufiri nuk është shumë i qartë; të paktën, natyra e përgjegjësive individuale të tij duhet marrë në konsideratë¹⁹¹. GJEDNJ ka theksuar se:

“Gjykata rinjeh interesin e shtetit për të kontrolluar disa lloj funksionesh publike. Megjithatë është detyrë e legjislatorit vendas të identifikojë fushat përkatëse dhe pozicionet përkatëse ku shteti ka interes më të lartë publik bazuar mbi ushtrimin e detyrave që i përkasin së drejtës publike dhe ku të drejtat individuale duhen lënë mënjanë.

“Gjykata rithekson rolin e saj mbikëqyrës, si pjesë e parimit të subsidiaritetit. Nëse sistemi ligjor vendas nuk lejon aksesin në gjykatë të këtyre pozicioneve, gjykata do verifikojë nëse mosmarrëveshja është e tillë që të justifikojë përjashtimin e garancive të nenit 6/1 të Konventës. Nëse jo, atëherë nuk ka arsye pse neni 6 me garancitë e tij të mos zbatohet.

“Për ta përmbledhur shteti anëtar duhet të

191 Çështja Vilho Eskelinen dhe të tjerë kundër Finlandës, aplikimi nr. 63235/00, vendim i datës 19 prill 2007, prg.52. Në këtë kontekst, Vilho Eskelinen ishte, një polic, i cili kishte nënshkruar një kontratë me institucionin, sipas të cilës pranonte të ushtronte detyrën, në një pjesë të largët dhe të izoluar të vendit dhe për të cilën kishte një trajtim financiar të posaçëm në varësi të distancës së vendit ku punonin. Më vonë kjo pjesë e trajtimit financiar u shfuqizua dhe Z. Eskelinen ngriti një padi në gjykatë, për të kërkuar kompensim financiar.

përmbushë dy kritere me legjislacionin vendas në mënyrë që nëpunësi civil të përjashtohet nga zbatimi i nenit 6/1. Së pari, mungesa e aksesit në gjykatë të sanksionohet me ligj duke specifikuar kategoritë përkatëse. Së dyti, shteti të ketë të justifikuar interesin e tij për këtë lloj përjashtimi.

“Fakti i thjeshtë se punonjësi punon në sektorin publik mbuluar nga e drejta publike për shkak të kriterit të besnikërisë në vetvete nuk mjafton. I takon shtetit të vërtetojë se mosmarrëveshja është e tillë që lidhet me ushtrimin e pushtetit shtetëror dhe që kërkon një kriter të veçantë besnikërie.

“Prandaj në parim garancitë e nenit 6 u ofrohen të gjithë personave në mosmarrëveshje punësimi, me prezumimin se neni 6/1 do të aplikohet. Qeveria duhet të argumentojë se ky nëpunës sipas ligjit të brendshëm nuk ka akses në gjykatë dhe se përjashtimi nga garancitë e nenit 6/1 për të janë të justifikueshme”¹⁹².

Me këtë vendim, GJEDNJ pranoi se, nëse sistemi vendas nuk ka perceptuar asnjë lloj konflikti mes interesave shtetërore dhe të drejtës së funksionarit publik për të gjetur mbrojtje në gjykatë, atëherë praktika duhet zhvilluar në drejtim të zgjerimit të mbrojtjes së nëpunësve publikë dhe zgjerimit të përfitimit të garancive dhe të drejtave të njeriut nga ata si bartës të funksioneve publike.

Në përgjithësi, GJEDNJ i ka interpretuar të drejtat e nëpunësit publik, si subjekt përfutues që gëzon të drejta si të gjithë individët e tjerë dhe se marrëdhënia e tyre e veçantë me shtetin nuk i zhvesh ata nga të drejtat dhe liritë themelore, duke përfshirë dhe lirinë e shprehjes¹⁹³. GJEDNJ ka theksuar se:

192 Po aty, paragrafët 31-63 të vendimit.

193 Çështja Glasenapp kundër Gjermanisë, aplikimi nr. 9228/80, vendim i datës 28 gusht 1986.

"...për shumë të drejta nëpunësit civilë nuk janë të përjashtuar nga qëllimi i KEDNJ. Në nenin 1 dhe 14, kjo konventë thekson fjalën "çdokush brenda juridiksionit të vendeve anëtare" duhet të gëzojë të drejtat dhe liritë pa asnjë lloj diskriminimi. Gjithsesi, neni 11/2 (liria e organizimit dhe e anëtarësimit) i KEDNJ i lejon shtetit të vendosë disa kufizime për "anëtarët e forcave të armatosura, të policisë si dhe të administratës". GJEDNJ konfirmon faktin se si rregull i përgjithshëm garancitë e Konventës shtrihen edhe tek nëpunësit civilë"¹⁹⁴.

Megjithatë, GJEDNJ u jep shteteve një hapësirë të gjerë vlerësimi, në lidhje me kufizimet e lirisë së shprehjes për funksionarët publikë.

Në disa raste, kjo Gjykatë ka analizuar në mënyrë të veçantë dhe i ka dhënë peshë statusit të mësuesit, për shembull, kur një "mësues historie" kishte shkruar një artikull tek gazeta e shkollës me fjalë ofenduese ndaj afrikano-jugorëve. Në atë rast, GJEDNJ theksoi "përgjegjësitë dhe detyrat specifike" të mësuesve, përderisa ata janë "figura autoriteteve për nxënësit". Ajo shtoi argumentin se "*arsimimi mbi qytetarinë i cili është thelbësor për luftën ndaj racizmit dhe ksenofobisë, kërkon aktivizimin e personave përgjegjës dhe pjesëmarrës në këtë proces, veçanërisht të mësuesve*"¹⁹⁵.

Sigurisht, këto parime vlejné në mënyrë të veçantë për nëpunësit shtetëror me detyrat edukative, por duhet marrë parasysh se si përfaqësues të shtetit, çdo nëpunës civil duhet të flasë dhe të shkruajë më përgjegjshëm kur është në kryerjen e detyrave.

Nga ana tjetër, në jurisprudencën e GJEDNJ

¹⁹⁴ Po aty, prg.49.

¹⁹⁵ Çështja Seurot kundër Francës, aplikimi nr. 5783/00, vendim i datës 18 maj 2004.

ka gjetur trajtim dhe konkurrimi i të drejtave të punëmarrësit me të drejtat e punëdhënësit. Në rastin *Barbulescu kundër Rumanisë*, GJEDNJ trajtoi çështjen e përdorimit të internetit në vendin e punës, në drejtim të detyrimeve pozitive të shtetit për të respektuar jetën private, (edhe pse punëdhënësi i përkiste sektorit privat). Kjo gjykatë theksoi se, edhe pse është hapur e-mail-i privat i punonjësit nga ana e punëdhënësit, ndërhyja ka qenë proporcionale, pasi punëdhënësi ka dashur të verifikojë, nëse punonjësi i tij kryente detyrat profesionale si duhet gjatë orarit të punës. Për sa kohë që nuk kishte fakte apo të dhëna se punëdhënësi kishte hapur komunikimet private të punonjësit, të gjendura dhe të marra nga llogaria e tij elektronike, por i ishte referuar vetëm atyre komunikimeve të dërguara gjatë orarit të punës, ndërhyrja ka qenë e arsyeshme dhe e ligjshme.¹⁹⁶

Mund të thuhet se GJEDNJ pranon disa kufizime, në lidhje me të drejtat e nëpunësve publikë, kryesisht në drejtim të lirisë së shprehjes, mbrojtjes së të dhënave personale, aksesit në gjykatë, si dhe lirisë së organizimit dhe anëtarësimit.

Nëpunësit publikë duhet të kenë vëmendje të posaçme ndaj respektimit të kufizimeve, që janë të justifikueshme. Nëse mendojnë, se kufizimet janë tej kritereve ligjore apo kushtetuese, ose kanë dyshime për ligjshmërinë apo kushtetutshmërinë e çdo lloj akti apo veprimi, ata disponojnë një serë mekanizmash ankimi sipas rastit.

¹⁹⁶ Çështja *Bărbulescu kundër Rumanisë*, aplikim nr. 61496/08, vendim i datës 12 janar 2016, prg. 54-61.

Ku mund të drejtohet nëpunësi publik, personalisht, ose i organizuar në shoqata apo sindikata, për shkelje të të drejtave të tij?

- » Nëpunësi publik mund t'i drejtohet gjykatës administrative për çdo lloj veprimi apo akti që ndryshon apo shuan marrëdhënien e tij të punës¹⁹⁷.
- » Nëpunësi publik mund t'i drejtohet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për pretendime të lidhura me sjellje diskriminuese ndaj tij, apo forma të tjera viktimizimi apo shqetësimi.
- » Nëpunësi publik mund t'i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për pretendime të lidhura me mungesën informimit ndaj tij, si subjekt gëzues i të drejtës për informim në kontekstin e marrëdhënies së punësimit, apo për pretendime për dhunimin e mbrojtjes së të dhënave personale të tij, po në kontekst të marrëdhënies së punësimit.
- » Nëpunësi publik mund t'i drejtohet Avokatit të Popullit, i cili ka për funksion kushtetues mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit ndaj çdo shkeljeje, veprimi apo mosveprimi nga veprimtaria e administratës publike, përfshirë dhe mbrojtjen e të drejtave të nëpunësve publikë.
- » Nëpunësi Civil mund t'i drejtohet Komisionerit për Shërbimin Civil, që edhe pse nuk vihet në lëvizje me kërkesë të nëpunësit, por informacionet e mbledhura nga nëpunësit mund t'i shërbejnë për verifikimin e rasteve me iniciativë.¹⁹⁸
- » Shoqatat apo sindikatat e krijuara për mbrojtjen e të drejtave që lidhen me punësimin, mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, për akte normative ligjore apo nënligjore, që çenojnë të drejtat e tyre kushtetuese¹⁹⁹.

Nëpunësit publikë mund t'i konsiderojmë si subjekte pasive dhe aktive. Janë *pasive* kur mbi vetë ata bien ligjet antikushtetuese apo veprimet e paligjshme të eprorëve ose organeve publike, që i kanë punësuar, dhe *aktive* kur ato vetë me veprimet e tyre shkaktojnë shkelje të të drejtave të individit në veprimtarinë e tyre administrative, gjatë ushtrimit të funksioneve publike. Prandaj dhe në këtë kontekst një lloj tensioni mund të krijohet edhe midis administratës publike dhe të drejtave kushtetuese të punonjësve të saj.

197 Ligji nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

198 Neni 14 i Ligjit për Nëpunësin Civil, sipas të cilit: Komisioneri për Shërbimin Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë. Në ushtrimin e kompetencave, Komisioneri: a) kryen hetim të plotë administrativ, sipas Kodit të Procedurave Administrative; b) kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij; c) inspekton dosjet dhe çdo dokument, lidhur me administrimin e shërbimit civil; ç) kërkon, kryesisht apo me kërkesë, dëshmi të çdo nëpunësi apo funksionari të institucionit; d) këqyr dhe inspekton çdo praktikë administrimi në çdo institucion që punëson nëpunës civilë.

199 Neni 134/f i Kushtetutës

Në një çështje me objekt “Shfuqizimin e vendimeve për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike”, Këshilli i Ministrave pretendoi se qëllimi i nxjerrjes së vendimeve në fjalë diktohej nga kushtet e gjendjes së korrupsionit në administratën publike.

Sipas GJK, vendimet ishin antikushtetuese, sepse kufizimi nuk ishte bërë me ligj, sipas nenit 17 të Kushtetutës, por edhe sikur të ishte bërë me ligj, vendimet nuk respektonin parimin e proporcionalitetit dhe të sigurisë juridike.

Në vazhdim, GJK theksoi se:

“ (...) Vendimeve u është dhënë fuqi prapavepruese, duke prekur edhe ata punonjës që kanë qenë në marrëdhënie pune para daljes së vendimeve. Antikushtetutshmëria e vendimeve nuk qëndron vetëm në faktin se vendimet e Këshillit të Ministrave kanë efekt edhe për marrëdhëniet e krijuara më parë, por dhe për shkak të mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit, sepse punonjësve që preken nga këto vendime nuk u sigurohet punë tjetër”²⁰⁰.

Në rastet e zbatimit të legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punësimit në administratën publike, GJK argumenton detyrimin e organeve të administratës publike për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, për rikthim në vendin e punës të nëpunësve civilë të larguar, duke mos justifikuar argumentin e organit përkatës, palë e paditur, se në atë vend është emëruar një person tjetër.

Në një vendim për rikthim në punë të një nëpunësi të Ministrisë së Drejtësisë, GJK u shpreh se:

200 Vendimi nr.20, datë 11.07.2006 i GJK.

“..Rikthimi në punë është urdhëruar si pasojë e shfuqizimit të urdhrit të largimit nga puna për shkak se është konstatuar si i pabazuar në ligj. Pretendimi i Ministrisë së Drejtësisë se rikthimi në pozicionin e mëparshëm është i pamundur për shkak se në atë pozicion është emëruar një person tjetër, i cili gëzon statusin e nëpunësit dhe për këtë arsye do të konsiderohej e paligjshme masa e largimit me qëllim rikthimin në punë të kërkueses, është i pabazuar.

“I takon debitorit [Ministrisë] të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Pavarësisht zgjidhjes që mund dhe duhet të ofrojë debitori, Gjykata vlerëson se pjesa e detyrimit të përcaktuar me vendim gjyqësor sa i përket rikthimit në punë është i qartë”²⁰¹.

Gjithsesi, një lloj tensioni mund të krijohet mes nëpunësit publik si individ dhe bartësi i të drejtave kushtetuese dhe nëpunësit publik si bartës i detyrimeve për shkak të pozicionit zyrtar, duke u vënë në konkurrim njëherësh dy vlera kushtetuese (p.sh. informimi dhe privatësia).

Në lidhje me të drejtën e privatësisë së funksionarëve publikë në konkurrencë me të drejtën për informim/transparencë të qytetarëve, në një çështje të lidhur me publikimin e deklarimeve të zyrtareve në *webpage*-in e Inspektoriatit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë, GJK është shprehur se:

“...në rastin konkret, kufizimi i të drejtës së jetës private në formën e deklarimit të pasurisë dhe mosmarrjes së pëlqimit për publikimin e mundshëm të të dhënave personale për tre kategori personash (subjekti deklarues, familjarët e tij dhe personat e lidhur me të) në përputh-

201 Vendimi nr.2, datë 01.2. 2011 i GJK.

je me ligjin “Mbi të drejtën e informimit”, vjen për shkak të interferimit me njëra tjetrën të dy vlerave të rëndësishme kushtetuese apo dy të drejtave themelore. (...)

“Transparenca dhe besimi i publikut në këtë kategori njerëzish luajnë rol të rëndësishëm në shtetin e lirë e demokratik. Pikërisht për këtë arsye, në jurisprudencën e vendeve të ndryshme demokratike është deklaruar se “publikimi i detajeve mbi të ardhurat ose pasurinë personale nuk përbën ndërhyrje në jetën private, veçanërisht nëse personi ushtron funksione publike ose kuazi – publike”²⁰².

Si përfundim mund të thuhet se ka një lloj tensioni mes administratës publike dhe të drejtave kushtetuese të nëpunësve publikë në detyrë.

9.2 Të drejtat e nëpunësve civilë²⁰³

Ligji për Nëpunësin Civil ka dhënë konceptin e nëpunësit civil dhe fushën e zbatimit të tij për çdo nëpunës civil, që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore. Ky ligj ka përcaktuar qartë dhe kategorinë e përjashtuar të funksionarëve publikë, që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil²⁰⁴.

Nga ana tjetër, ky Ligj ka trajtuar dhe “rastet e veçanta”, që do të thotë ka konsideruar nëpunës civilë edhe punonjësin e policisë dhe punonjësin e shërbimit të jashtëm, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.

202 Vendimi nr.16, datë 11.11.2004 i GJK.

203 Në këtë nën çështje në trajtimin teorik kemi përdorur vetëm termin “nëpunës civil”, duke pasur parasysh se i referohemi vetëm Ligjit për Nëpunësin Civil, dhe jo kategorisë së “nëpunësve publikë” përdorur si term në përgjithësi, dhe trajtuar në pjesët e tjera të Manualit, pa ndonjë diferencim qëllimor.

Gjithsesi, Ligji u ka lënë hapësirën këtyre dy kategorive të nëpunësve civilë, që të kenë të rregulluar me ligj të posaçëm elementë shtesë të marrëdhënieve të shërbimit civil²⁰⁵.

KATALOGU I TË DREJTAVE TË NËPUNËSVE CIVILË

Ligji për Nëpunësin Civil ka parashikuar të drejtat e nëpunësve civile, të cilat po i listojmë sikundër janë prezantuar në ligj, pa komente²⁰⁶.

» *E drejta e kushteve të përshtatshme të punës dhe e drejta e mbrojtjes nga shteti*
Nëpunësi civil ka të drejtën për kushte pune të përshtatshme. Institucionet shtetërore sigurojnë kushtet për mbrojtjen e integritetit fizik, moral dhe dinjitetit të nëpunësit civil. Nëpunësi civil mbrohet nga shteti në ushtrimin e detyrave të tij në shërbimin civil. Institucioni shtetëror, ku nëpunësi ushtron detyrën,

204 Neni 2 i Ligjit Për Nëpunësin Civil, i ndryshuar. Ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (në vazhdim “nëpunës civil”), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, me përjashtim të:

- të zgjedhurve;
- ministrit dhe zëvendësministrit;
- funksionarët e emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës ose Këshilli i Ministrave;
- gjyqtarit dhe prokurorit;
- nëpunësit të administratës gjyqësore;
- ushtarakut të Forcave të Armatosura;
- personelit të Shërbimit Informativ Shtetëror;
- personelit të njësive publike direkte të shërbimit;
- anëtarit dhe kryetarit të organeve kolegjiale drejtuese të komiteteve apo institucioneve në varësi të Kryeministrit apo një ministri;
- punonjësit administrativ;
- funksionarit të kabinetit
- punonjësve që realizojnë atributet e agjentit/oficerit të Policisë Gjyqësore dhe ata që sipas ligjit lejohet të mbajnë armë;
- civilët në strukturat e Forcave të Armatosura;
- punonjësit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;
- punonjësit e bordeve të kullimit;
- avokatët pranë Avokatit të Shtetit.

205 Neni 3 i Ligjit për Nëpunësin Civil.

206 Nenet 33-41 të Ligjit për Nëpunësin Civil.

siguron mbrojtjen e nëpunësit civil gjatë ushtrimit të detyrës apo në lidhje me të, duke kërkuar, nëse është e nevojshme, mbështetjen e organeve të specializuara sipas ligjit.

- » *E drejta e pagës dhe struktura e saj.* Nëpunësi civil ka të drejtën e pagës për ushtrimin e detyrës në shërbimin civil sipas ligjit.
- » *E drejta e grevës.* Nëpunësi civil ka të drejtën e grevës, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji. Në çdo rast e drejta e grevës nuk lejohet në fushën e shërbimeve thelbësore të veprimtarisë shtetërore si transporti, televizioni publik, furnizimi me ujë, gaz dhe energji elektrike, administrata e burgjeve, administrata e sistemit të drejtësisë, shërbimet kombëtare të mbrojtjes, shërbimet shëndetësore urgjente, shërbimet për furnizimin me ushqime ose shërbimet e kontrollit të trafikut ajror.
- » *E drejta e anëtarësimit në sindikatat dhe shoqatat profesionale.* Nëpunësi civil ka të drejtë të krijojë dhe të bëhet anëtar i sindikatave dhe shoqatave profesionale që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të tyre në shërbimin civil. Ai, gjithashtu, mund të zgjidhet në organet drejtuese të sindikatave dhe të marrë pjesë në veprimtarinë e tyre, jashtë orarit zyrtar.
- » *Të drejtat politike.* Nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar. Nëpunësi civil nuk duhet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike. Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Nëpunësit civilë të kategorive të tjera kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese të tyre. Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe

të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra.

- » *E drejta e formimit profesional.* Nëpunësi civil ka të drejtën të përmirësojë aftësitë profesionale, nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike, donatorë të huaj apo të ardhurat vetjake.
- » *E drejta e konsultimit.* Nëpunësi civil ka të drejtën të konsultohet, nëpërmjet sindikatave apo përfaqësuesve të nëpunësve civilë të institucionit, në vendimmarrjen për aktet ligjore dhe nënligjore, lidhur me marrëdhënien e shërbimit civil dhe kushtet e punës. Sindikata, ku nëpunësi është anëtar apo përfaqësuesit e nëpunësve civilë të institucionit, ku nëpunësi civil ushtron detyrën, konsultohet në marrjen e çdo vendimi individual, lidhur me një nëpunës civil të përfaqësuar prej saj.
- » *Kohëzgjatja e punës, lejet dhe pushimet.* Nëpunësi civil ka të drejtën për pushime vjetore të paguara, si dhe për pushime të tjera me apo pa pagesë.
- » *E drejta e informimit dhe ankimit.* Nëpunësi civil ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedimi administrativ dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e tij të shërbimit civil. Nëpunësi civil ka të drejtë të kontrollojë dosjen e tij të personelit dhe të kërkojë ndryshimin e të dhënave të saj. Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi, që i cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil.

USHTRIMI NR. 34	<p>Drejtori i nëpunëses civile X, (i njëjti kasus mund të trajtohet sipas qasjeve mbi orientimin seksual, pra drejtori-nëpunësi, drejtoresha-nëpunësja), ka filluar që herë pas here t'i bëjë komplimente si "...sa e bukur qenke bërë sot", ose, "...të shkoka shumë kjo veshja". Edhe pse nëpunësja fillimisht i ka gjetur komplimentet të këndshme dhe të pranueshme, me kalimin e javëve ajo kupton se përtej tyre, Drejtori gjen shkak dhe pretext që ta thërrasë në zyrë, me argumentin që të diskutojnë për punë. Nëpunësja ndjehet e shqetësuar. Ajo ndjehet e frikësuar për vendin e punës dhe ndërkohë dhe nën presionin e sjelljeve shqetësuese të Drejtorit</p>	<p>Nëpunësja civile, X, shefe sektori e kategorisë së ulët drejtuese, pranë një institucioni të pavarur prej 5 vitesh, konkurren për pozicionin e kategorisë së mesme "drejtoreshë drejtorie". Nga Komiteti i pranimit për ngritjen në detyrë i komunikohet se nuk është përzgjedhur, pasi nuk ka marrëdhënie sociale të kenaqshme me kolegët. Duke qenë se, sipas sistemit të pikëzimit, "gatishmëri pune në grup", si kriter kishte 10 pikë dhe ajo ishte vlerësuar me 2 pikë, kjo kishte sjellë për pasojë mospërzgjedhjen e saj për atë vend pune.</p> <p>Sipas nëpunëses, është vërtetë që ajo nuk shoqërohet "për kafe" me kolegë të tjerë, kjo pasi disa nga kolegët e shqetësojnë vazhdimisht me komente negative, por kur i kërkohen bashkëpunim dhe informacion për punën, ajo ka qenë gjithmonë e gatshme të ofrojë bashkëpunim.</p>
PYETJE	<p>A ndodhet nëpunësja përballë ngacmimit seksual? Cilat veprime mund të konsiderohen ngacmime seksuale²⁰⁷? Si mund të vepohet para rasteve të tilla? Cilat alternativa janë më të mirë? Duhet diskutuar avantazhet dhe disavantazhet e secilës. Listimi i argumenteve "pro" dhe "kundër" zgjidhjes së situatës, nëpërmjet rrugës ligjore të ankimit ose jashtë kësaj rruge</p>	<p>Si e shikoni situatën në fjalë? Sa realiste janë vlerësimet ndaj nëpunëses civile? A ka lidhje ky lloj motivi me stereotipet e shoqërisë? A është argument i bazuar në kriteret ligjore, mosshoqërimi social me kolegët?</p>
OBJEKTIVI	<p>Ndërgjegjësimi me përballjen me situata të tilla. Orientimi i nëpunësve të administratës publike drejt zgjidhjeve ligjore të rasteve të tilla.</p>	<p>Të dallohen diferencat në karakter dhe qasjet ndaj jetës sociale brenda marrëdhënieve të punës. Të kuptohet qëllimi në lidhje me kriterin e punësimit "aftësi komunikimi dhe punë në grup". Nëpunësit civilë të ballafaqohen me sjellje dhe veprime jo ligjore dhe të menaxhojnë elementët e viktimizimit. Të aftësohen me gjykim analizues dhe diskutimi, si dhe me njohje me kuadrin ligjor të punësimit të nëpunësit civil..</p>

207 Veprimet shqetësuese në kontekstin e ngacmimit seksual mund të jenë të ndryshme, në varësi të llojit të veprimit, sjelljes, qëndrimit, kohëzgjatjes, rrethanave, por mund të klasifikohen në: 1.kërkesa të shprehura ose të nënkuptuara për përfitime seksuale; 2. shprehje ekuivoqe me dy kuptime; 3. vlerësime verbale mbi trupin ose seksualitetin; 4. kërcënime, intimidime, për shkak të refuzimit të ngacmimit seksual; 5. batuta ose gjeste vulgare; 6. kontakte fizike jo të mirëpritura; 7. vëmendje ose propozime të padëshiruara; 8. shantazhe me qëllim përfitimi seksual; 9. ngacmime në ambientin e punës, me qëllim krijimin e një ambienti armiqësor, poshtëruës, edhe pa kërkuar specifikisht favore seksuale; 10. akte dhune seksuale. Për më tepër mund t'i referoheni, Manuale di comportamento da addotare in caso di molestie sessuali nei luoghi di lavoro, con annesso questionario per la raccolta dati sul fenomeno, Regione Siciliana [Manual mbi sjelljen, në rast të ngacmimit seksual në vendin e punës]; e disponueshme on line: http://www.regione.sicilia.it/presidenza/personale/n2/Sito_HTML/personale/Ultima%20versione%20del%20manuale.PDF, vizituar me datë 23.03.2016.

Nëpunësi civil ka qenë në punë në Ministrinë Y. Në janar të vitit 2005 ai u ka treguar tri kolegëve se kishte frikë mos ishte infektuar me virusin HIV, që më pas u konfirmua nga një test. Menjëherë pas këtij konfirmimi tri kolegët i dërguan letër titullarit të institucionit, që i bënë me dije se nëpunësi kishte virusin në fjalë dhe se duhej pushuar nga puna. Informacioni rreth statusit shëndetësor të nëpunësit filloi të qarkullonte në të gjithë institucionin, i cili kishte të punësuar rreth 70 punonjës. Staf i kërkonte pushimin nga puna të nëpunësit X. Titullari i institucionit ftoi një doktor profesionist që t'u shpjegonte nëpunësve mbi llojin e sëmundjes dhe masat që duhet të merreshin. Pas këtij takimi, ata i dërguan një letër titullarit ku i kërkonin pushimin nga puna të kolegut të tyre, me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre dhe të së drejtës për të punuar. Në këto kushte, institucioni u vu në lëvizje dhe u ndoq procedura e pushimit nga puna të nëpunësit civil X

Përshkruani se si do të konsiderohej nga autoritetet kompetente situata. Në veçanti, merrni parasysh pyetjet specifike: Për cilat të drejta të nëpunësit X mund të diskutohet në rastin konkret? A konkurrojnë këto të drejta me të drejtat e nëpunësve të tjerë? Nëse po, me cilat?

Rritje e ndërgjegjësimit të nëpunësve publikë për të drejtat e tyre. Kjo duhet të jetë në funksion të rritjes së kulturës së nëpunësve me paketën e të drejtave të njeriut, pjesë e së cilës janë..

9.3 NËPUNËSIT CIVIL DHE

URDHRAT E PALIGJSHËM²⁰⁸

Situatat kur urdhrat e paligjshëm jepen nga eprorët janë ndër më delikatet në punën e një nëpunësi civil.

Nëpunësi nuk është i detyruar të zbatojë menjëherë një urdhër të paligjshëm, por në rast të dyshimeve mbi paligjshmërinë, ai duhet të informojë menjëherë organet urdhërdhënëse apo hierarkike. Ligji për Nëpunësin Civil i ka dhënë rëndësi hierarkisë, duke e detyruar nëpunësin ta zbatojë urdhrin pasi është konfirmuar me shkrimin nga eprori, me përjashtim të rasteve kur urdhëri përbën vepër penale.²⁰⁹

208 Edhe në këtë nënçështje sikundër tek 9.2. [supra] i referohemi vetëm nëpunësve civilë, që janë në marrëdhënie punësimi bazuar mbi Ligjin për Nëpunësin Civil.

209 Neni 43 i Ligjit për Nëpunësin Civil, përcakton se: "1. Nëpunësi civil mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës në shërbimin civil. 2. Nëpunësi civil ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga eprorët hierarkikë, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit. 3. Nëse nëpunësi civil ka dyshime për paligjshmërinë e urdhrit të eprorit, ai nuk e zbaton urdhrin, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim. 4. Nëpunësi civil ka detyrimin ta zbatojë urdhrin me shkrim, sipas pikës 3 të këtij neni, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale".

<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">USHTRIMI NR. 37</p>	<p>» Komiteti i Pranimet për Lëvizjen Paralele (i përbërë nga 3 anëtarë) në shërbimin civil vlerëson X si person më të kualifikuar për pozicionin specialist pranë Drejtorisë së Studimeve në një institucion të pavarur administrativ, duke ndjekur procedurën e lëvizjes paralele nga i njëjti pozicion që ka patur në një institucion tjetër. Titullari, pasi njihet me emrin e fituesit, shprehet se nuk duhet t'i lejohet lëvizja paralele, pasi sipas informacioneve që ai kishte, është person politik, shprehet hapur kundër qeverisë si edhe ka marrë pjesë në mitingjet e opozitës.</p>
<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">PYETJE</p>	<p>» Cili parim mbizotron në rastin konkret, parimi i hierarkisë, apo parimi i ligjshmërisë? Si ndikon në marrëdhëniet e mëpasshme të punës dhe në klimën sociale të institucionit, e drejta e mosbindjes ndaj një urdhri jo në përputhje me ligjin, ose edhe anti-kushtetues/anti-ligjor, në raport me hierarkinë dhe llogaridhënien?</p>
<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">OBJEKTIVI</p>	<p>» Njohja e vështirësisë dhe përballjes me urdhrat e paligjshëm, ashtu si dhe dilemat mbi sjelljen në të tilla situata. Ndërgjegjëzimi për mënyrat e kundërshtimit të tyre. Njohja me kufijtë e respektimit të hierarkisë si vlerë administrative.</p>
<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">USHTRIMI NR. 38</p>	<p>» Një nëpunës civil, jurist i punësuar pranë Ministrisë X, nxjerr në media disa dokumente lidhur me menaxhimin e këtij institucioni. Sipas tij, sa herë ka tentuar të flasë brenda institucionit i është dhënë masë disiplinore. Edhe 3 masat disiplinore të marra i ka vënë në dispozicion të shtypit për botim, duke pretenduar se masat disiplinore i ka marrë si hakmarrje për shkak të kundërshtimit të tij ndaj disa procedurave administrative në kundërshtim me ligjin. Konkretisht, ai pretendon se disa licenca janë dhënë në konflikt interesi të Ministrit, dhe se buxhetit të shtetit i janë bërë dëme financiare</p>
<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">PYETJE</p>	<p>» Si mendoni ju, a veproi drejt nëpunësi? A jemi para detyrimit të tij për të folur, apo detyrimit të tij për të heshtur? Denoncimi në media, a është rruga e duhur e ndjekjes së kësaj çështjeje?</p>
<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">OBJEKTIVI</p>	<p>» Të njihen situatat komplekse kur konkurrojnë aspekte të ndryshme vlerash në administratën publike. Të fitohen njohuri për kufizimet e lirisë së shprehjes së nëpunësit publik si dhe nga ana tjetër dhe ndërgjegjësim me detyrimet ligjore për denoncim abuzimesh.</p>

9.4 PËRGJEGJËSIA E NËPUNËSIT PUBLIK PËR MOSRESPEKTIMIN E DETYRIMEVE LIGJORE DHE KUSHTETUESE

Nëpunësit civil kanë detyrimin të zbatojnë ligjin dhe të jenë në shërbim të popullit²¹⁰. Përveç këtij parimi të rëndësishëm, që nga viti 1999 ka një ligj për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore. Edhe GJEDNJ ka theksuar në këtë kontekst se:

“...një shtet demokratik ka të drejtë t’u kërkojë nëpunësve publikë të mbështesin parimet kushtetuese mbi të cilat ai vetë mbështetet...”²¹¹

Nëpunësit civil janë përgjegjës ndaj eprorëve, por edhe ndaj Kushtetutës, ligjit dhe interesit publik. Llogaridhënia ligjore apo kushtetuese ka lidhje me detyrimet e nëpunësve civil ndaj zbatimit të ligjit. Ata duhet të marrin përsipër të justifikojnë veprimet e tyre para organeve gjyqësore dhe t’i argumentojnë ato sipas Kushtetutës dhe ligjit.

Përgjegjësia e nëpunësve dhe organeve të tyre, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore, është detyrimi për të shpërblyer dëmin, që këto të fundit i kanë shkaktuar interesave të personave privatë në ushtrim e sipër të funksioneve të tyre publike²¹². Më poshtë po japim disa parashikime të këtij Ligji.

Cilat janë rastet e përgjegjësisë së organeve shtetërore?

- » kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme;
- » kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizike a juridike privatë;
- » kur, megjithatë kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, u shkaktojnë një dëm të pabarabartë subjekteve, të cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim;
- » kur, për shkak të mosfunksionimit të mjeteve teknike me të cilat organet e administratës shtetërore ushtrojnë veprimtarinë e tyre, persona fizike a juridike privatë cenohen në interesat e tyre të ligjshme;
- » kur u shkaktojnë një rrezik të vazhdueshëm personave fizike a juridike privatë .

Siç shihet, jo të gjithë këto veprime janë shkelje të të drejtave të njeriut, por megjithatë mund të passjellin përgjegjësinë për t’i shpërblyer personat, që janë dëmtuar.

Po nëpunësit publikë, a mbajnë përgjegjësi vetjake?

- » Në ushtrimin e funksioneve shtetërore, punonjësit e organeve të administratës shtetërore nuk përgjigjen për dëmet shkaktuar personave fizike a juridike private kur vërtetohet se ata kanë vepruar me keqbesim. Në këtë rast, organi shtetëror punëdhënës, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit, që ka paguar.

210 Neni 107/1 i Kushtetutës.

211 Çështja Vogt kundër Gjermanisë, aplikimi 17851/91, vendim i GJEDNJ i datës 2 shtator 1995.

212 Neni 2 i Ligjit për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore.

USHTRIMI NR. 39	<ul style="list-style-type: none"> » Shoqëria X është regjistruar si person juridik, dhe ushtron aktivitet privat. Për ushtrimin e kesaj veprimtarie, ky subjekt është licensuar në fushën e “Transmetimeve Toksore”. Me vendim administrativ Autoriteti Mbikqyrjes Audiovizive (AMA) ka bërë të pavlefshme licensën dhe e ka hequr atë si dhe është vendosur që ky televizion të ndërpresë menjëherë transmetimet,. Vendimi është botuar në fletoren zyrtare. Në zbatim të aktit administrativ ka dalë urdhëri “Për mbylljen e aktivitetit transmetues”, që është ekzekutuar nga Drejtoria e Pergjithshme Tatimeve. » Është pretenduar dhe provuar nga shoqëria se akti administrativ që ka zhvlerësuar licencën ka qenë i paligjshëm. Kjo shoqëri pretendon shpërblim demi për shkak të ndërprerjes së aktivitetit në mënyrë të paligjshme, si dhe dëmit të ardhur nga mospërmbushja e detyrimeve kontraktore me subjekte të ndryshme me objekt realizimin e reklamave nga ky televizion.
PYETJE	<ul style="list-style-type: none"> » Si duhet trajtuar ky rast? A jemi para përgjegjësisë jashtëkontraktore? A ka të drejtë shoqëria X? Ndaj kujt duhet të kërkojë dëmshpërblim dhe për çfarë?
OBJEKTIVI	<ul style="list-style-type: none"> » Familjarizim me rregullimin e situatave që passjellin dëm; përfitim i njohurive për mbajtjen përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga administrata publike..



X. Përfundime, përmbledhje dhe 10 këshilla praktike për nëpunësit publikë

Në çdo qeveri, ekzekutivi dhe administrata publike janë më shumë të përqendruar në realizimin e objektivave dhe politikave të caktuara me interes të përgjithshëm sesa me kërkesat dhe standardet që lidhen me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Megjithatë, shoqëria e re demokratike, dhe modernizimi i administratës publike shqiptare, në drejtim të Bashkimit Europian, kërkojnë jo vetëm familiarizëm me këto kërkesa dhe standarde por edhe realizimin e tyre si dhe zhvillimin e kulturës së të drejtave të njeriut.

Çdo ditë, individët në publikun e gjerë, si dhe nëpunësit e administratës, përballen me veprime, procese dhe vendime administrative, të cilat në jetën e përditshme, i diktojnë cilësinë e jetës, p.sh. një taksë e re, një dhënie ose refuzim licence, vonesa në procedurat e pensionit, një ushtrim aktiviteti privat, që ndikon në cilësinë e mjedisit dhe mijëra veprime të tjera. Është e padiskutueshme, që të drejtat dhe liritë themelore të njerëzve duhet të jenë në qendër të veprimtarisë dhe të trajtohen me rëndësi të veçantë.

Për rrjedhojë, familjarizimi me *Manualin Shpjegues për Administratën Publike* ka për qëllim edukimin e administratës publike me nocionet kryesore të të drejtave të njeriut, me një

fokus të veçantë në ato të drejta të individit, të cilat mund të preken më shpesh nga veprimtaria e përditshme e nëpunësve të administratës publike.

Nuk mjafton vetëm pajisja e juristëve me dije ligjore dhe kushtetuese. Çdo nëpunësi publik duhet të ketë njohuri të mjaftueshme, në varësi të specifikës së funksionit, me qëllim përmirësimin e ushtrimit të veprimtarisë administrative.

Manuali synon të shërbejë si udhërrëfyes për administratën publike, e cila është zotuar, me Ligjin e ri për Shërbimin Civil, të marrë hapa për trajnimin e punonjësve të saj me *njohuri për të drejtat e njeriut*, me qëllim shmangien e shkeljeve kushtetuese në drejtim të këtyre të drejtave.

Në rast të mungesës së këtij lloj trajnimi, organet publike nuk do të përparojnë në realizimin e shtetit të së drejtës. Sigurisht, kjo varet edhe nga kultura politike, juridike, zhvillimi ekonomik dhe shoqëror e të tjerë faktorë të vendeve të caktuara. Këto faktorë shpjegojnë dhe ndryshimet mes vendeve me demokraci të konsoliduar nga vendet me demokraci në zhvillim, edhe pse në nivelin juridiko-formal mund të jenë palë e të njëjtave konventa dhe akteve ndërkombëtare, siç është Shqipëria.

Në këtë kontekst, mund të kuptohet dhe sfida

e administratës publike shqiptare në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Gjithsesi, sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutën shqiptare si dhe akte të ndryshme juridike, dhe shoqërimi me masat e ndryshme për vënien e tyre në jetë, do të çojë në përmirësimin e vazhdueshëm dhe me kalimin e kohës në rritjen e standardeve në këtë fushë.

Së fundmi, mund të themi se ky Manual është shkruar dhe redaktuar me sensin e një misioni, pasi besojmë se roli që ai mund të ketë në përmirësimin e duhur të veprimtarisë së administratës publike, me njohuritë dhe kuptimin më të mirë të të drejtave të njeriut, do të kontribuojë në vendosjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në qendër të veprimtarisë së përditshme të administratës publike shqiptare.

10 këshilla praktike për nëpunësit publikë

Të drejtat e njeriut nuk janë për “të tjerët”, por për të gjithë ne. Ju sugjerojmë që këshillat që vijojnë, të merren parasysh në jetën e përditshme administrative në shërbim të vetes dhe publikut të gjerë. . Ato gjithashtu mund të shërbejnë si një përmbledhje e parimeve të shtjelluara në Manual:

Neni 1

Dinjiteti njerëzor

Dinjiteti njerëzor nuk duhet të dhunohet. Ai duhet respektuar dhe duhet mbrojtur. Kushdo ka të drejtë për respektim të integritetit të tij mendor dhe fizik.

Neni 2

Paanshmëria, ndershmëria dhe pavarësia

Të jeni të paanshëm, të drejtë, të ndershëm dhe të pavarur nga çdo influencë me përjashtim të ligjit, në ushtrimin e funksioneve publike.

Neni 3

Mosabuzimi me pushtetin

Të ushtroni pushtetin vetëm për qëllimet për të cilat ju është dhënë, duke shmangur përdorimin e tij për qëllime të cilat nuk kanë bazë ligjore, apo nuk janë të motivuara nga ndonjë interes publik.

Neni 4

Paanësia politike

Të mos bëheni pjesë e partizanizmit politik, duke lejuar që në ushtrimin e detyrës të përdoren për qëllime politike të papërshtatshme dhe të palejuara nga ligji.

Neni 5

Ligjshmëria

Të zbatoni me korrektësi të gjitha rregullat dhe procedurat që rrjedhin nga legjislacioni i detyrueshëm për zbatim në funksionin për të cilin jeni përgjegjës.

Neni 6

Mosdiskriminimi

Të siguronit respektimin e parimit të barazisë së trajtimit, ose të diferencimit në trajtim nëse justifikohet nga një veçori objektive, në trajtimin e kërkesave si dhe në marrjen e vendimeve.

Neni 7

Ekonomizimi

Të menaxhoni gjatë ushtrimit të detyrës pronën publike, si burimet financiare, infrastrukurore, materiale, me qëllim që, të përdoren me efektivitet, efikasitet dhe ekonomizim.

Neni 8

Pritshmëritë e ligjshme

Të respektoni pritshmëritë e arsyeshme dhe të ligjshme që publiku mund të ketë, bazuar në mënyrën se si keni vepruar ju apo si organi administrativ ka vepruar në të shkuarën në raste të të njëjtës situatë ose të ngjashme.

Neni 9

Mirësjellja

Të jeni korrekt, i sjellshëm, me mendje hapur dhe i aksesueshëm në raport me publikun. Kur i përgjigjeni korrespondencës, thirrjeve telefonike dhe postës elektronike, përpuni të jeni sa më ndihmues dhe t'i jepni përgjigje pyetjeve që ju janë bërë në mënyrë sa më të plotë e të saktë që të mundet. Nëse ndodh një gabim që dëmton të drejtat apo interesat e individit, kërkoni ndjesë për këtë gjë dhe përpuni të korrigjoni efektet negative.

Neni 10

Bashkëveprimi dhe bashkëpunimi

Të bashkëpunoni me kolegët dhe strukturat e brendshme të institucionit, pasi jeni pjesë e një institucioni dhe e një organi, që e zhvillon veprimtarinë si një i tërë, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar.

213 Mbështetur dhe frymëzuar nga Rekomandimi nr.R (2000) 10 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare "Mbi kodin e sjelljes të nëpunësve publikë", i detyrueshëm për zbatim nga nëpunësit publik të vendeve anëtare të KIE.

Referenca

Legjislacion

- » Kushtetuta
- » Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)
- » Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)
- » Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Civile dhe Politike (KDCP)
- » Konventa Ndërkombëtare e Eliminimit të të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (KEFDR)
- » Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK)
- » Konventa Ndërkombëtare kundër të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW)
- » Konventa e Personave me Aftësi të Kufizuar (KPAK)
- » Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF)
- » Ligji nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”
- » Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (ndryshuar me ligjin nr.178/2014)
- » Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- » Ligji nr.9887, datë 10.03.2008, (ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 si dhe me ligjin 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)
- » Ligji nr.10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”
- » Ligji nr.8510, datë 15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” ndryshuar me Ligjin nr.10005, datë 23.10.2008
- » Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- » Ligji nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”
- » Ligji nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar
- » Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.247, datë 20.03.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020”

Vendime të Gjykatës Kushtetuese

- » Vendimi nr.65, datë 10.12.1999
- » Vendimi nr.38, datë 23.12. 2003
- » Vendimi nr.16, datë 11.11.2004
- » Vendimi nr.14, datë 05.07.2005
- » Vendimi nr.30, datë 01.12.2005
- » Vendimi nr.20, datë 11.07. 2006
- » Vendimi nr.20, datë 04.05. 2007
- » Vendimi nr.35, datë 10.10.2007
- » Vendimi nr.40, datë 16.11.2007
- » Vendimi nr. 9, datë 19.03.2008
- » Vendimi nr.10, datë 19.03. 2008
- » Vendimi nr.14, datë 03.06.2009
- » Vendimi nr.13, datë 14.04.2010
- » Vendimi nr.14, datë 15.04.2010
- » Vendimi nr .2, datë 01.02.2011
- » Vendimi nr.13, datë 22.04.2011
- » Vendim nr. 1, datë 06.02. 2013
- » Vendim nr. 4, datë 05. 02. 2014

Vendime të GJEDNJ

- » Belgian Linguistic, aplikimet nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63, 2126/64, vendim i vitit 1968
- » Kjeldsen, Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës, vendim i datës 7 dhjetor 1976
- » Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 22 tetor 1981
- » Campbell dhe Cosans kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 25 shkurt 1982
- » Glasenapp kundër Gjermanisë, aplikimi nr. 9228/80, vendim i datës 28 gusht 1986
- » Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 2 gusht 1994
- » Keegan kundër Irlandës, vendimi i datës 26 maj 1994
- » Vogt kundër Gjermanisë, vendim i datës 2 shtator 1995
- » Hatton dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikim 36022/97, vendim i datës 2 tetor 2001
- » Z. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 29392/95, vendim i datës 10 maj 2001
- » Price kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 33394/96, vendim i datës 10 korrik 2001
- » Sylvester kundër Austrisë, nr. 36812/97, vendim i datës 24 prill 2003
- » Leyla Dahin kundër Turqisë, aplikimi nr. 44774/98, vendim i datës 10 nëntor 2005
- » Sdrůženi Jihoceské Matky kundër Republikës Çeke, vendim i datës 10 korrik 2006
- » Panteleyenکو kundër Ukrainës, vendim i datës 29 qershor 2006
- » Bajrami kundër Shqipërisë, aplikimi nr. 35853/04, vendim i datës 12 dhjetor 2006
- » Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, aplikimi nr.38222/02, vendim i datës 13 nëntor 2007
- » Vilho Eskelinen kundër Finlandës, aplikimi nr. 63235/00, vendim i datës 19 prill 2007
- » S. dhe Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikim nr. 30562/04 dhe nr. 30566/04, vendim i datës 4 dhjetor 2008
- » Hamzaraj kundër Shqipërisë, aplikimi nr.45264/04, vendim i datës 3 shkurt 2009
- » Nuri kundër Shqipërisë, vendim i datës 3 shkurt 2009
- » K.H. dhe të tjerë kundër Slovakisë, aplikimi nr. 32881/04, vendim i datës 28 prill 2009
- » Kiyutin kundër Rosisë, vendim i datës 10 mars 2011
- » Khelili kundër Zvicrës, vendim i datës 18 tetor 2011
- » Center of Legal Resources në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë, vendim i datës 17 korrik, 2014
- » Halil Adem Hasan kundër Bullgarisë, vendim i datës 10 mars 2015
- » Brumarescu kundër Rumanisë, vendim i datës 12 janar 2016

Vendime të GJED

- » Costeja kundër Google, vendimi nr.131/12, i maj 2014
- » Komisioni i Komunitetit Ekonomik Europian kundër Dukës së Luksemburgut, vendim i datës 2 korrik 1996

- » United Nations Declaration on the Right to Development [Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën për t'u zhvilluar], 1986
- » "Governance and Development", [Qeverisja dhe zhvillimi], publikim i Bankës Botërore, ISBN 0-8213-2094-7 (1992)
- » Vjena Declaration and Plan of Action [Deklarata e Vjenës dhe Plani i Veprimit], miratuar nga Konferenca Botërore e të Drejtave të Njeriut, me 25 qershor, 1993
- » Government for Sustainable Human Development , [Qeverisja për zhvillim të qëndrueshëm njerëzor], Dokument i UNDP, janar 1997
- » Resolution 66/137 "United Nations Declaration on Human Rights and Education and Training" [Rezoluta 66/137, "Edukimi dhe trajnime me të drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara"], e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e 19 dhjetorit 2011
- » World Programme for Human Rights Education [Plani Veprues i Kombeve të Bashkuara për Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut (2010-2014)]
- » Charter on Education for Democratic Citizenship and Human Rights Education [Karta Evropiane mbi Edukimin me Qytetarinë dhe të Drejtat e Njeriut] Këshilli i Europës, miratuar me Rekomandimin CM/Rec (2010) 7.
- » Communication from the Commission of 25 July 2001, "European governance - A white paper", Komunikatë e Komisionit Evropian, 25 korrik 2001 "Qeverisja Evropiane-libri i bardhë", Gazeta Zyrtare C 287, e datës 12 tetor 2001
- » Constitution of World Health Organization, [Kushtetuta e miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetsisë], New York, 19 qershor - 22 korrik 1946
- » Recommendation no.R (2000) 10 of the Committee of Ministers to Member States on Codes of Conduct for Public Officials, [Rekomandimi nr.R (2000) 10 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare "Mbi Kodin e Sjelljes të Nëpunësve Publikë"]
- » The European Code of Good Administrative Behaviour, (Kodi Evropian i Sjelljes së Mirë Administrative), Mars 2002.
- » The Limburg Principles on the implementation of the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights [Parimet e Limburgut mbi zbatimin e Konventës Ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. (UN doc. e/cn.4/1987/17)]
- » A new space for public administrations and services of general interest in an Enlarged Union" [Një hapësirë e re për administratat publike dhe shërbimet e interesit të përgjithshëm në një Bashkim Evropian të zgjeruar], Studim për Ministrat Përgjegjes të Administratës Publike të vendeve anëtarë të BE, Luxembourg, 8 qershor 2005
- » Integrity Framework [Kudri i veprimtarisë mbi integritetin], 2005, Dokument i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim

- » Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, financuar nga Fondacioni Konrad Adenauer, 2010
- » Elsa Toska, “Kontrolli mbi veprimtarinë administrative sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”, ISBN 9928-04-157-1, Shtator 2013.
- » Asbjorn Eide, Catarina Krause, Allan Rosas, “Economic social and cultural rights, second revised edition, [Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore], shtëpia botuese Martinuss Nijhoff Publishers, 2001
- » Iam L.Richter, Frances Burke, “Combating corruption, encouraging ethics” botim i dytë, [Të luftosh korrupsionin, të inkurajosh etikën- një udhëzues praktik për përdorimin e Etikës], botuesi Rowman & Littlefield Publishers, Inc. 2007
- » Komentari i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, së bashku me praktikën e Komisionerit për të drejtën e informimit, botim i Qendrës Res publica, maj 2015
- » Fjalor i Shqipes së Sotme, Botimi i dytë i ripunuar, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botimet Toena, Tiranë, 2002
- » Black’s Law Dictionary, Seventh Edition (Fjalor mbi termat ligjorë), St. Paul, Minnesota USA 1999
- » David H. Rosenbloom/James D.Carroll “Toward Constitutional Competence - A casebook for public administrators” [Një udhëzues praktik për administratorët publikë], 1990, botuesi Prentice Hall Inc, New Jersey 07632, ISBN 0-13-926122-2
- » Henk Bruning, “Finding inspiration and integrity in public services, (...) To be Honest”, [Të gësh frymëzim dhe integritet në shërbimet publike], botuar në Spanjë nga Caslon S.L. – Madrid, 2014
- » George Berkley & jon Rouse “The craft of Public administration”, [Zanati i administratës publike], eighth edition, ISBN 0-697-38590-6, The McGraw – Hill Companies, 2000
- » Compass: “Manual for human rights education with young pople” (Manual mbi edukimin e të rinjve për të drejtat e njeriut), botim i rishikuar dhe përditësuar, Këshilli i Europës, tetor, 2012
- » “Understanding Human Rights”, Manual on Human Rights Education, A contribution to the Human Security Network on the initiative of the Federal Ministry for European and International Affairs Austria [Të kuptosh të drejtat e njeriut, Manual mbi Edukimin për të Drejtat e Njeriut], financuar nga Austrian Development Agency, 2012
- » Manual of Human Rights in Theory and Practice for Social Workers, OSCE Mission to Bosnia and Hercegovina [Manual mbi të Drejtat e Njeriut, në Teori dhe Praktikë, Bosnjë – Hercegovinë], 2010
- » Training Manual on Human Rights Monitoring, Professional Training Series, no.7, Office of the High Commissioner for Human Rights, UN, 2001[Manual Trajnimi mbi Monitorimin e të Drejtave të Njeriut]
- » Manual on Human Rights Reporting, under six major international human rights instruments, ISBN 92- 1- 100752-6, Office of the High Commissioner for Human Rights (Manual mbi Raportimin për të Drejtat e Njeriut) 1997
- » Handbook on European Non –discrimination Law, European Union Agency for Fundamental Rights, Council of Europe, [Udhëzues mbi Legjislacionin European të Antidiskriminimit] 2010
- » “Manual on Hate Speech” [Manual mbi Gjuhën e Urrejtjes], Anne Weber, botim i Këshillit të Europës, ISBN 978-92-871-6613-5, 2009
- » The right to property, Human Rights Handbooks no.4, A guide fo the implementation of article no.1, Protocol no. 1 to the European Convention of Human Rights, [Manual i të Drejtave të Njeriut nr.4, Një udhëzues për zbatimin e nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ], Këshilli i Europës 2001
- » Handbook on Europian Data Protection Law, [Manual mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale], European Union Agency for Fundamental Rights, Council of Europe, 2014
- » Ethics training for public officials, [Trajnime të zyrtarëve publikë mbi etikën] OECD, ACN, SIGMA, mars 2013
- » Manuale di comportamento da addotare in caso di molestie sessuali nei luoghi di lavoro, con annesso questionario per la raccolta dati sul fenomeno, [Manual mbi sjelljen, në rast të ngacmimit seksual në vendin e punës], Regione Siciliana, 2009

Referenca

<p>KNDCP</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Për tekstin e plotë: http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/a_ccpr.htm. » Për veprimtarinë e Komitetit: http://www.unhchr.ch/html/menu2/6/hrc.htm. » Për jurisprudencën: http://www.unhchr.ch. » Për statusin e ratifikimit të instrumenteve të OKB: http://www.unhchr.ch/pdf/report.pdf.
<p>KNDESK</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Për tekstin e plotë: http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/a_ceschr.htm. » Për materialet Komitetit: http://www.unhchr.ch/html/menu2/6/ceschr.htm » Për statusin e ratifikimit të instrumenteve të OKB: http://www.unhchr.ch/pdf/report.pdf.
<p>KNFDR</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Për tekstin e plotë: http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/d_icerd.htm » Për materialet e Komitetit: http://www.unhchr.ch/tbs/doc.nsf/FramePage/TypeJurisprudence?OpenDocument » Për statusin e ratifikimit të instrumenteve të OKB: http://www.unhchr.ch/pdf/report.pdf.
<p>CEDAW</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Për tekstin e plotë: http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm » Për materialet e Komitetit : http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/committee.htm » Për tekstin e protokollit shtesë: http://www.ohchr.org/english/law/cedaw-one.htm » Për statusin e ratifikimit: http://www.unhchr.ch/pdf/report.pdf. » Për statusin e ratifikimit të protokollit shtesë: http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/sigop.htm
<p>KDF</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Për tekstin e plotë: http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/k2crc.htm » Për materialet e Komitetit: http://www.unhchr.ch/html/menu2/6/crc/ » Për tekstin e protokollit mbi procedurat e ankimit: http://www.ohchr.org/EN/HR-Bodies/TBPetitions/Pages/HRTBPetitions.aspx

KEDNJ	<ul style="list-style-type: none"> » Për tekstin e plotë: http://conventions.coe.int/treaty/en/Treaties/Html/005.htm » Për GJEDNJ: http://www.echr.coe.int » Për jurisprudencën e GJEDNJ: http://www.echr.coe.int/Eng/Judgments.htm » Për statusin e ratifikimit: http://www.echr.coe.int/Eng/EDocs/DatesOfRatifications.html » Për Këshillin e Europës: www.coe.int
Bashkimi Evropian	<ul style="list-style-type: none"> » Për informacionet e përgjithshëm për Bashkimin Evropian: http://europa.eu.int » Për materialet ligjore: http://curia.eu.int/en/index.htm » Për aktivitetet mbi të drejtat e njeriut të BE: http://europa.eu.int/pol/rights/index_en.htm » Portali i ligjeve të BE: http://europa.eu.int/eur-lex/en/index.html » Për tekstin e Kartës themelore të të drejtave të njeriut të BE: http://www.europarl.eu.int/charter/default_en.htm
Institucionet Kombëtare	<ul style="list-style-type: none"> » http://www.avokatipopullit.gov.al/ (Avokati i Popullit) » http://www.idp.al/index.php/en/ (Komisioneri i të Drejtës për Informim dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale) » http://www.kmd.al/ (Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi) » http://www.gjk.gov.al/ (Gjykata Kushtetuese) » http://www.punetejashtme.gov.al/al/dokumenta/konventa-dhe-raporte-per-te-drejtat-e-njeriut (faqja zyrtare e Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë, mbi konventat dhe instrumentet ndërkombëtare)

Përkufizime

Më poshtë po prezantojmë disa terma dhe koncepte të selektuara si definicione nga burime të ndryshme, me kuptimin që janë përdorur në këtë Manual, të cilat mund të jenë ndihmuese dhe orientuese për nëpunësit civilë, si me qëllim që ta kuptojnë Manualin më mirë, por ashtu edhe për t'u fokusuar në disa terma, koncepte dhe parime kyce në veprimtarinë e tyre të përditshme administrative.

DINJITET - 1. Tërësia e vlerave morale të njeriut a të një grupi njerëzish; vetëdija e njeriut për këto vlera e për të drejtat e veta në shoqëri dhe nderimi për vetveten²¹⁴; - 2. Trajtimi i njeriut nga pushteti shtetëror kur zbaton ligjin dhe gjatë këtij procesi prek dinjitetin njerëzor, duhet konsideruar si shprehje, përçmim ndaj vlerës që përfaqëson njeriu falë personalitetit të tij, d.m.th në këtë kuptim një trajtim përçmues²¹⁵.

RESPEKT- Nderimi që kemi për dikë²¹⁶.

TË DREJTAT CIVILE - Përfshin kategorinë e të drejtave dhe lirive që mbron individët nga

veprimet e organeve shtetërore dhe siguron aftësinë e tyre për të qenë pjesmarrës në jetën sociale të shoqërisë, pa u diskriminuar dhe pa u detyruar²¹⁷.

TË DREJTAT POLITIKE - Përfshin kategorinë e të drejtave të individëve për të qenë pjesmarrës në jetën politike të komunitetit të tyre ose të shoqërisë²¹⁸.

TË DREJTAT EKONOMIKE - Përfshin kategorinë e të drejtave të lidhura me prodhimin, zhvillimin dhe menaxhimin e nevojave për të jetuar²¹⁹.

TË DREJTAT SOCIALE - Përfshin kategorinë e të drejtave të nevojshme për pjesmarrje të plotë në jetën e shoqërisë²²⁰.

TË DREJTAT KULTURORE - Përfshin kategorinë e të drejtave të gjithkujt të ruajë identitetin dhe zhvillimin e tij kulturor²²¹.

214 Fjalor i Shqipërisë së Sotme, Botimi i dytë i ripunuar, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botimet Toena, 2002, Tiranë, fq.241.

215 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, nr. 30,1 Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, Fondacioni Konrad Adenauer, 2010, fq.64.

216 Black's Law Dictionary, Seventh Edition, St.Paul, Minnesota USA (Fjalor Mbi Termet Ligjorë), 1999, fq.1103.

217 Compass: "Manual for human rights education with young people" (Manual mbi edukimin e të rinjve për të drejtat e njeriut), botim i rishikuar dhe përditësuar, Këshilli i Europës, tetor, 2012, fq.620.

218 Ibid, fq.623.

219 "Understanding Human Rights", Manual on Human Rights Education, A contribution to the Human Security Network on the initiative of the Federal Ministry for European and International Affairs Austria (Të kuptosh të drejtat e njeriut, Manula mbi Edukimin për të Drejtat e Njeriut), financuar nga Austrian Development Agency, 2012, fq. 541.

220 Ibid, fq.541.

221 Compass: "Manual for human rights education with young people" (Manual mbi edukimin e të rinjve për të drejtat e njeriut), botim i rishikuar dhe përditësuar, Këshilli i Europës, tetor, 2012, Fq.621.

E DREJTA PËR ZHVILLIM - E drejta e patjetërsueshme e çdo personi dhe e të gjithëve për të kontribuar dhe për të marrë pjesë dhe për të gëzuar zhvillimin ekonomik, social, kulturor, dhe politik, në mënyrë që të drejtat dhe liritë themelore të mund të realizohen plotësisht²²².

KEQADMINISTRIM - Menaxhim me të meta, sidomos në të vepruarit në cilësinë si zyrtar.²²³

SJELLJE JO E DUHUR - Shkelje e detyrës, sjellje e papërshtatshme apo e paligjshme²²⁴.

QEVERISJA - Ushtrim autoriteti nga pikëpamja ekonomike, politike, administrative, për të menaxhuar çështjet kombëtare në të gjitha nivelet. Kjo përfshin mekanizma, procese, institucione, nëpërmjet të cilave individët dhe grupet artikulojnë interesat e tyre, ushtrojnë të drejtat ligjore, plotësojnë detyrimet dhe negociojnë diferencat mes tyre.²²⁵

MIRËQEVERISJE - Përfshin mes të tjerash edhe pjesëmarrje, transparencë dhe llogaridhënie. Është gjithashtu barazi dhe efikasitet. Dhe promovon shtetin e së drejtës.²²⁶

KEQQEVERISJE - Dështim për të ndarë qartësisht çfarë është publike dhe çfarë është

private, dhe për rrjedhojë një tendencë për të devijuar burimet publike drejt përfitimeve private; dështim për të krijuar një kuadër ligjor me parashikueshmëri dhe favorizim të sjelljeve qeveritare arbitrare; rregulla, norma, kërkesa licencimi të tepërta, të cilat pengojnë funksionimin e tregut; prioritete jo konsistente me zhvillimin, të cilat rezultojnë në alokim të gabuar resursesh; vendimmarrje jo transparente²²⁷.

RATIFIKIM - nënkupton aktin me të cilin Kuvendi Popullor ose Presidenti i Republikës jep miratimin përfundimtar për një traktat ose marrëveshje ndërkombëtare, dypalëshe ose shumëpalëshe, të nënshkruar nga Republika e Shqipërisë²²⁸.

ADERIM - nënkupton aktin me të cilin Kuvendi Popullor ose Presidenti i Republikës jep miratimin që Republika e Shqipërisë të jetë palë në një traktat ose marrëveshje ndërkombëtare, e cila nuk është nënshkruar prej saj²²⁹.

“INSTITUCION I ADMINISTRATËS SHTETËRORE” - Në kuptim të Ligjit për Nëpunësin Civil, është aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit.

“INSTITUCION I PAVARUR” - Në kuptim të Ligjit për Nëpunësin Civil është administrata e Kuvendit, e Presidentit, e pushtetit vendor, e Gjykatës Kushtetuese, e Gjykatës së Lartë, e Prokurorisë dhe çdo institucion i pavarur,

222 The UN Declaration on the Right to Development of 1986 (Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën për zhvillim), (neni 1), e disponueshme online: <http://www.un.org/documents/ga/res/41/a41r128.htm>

223 Black's Law Dictionary, Seventh Edition, St. Paul, Minnesota USA (Fjalor mbi termat ligjore, Publikimi i shtatë), 1999, fq.967.

224 Ibid, fq.1013.

225 “Governance for Sustainable Human Development”, (Qeverisja për Zhvillim të Qëndrueshëm), Dokument i UNDP, Janar 1997, fq.12, e disponueshme online: <http://www.pogar.org/publications/other/undp/governance/undppolicydoc97-e.pdf>.

226 “Governance for Sustainable Human Development”, (Qeverisja për Zhvillim të Qëndrueshëm) Dokument i UNDP, janar 1997, fq. 12, e disponueshme online: <http://www.pogar.org/publications/other/undp/governance/undppolicydoc97-e.pdf>.

227 “Governance and Development, World Bank” [Qeverisja dhe zhvillimi, Banka Botërore], publikim i Bankës Botërore, ISBN 0-8213-2094-7 (prill 1992), fq.9.

228 Neni 2/b i Ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.

229 Ibid, neni 2/c.

i parashikuar në Kushtetutë apo i krijuar me ligj dhe që i raporton Kuvendit, përfshirë degët e tyre territoriale.

“NËPUNËS CIVIL” - Në kuptim të Ligjit për Nëpunësin Civil, është personi që kryen funksionin për ushtrimin e autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

“NJËSI PUBLIKE DIREKTE SHËRBIMI” - Në kuptim të Ligjit për Nëpunësin Civil, është njësi administrative që kryen drejtpërdrejt për qytetarët shërbimet publike të arsimit parauniversitar e universitar, kujdesit shëndetësor, kulturës, sportit, artit, ndihmës sociale dhe shërbimet e tjera shoqërore.

“NËPUNËS I ADMINISTRATËS PUBLIKE” - Në kuptim të Ligjit për Etikën, janë të gjithë personat e punësuar pranë një institucioni të administratës publike.

“ADMINISTRIMI PUBLIK” - Koncept i vështirë për t’u përkufizuar dhe shpesh herë i hapur për mënyra të ndryshme interpretimi, megjithatë i referohet veprimtarive të administruara nga shteti për qëllime publike. Mund të përkufizohet si procesi i ballafaqimit dhe zbatimit të vlerave të ndryshme në një shoqëri komplekse dhe vazhdimisht në lëvizje dhe dinamikë, që luan rol thelbësor në jetën e përditshme të të gjithë qytetarëve²³⁰.

230 George Berkley & Jon Rouse “The craft of Public Administration,” [Zanati i administratës publike], eighth edition, ISBN 0-697-38590-6, The McGraw - Hill Companies, 2000, fq.2.

“ADMINISTRATOR PUBLIK”- Ky term mund të ketë kuptime të ndryshme në varësi të sistemeve dhe modeleve ligjore të përzgjedhura. Në kuptimin e parë dhe të gjerë është çdo individ i punësuar në administratë publike dhe që menaxhon për llogari të administratës, asete, burime dhe të mira publike, si; financa, prona, materiale infrastrukturore, deri tek letrat, fotokopjet, bojrat, etj, (*sensu latu*), ndërsa në kuptimin e dytë dhe të ngushtë në varësi të sistemit ligjor përkatës, përdoret si term për një person të caktuar si administrator ligjor i pronave dhe shoqërive aksionere shtetërore, ose administrator i caktuar nga shteti për prona e pasuri private, nën kujdesin e shtetit, deri në një periudhë të caktuar, ose për një qëllim të caktuar. (*strictu sensu*).²³¹

“ORGAN PUBLIK” - Në kuptimin e KPA, është: “1. çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; 2 çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; 3. çdo organ i Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, 4. çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike”.

“PROCEDURË ADMINISTRATIVE” - Në kuptimin e KPA, është veprimtaria e një organi publik, me qëllim përgatitjen dhe miratimin e

231 David H. Rosenbloom/James D.Carroll “Toward Constitutional Competence - A casebook for public administrators”, (Drejt njohurive kushtetuese - një udhëzues për administratorët publikë) 1990, Prentice Hall Inc, New Jersey 07632, ISBN 0-13-926122-2, si dhe George Berkley & Jon Rouse “The craft of Public Administration” [Zanati i administratës publike], eighth edition, ISBN 0-697-38590-6, The McGraw - Hill Companies, 2000, fq.2.

veprimeve konkrete administrative, ekzekutimin e tyre dhe rishikimin e tyre me mjete ligjore administrative.

“VEPRIM ADMINISTRATIV” - Në kuptimin e KPA është akti administrativ, kontrata administrative dhe çdo veprim tjetër administrativ.

“VEPRIM TJETËR ADMINISTRATIV” - Në kuptimin e KPA, është çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, që nuk plotëson kriteret për të qenë akt administrativ apo kontratë administrative dhe që sjell pasoja juridike për të drejtat subjektive dhe interesat legjitimë.

“VEPRIMTARI ADMINISTRATIVE” - Në kuptimin e KPA, është tërësia e akteve dhe veprimeve, që përbëjnë dhe shprehin vullnetin e administratës publike, si dhe ekzekutimin e vullnetit.

“ORGANET E LARTA TË ADMINISTRATËS SHETËRORE” - Në kuptimin e Ligjit për Administratën Shtetërore, Kryeministri dhe ministrat janë organet e larta të administratës shtetërore.

“INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHETËRORE”- Në kuptimin e Ligjit për Administratën Shtetërore, Administrata shtetërore përbëhet nga këto *institucione*:

- a) Kryeministria;
- b) ministrinë;
- c) institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave; ç) njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve;
- d) agjencitë autonome;
- dh) administrata e prefektit.

“PARIMI I UNITETIT DHE HIERARKISË”

- Në kuptimin e Ligjit për Administratën Shtetërore, do të thotë që, administrata shtetërore organizohet në mënyrë të atillë që çdo organ, institucion apo njësi administrative, është në varësinë dhe i raporton një organi, institucioni apo njësie administrative, eprorë.

“PARIMI I LLOGARIDHËNIES” - Në kuptimin e Ligjit për Administratën Shtetërore, do të thotë që, çdo organ, institucion apo njësi administrative i nënshtrohet drejtimit dhe mbikëqyrjes nga organi epror përkatës, si për veprimtarinë e vet, ashtu edhe për atë të organeve, institucioneve apo njësive administrative vartëse.

“PARIMI I DEKONCENTRIMIT” - Në kuptimin e Ligjit për Administratën Shtetërore, do të kuptohet si, kryerja e funksioneve administrative, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me personat privatë, organizohet për t’u kryer sa më afër tyre, me qëllim lehtësimin e aksesit të tyre në informacion, në shërbimet publike, si dhe një pjesëmarrjeje të përshtatshme në procedimin administrativ, sipas ligjit.

“PARIMI I QARTËSISË” - Në kuptimin e Ligjit për Administratën Shtetërore, do të thotë që, në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë, ndarja dhe caktimi i funksioneve dhe detyrave administrative, ndërmjet organeve, institucioneve dhe njësive administrative, duhet të jenë specifike, të shmangin mbivendosjen, të jenë transparente dhe të bëhen publike në mënyrë të përshtatshme.

“PARIMI I EKONOMISË, EFIÇENCES DHE EFEKTIVITETIT” - Në kuptimin e Ligjit për Administratën Shtetërore, do të thotë që cak-

timi dhe shpërndarja e përgjegjësisë, si dhe organizimi i administratës shtetërore duhet të sigurojnë efektivitetin në kryerjen e funksioneve dhe detyrave, eficientën në arritjen e objektivave të politikave të miratuara, si dhe ekonominë në përdorimin e të mirave dhe fondeve publike.

“PARIMI I BASHKËPUNIMIT” - Në kuptimin e Ligjit për Administratën Shtetërore, do të thotë që, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucionet e pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin.

Akte ligjore të gjendura në CD

1. Kushtetuta e vitit 1998 (Pj. e të drejtave të njeriut)
2. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (Pj. e të drejtave të njeriut)
3. Ligji për Etikën
4. Kodi i Procedurave Administrative (Pj. e procedurave administrative)
5. Ligji Për Nëpunësit Civil (Pj. e të drejtave dhe detyrimeve)
6. Ligji për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore (Rastet e përgjegjësisë dhe llojet)
7. Kodi European i Sjelljes së Mirë Administrative të Bashkimit Evropian

